



## STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

Ndikimi i përkrahjeve financiare dhe  
jofinanciare në performancën e NVM-  
ve në R. e Maqedonisë – Rast  
studimor “Rajoni i Pollogut”

KANDIDATI:  
Leartha Jusufi

MENTORI:  
Prof. dr. Rufi Osmani

Tetovë, Korrik 2019

## Abstrakti

Financimi i NVM-ve ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, ekonomistëve dhe krijuesve të politikave, sepse NVM-të janë mjaft të rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Si rezultat i pasojave të vazhdueshme të krizës ekonomike, në përgjithësi nuk është edhe aq e lehtë për NVM-të të marrin financim të jashtëm. Në këtë mënyrë, një shpëtim për ta mund të jenë përkrahjet e ndryshme që ofrohen nga qeveritë dhe institucionet relevante, që i ofrojnë të njëjtat me qëllim të korigjimit të papërsosshmërive të tregut apo stimulimit të zhvillimeve të dëshiruara ekonomike dhe politike.

Ky punim do të jetë një kontribut me interes në ndikimin që kanë përkrahjet financiare dhe jofinanciare në performancën e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në R. e Maqedonisë, me theks të veçantë në rajonin e Pollogut. Politika e subvencionimit në R. e Maqedonisë do të analizohet nga këndvështrimi teorik dhe praktik i institucioneve relevante që i ofrojnë këto përkrahje, programeve, projekteve dhe aktiviteteve të tyre, si dhe procedurave të implementimit të të njëjtave, me qëllim të identifikimit të ndikimit që këto përkrahje kanë në performancën e NVM-ve, vëllimit dhe dinamikës së tyre, si dhe strukturës së kapaciteteve funksionale për implementimin e tyre. Për më tepër, këto përkrahje do të krahasohen edhe me ato të disa vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, me qëllim që të vërehet përparësitë dhe mangësitë e politikës së tanishme dhe përmirësimit të së njëjtës.

**Fjalë kyçe:** përkrahje financiare, përkrahje jofinanciare, NVM

## Апстракт

Финансирањето на МСП го привлекувало вниманието на многу истражувачи, економисти и креатори на политики затоа што малите и средните претпријатија се многу важни за економскиот развој. Како резултат на тековните последици од економската криза, добивањето на надворешно финансирање генерално не е лесно за МСП. На овој начин, спас за нив може да бидат различните поддршки што се обезбедуваат од страна на владите и релевантните институции, кои ги обезбедуваат истите со цел на поправањето на несовршеностите на пазарот или стимулирањето на посакуваните економски и политички случувања.

Овој труд ќе има интересен придонес во сферата на влијанието што ја имаат финансиската и нефинансиската поддршка врз перформансите на микро, малите и средните претпријатија во Р. Македонија, со посебен акцент на Полошкиот регион. Политиката за субвенционирање во Р. Македонија ќе биде анализирана од теоретска и практична гледна точка на релевантните институции кои ги обезбедуваат овие

поддршки, нивните програми, проекти и активности, како и процедурите за имплементација на истите, со цел да се идентификува влијанието што овие поддршки го имаат врз перформансите на МСП, нивниот волумен и нивната динамика, како и структурата на функционалните капацитети за нивно спроведување. Покрај тоа, овие поддршки ќе бидат споредени со оние на некои други земји од Западен Балкан, со цел да се забележат предностите и недостатоците на тековната политика и подобрување на истата.

**Клучни зборови:** финансиска поддршка, нефинансиска поддршка, МСП

## **Abstract**

SME financing has attracted the attention of many researchers, economists and policy makers because SMEs are very important for economic development. As a result of the ongoing consequences of the economic crisis, it is generally not that easy for SMEs to obtain external financing. Thus, a salvation for them may be the various types of support provided by the governments and relevant institutions, that provide the same with the aim of correcting market imperfections or stimulating the desired economic and political developments.

This paper will be a contribution with an interest to the impact of financial and non-financial subsidies in the performance of micro, small and medium-sized enterprises in R. of Macedonia, with a particular emphasis on the Polog region. The subsidy policy in the R. of Macedonia will be analyzed from the theoretical and practical point of view of the relevant institutions that provide these supports, their programs, projects and activities, as well as the procedures for the implementation of the same, in order to identify the impact that these supports have on the the performance of SMEs, their volume and dynamics, as well as the structure of the functional capacities for their implementation. Moreover, these subsidies will be compared to those of some other Western Balkan countries, in order to identify the advantages and disadvantages of the current policy and improve the same.

**Keywords:** financial subsidies, non-financial subsidies, SMEs

# Përmbajtja

1. Hyrje .....	1
1.1 Lënda e hulumtimit.....	1
1.2 Qëllimet e hulumtimit.....	2
1.3 Hipotezat .....	3
1.4 Metodologjia e hulumtimit .....	3
2. Sipërmarrësia, inovacionet dhe konkurrueshmëria e NVM-ve .....	4
2.1 Definimi i NVM-ve.....	5
2.2 Inovacionet e NVM-ve në R. e Maqedonisë.....	8
2.3 Konkurrueshmëria e NVM-ve në R. e Maqedonisë .....	11
3. Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në disa vende të Ballkanit Perëndimor.....	13
3.1 Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në Shqipëri .....	13
3.2 Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në Kosovë.....	19
3.3 Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në Sërbë .....	23
4. Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në R. e Maqedonisë .....	31
4.1 Ministria e Ekonomisë.....	31
4.2 Ministria për Punë dhe Politikë sociale, Agjencia e Punësimit dhe UNDP (Programi zhvillimor i Kombeve të Bashkuara) – Masat aktive për punësim .....	37
4.3 Agjencia për përkrahjen e sipërmarrësisë së Republikës së Maqedonisë (APSRM) .....	43
4.4 Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik (FEZ) dhe Agjencia për Investime të Huaja dhe promovimin të Eksportit të RM-së. ....	47
4.5 Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik.....	48
4.6 Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve nga projekte donatore ndërkombëtare.....	52
5. Analiza dhe diskutimi i rezultateve .....	54
5.1 Karakteristika të përgjithshme të ndërmarrjeve në R. e Maqedonisë - në veçanti në Rajonin e Pollogut.....	54
5.1 Analiza dhe diskutimi i rezultateve nga hulumtimi/anketimi i NVM-ve në Rajonin e Pollogut .....	56
6. Përfundime, rekomandime dhe kufizimet e studimit.....	79
6.1 Përfundime .....	79
6.2 Rekomandime.....	82
6.3 Kufizimet e studimit dhe hulumtimet e ardhshme .....	83
7. Literatura .....	83
8. Shtojcë .....	88

## Lista e Tabelave

Tabela 1 Kategorizimi i ndërmarrjeve sipas Unionit Evropian .....	6
Tabela 2 Kategorizimi i ndërmarrjeve në R. e Maqedonisë .....	7
Tabela 3 Kategorizimi i ndërmarrjeve në R. e Shqipërisë, Kosovës dhe Sërbisë.....	7
Tabela 4 GCI për vendet e Ballkanit Perëndimor .....	11
Tabela 5 Buxhetet vjetore të fondeve të Qeverisë së Shqipërisë për përkrahje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (ALL) .....	13
Tabela 6 Buxhetet vjetore të institucioneve të Kosovës për përkrahje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (EUR) .....	19
Tabela 7 Buxhetet vjetore të institucioneve të Sërbisë për përkrahje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2018 (RSD) .....	23
Tabela 8 Buxhetet vjetore të sektorit për përkrahje të sipërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë së NVM-ve pranë ME-së dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (MKD).....	32
Tabela 9 Buxhetet vjetore të Planit operativ për masat aktive për punësim dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (MKD) .....	38
Tabela 10 Buxhetet vjetore të APSRM-së dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (MKD) .....	43
Tabela 11 Buxhetet vjetore të FITR-it dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (EUR) .....	48
Tabela 12 Ndërmarrjet aktive sipas madhësisë, komunave dhe viteve në R. e Maqedonisë, dhe në veçanti Rajonin e Pollogut, për periudhën 2014-2018 .....	54
Tabela 13 Ndërmarrjet aktive sipas veprimtarive në R. e Maqedonisë, dhe në veçanti rajonin e Pollogut, në vitin 2018.....	55

## Lista e Grafikëve

Grafiku 1 Shpenzimet bruto për H&ZH (GERD) si % e GDP-së .....	9
Grafiku 2 Profili i konkurrueshmërisë së NVM-ve në RM .....	12
Grafiku 3 Struktura e veprimtarisë së ndërmarrjeve.....	56
Grafiku 4 Forma e regjistrimit të ndërmarrjeve .....	57
Grafiku 5 Pronësia e ndërmarrjeve.....	57
Grafiku 6 Kohëzgjatja e ekzistimit të ndërmarrjeve .....	58
Grafiku 7 Kategorizimi ligjor i ndërmarrjeve .....	58
Grafiku 8 Kategorizimi i ndërmarrjeve në bazë të qarkullimit vjetor në 5 vitet e fundit .....	59
Grafiku 9 Ndryshimi vjetor i qarkullimit të ndërmarrjeve në 5 vitet e fundit, 2014-2018 .....	59
Grafiku 10 Pritjet për rritje të qarkullimit vjetor në 3-5 vitet e ardhshme .....	60
Grafiku 11 Ndryshimi vjetor i numrit të të punësuarve në 5 vitet e fundit, 2014-2018 .....	60
Grafiku 12 Pritjet për rritje të numrit të të punësuarve në 3-5 vitet e ardhshme .....	61
Grafiku 13 Faktorët më problematik në udhëheqjen e biznesit të NVM-ve.....	61

Grafiku 14 Odat ekonomike në të cilat janë të anëtarësuara NVM-të.....	62
Grafiku 15 Përkrahja e NVM-ve nga institucionet relevante .....	64
Grafiku 16 Dokumentacioni i kërkuar gjatë aplikimit për përkrahjet relevante.....	65
Grafiku 17 Institucionet nga ku është marrë përkrahja e shfrytëzuar .....	66
Grafiku 18 Masat aktive për punësim të shfrytëzuara nga NVM-të.....	67
Grafiku 19 Lartësia e mjeteve financiare apo jofinanciare të shfrytëzuara nga NVM-të në formë të përkrahjes .....	68
Grafiku 20 Qëllimet e shfrytëzimit të përkrahjes financiare nga NVM-të .....	69
Grafiku 21 Qëllimet e shfrytëzimit të përkrahjes jofinanciare nga NVM-të .....	69
Grafiku 22 Arsyeja e mos fitimit të përkrahjes për të cilën është aplikuar .....	71
Grafiku 23 Impakti nga mospranimi i kërkesës/aplikimit për përkrahje financiare/jofinanciare .....	71
Grafiku 24 Arsyet për mos aplikim për asnjë lloj përkrahjeje .....	72
Grafiku 25 Lloji i përkrahjes që preferohet më shumë nga NVM-të .....	73
Grafiku 26 Qëllimet e shfrytëzimit të përkrahjeve financiare/jofinanciare nga NVM-të nëse do tu jepej mundësia.....	74
Grafiku 27 Vlera e përkrahjes për të cilën NVM-të kanë nevojë nëse do tu jepej mundësia e shfrytëzimit të tyre.....	75
Grafiku 28 Ndikimi pozitiv që ka pasur/do të kishte shfrytëzimi i përkrahjeve financiare/jofinanciare nga ana e NVM-ve .....	75
Grafiku 29 Nevoja për përkrahje financiare dhe jofinanciare në 5 vitet e fundit .....	76
Grafiku 30 Kanalet e informimit për përkrahjet e disponueshme financiare/jofinanciare ....	76
Grafiku 31 Masat e domosdoshme që sipas NVM-ve nevojiten për përmirësimin e performancës së tyre në tregjet ku veprojnë.....	77

# 1. Hyrje

## 1.1 Lënda e hulumtimit

Politikat zhvillimore të shteteve gjithmonë pëfshijnë në vete edhe komponentën e përkrahjes dhe mbështetjes së bizneseve në forma të ndryshme qofshin ato jofinaciare (trajnime, këshilla, konsulencë, ekspertizë etj.) apo finaciare (subvencionim për furnizim të makinave dhe pajisjeve, lëndës së parë, investimeve kapitale në objekte afariste, inovacione dhe teknologji të reja, marketing dhe promovim, kredi me kushte të volitshme etj. (OECD & UNIDO, 2004).

“Mungesa e kapitalit qarkullues, parasëgjithash për asrye të përmirësimit të likuiditetit të ndërmarrjeve gjegjësisht blerësve të tyre si dhe qasja më liberale nga bankat komercijale gjatë financimit të NVM-ve ka dhënë rezultat pozitiv tek ndërmarrjet në vitin 2015” (АППРМ, 2015).

Edhe R. e Maqedonisë nuk dallon në krahasim me shtetet e BE-së dhe ato të rrajonit në këtë drejtim por struktura e institucioneve të cilat janë përgjegjëse për përkrahjen financiare dhe jofinaciare të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është e centralizuar, me buxhet të limituar, promovim të dobët, kriteriume jo të volitshme, shkallë të subveconimit jo të përshtatshëm, respektivisht mungon një rrjet i përshtatshëm që do të ishte më afër bizneseve gjegjësisht që do të ofronte shërbime jashta kryeqendrës etj.

Përpunimi i Temës do të përfshije të dhëna primare përmes analizës dhe përpunimit të dhënave të programeve, projekteve, strategjive, të institucioneve relevante që ofrojnë subvencione për përkrahje jofinaciare dhe financiare të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nga niveli qendror në periudhën 2014-2018 (Agjensioni për përkrahjen e sipërmarrësive në RM-APSRM, Ministria e Ekonomisë, Ministria për punë dhe politikë sociale & UNDP - masat e ndryshme aktive për krijimin e bizneseve dhe punësimeve, Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik dhe projekte/programe nga donator të huaj).

Për qëllim të sigurimit të të dhënave sekondare do të përgatitet një pyetësor ku përmes intervistave/anketimeve të NVM-ve do të mblidhen të dhëna dhe të njëtat do të përpunohen dhe analizohen me qëllim që të vërehet se sa është roli dhe rëndësia e subvencioneve financiare dhe jofinanciare në rritjen dhe zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve.

Ndërmarrjet që do të anketohen do të jenë nga rrajoni i Pollogut.

Target I hulumtimit do të jenë 30 ndërmarrje ku 2/3 do të jenë nga ato që kanë shfrytëzuar ndonjë subvencion (mjete financiare, trajnime, implementime të standardeve, themelim të bizneseve etj.). Për këtë grup ndërmarrjesh do të bëhen analiza të dhënave në lidhje me madhësinë e ndihmës /mbështetjes së realizuar, rritjes së qarkullimit, rritjes së punësimit,

përmirësimit/rritjes së aftësive/njohurive të punsuarve etj. me qëllim të përcaktimit të ndikimit real të këtyre ndihmave në performancën e ndërmarrjeve.

Ndërsa, 1/3 do të jenë ndërmarrje që nuk kanë shfrytëzuar asnjëherë subvencione, me qëllim që të mund të nxjerrim në pah problemet dhe pengesat që e pamundësojnë aplikimin e tyre për shfrytëzimin e të njejtave.

Duke u nisur nga fakti se në rajonin e Pollogut dominojnë ndërmarrjet mikro dhe të vogla (qoftë në bazë të numrit të punësuarve apo të qarkullimit vjetor) (ESA Tetovë, 2016) anketimi do të jetë i koncentruar në përfshirjen e këtyre. Për këtë pjesë do të ketë një kaptinë ku do të prezentohen rregullativat ligjore të përcaktimit të madhësisë së ndërmarrjeve në BE dhe në R. e Maqedonisë si dhe trendet e zhvillimit të subjekteve afariste (numri dhe madhësia tyre) në periudhën analizës 2014-2018.

## 1.2 Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi kryesor i studimit është analiza e rolit dhe rëndësisë së politikave të subvencionimeve në rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve, vëllimi dhe kapaciteti i tyre, kushtet dhe kriteret e aplikuara në procesin e selektimit nga institucionet relevante në nivel qendror (Ministria e ekonomisë, Agjensioni për përkrahjen e sipërmarrësisë, MPPS/UNDP, Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik etj.).

Në hulumtim do të analizohen format dhe mënyrat e përkrahjes financiare dhe jofinanciare në R. e Maqedonisë krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor (Kosovë, Shqipëri dhe Serbi), institucionet relevante përgjegjëse, struktura organizative e tyre, aktivitetet të cilat ata i subvencionojnë dhe vëllimi dhe kapaciteti i tyre. Analiza e të dhënave në këtë pjesë të hulumtimit do të nxjerr në pah praktikatat pozitive në subvencionimin e NVM-ve të cilat do të mund të rekomandohen për aplikim edhe në R. e Maqedonisë.

Metodat analitike dhe komparative që do të përdoren gjatë hulumtimit poashtu do të nxjerrin në pah pasqyrën reale të gjendjes së strukturës organizative, të institucioneve qendrore që mbështesin me subvencione financiare dhe jofinanciare NVM-të, buxhetet e tyre, kriteriumet e selektimit, promovimin e aktiviteteve, transparencën në procesin e selektimit, madhësinë/përqindjen e subvencionimit dhe sa i gjithë ky proces ose politikë e mbështetjes së ndërmarrjeve ndikon në rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve, me theks të veçantë për rajonin e Pollogut. Nga konstatimi i pasqyrës reale do të mund të nxjerrim konkludime dhe rekomadime të cilat do të mund të meren për bazë në planifikimin e politikave për subvencionim të NVM-ve në institucionet qendrore që janë pjesë e analizës të këtij punimi.



### 1.3 Hipotezat

Në funksion të lidhjes së lëndës dhe qëllimeve të hulumtimit në kuadër të këtij studimi, në këtë pjesë prezentohen 3 hipotezat bazë:

- 1. Subvencionet financiare dhe jofinanciare kanë rol të rëndësishëm në performancën ekonomike të NVM-ve.**
- 2. Vëllimi dhe dinamika e subvencioneve financiare dhe jofinanciare nuk plotësojnë nevojat reale të NVM-ve në funksion të realizimit të objektivave biznesore.**
- 3. Mungesa e kapaciteteve funksionale të qendrave rajonale për përkrahje të NVM-ve pamundëson shryftëzimin më voluminoz të subvencioneve të ofruara nga institucionet qëndrore në rajonin e Pollogut.**

### 1.4 Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e hulumtimit do të përbëhet nga shfrytëzimi i dy llojeve të dhënave: sasiore dhe cilësore. Të dhënat sasiore do të sigurohen nga publikimet, buletinet statistikore dhe analizat e institucioneve/organizatave publike vendore dhe të huaja (si psh. Ministria e Ekonomisë, Agjensioni për përkrahjen e Sipërmarrësisë së RM-së, Agjensioni për Punësim i RM-së, Ministria për punë dhe politikë sociale, Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik, Enti shtetëror statistikor i RM-së, USAID, UNDP, OECD, etj.).

Gjatë hulumtimit do të përdoren metodat analitike, statistikore dhe komparative të cilat do të prezantojnë rolin dhe rëndësinë e subvencioneve në rritjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në R. e Maqedonisë - me theks të veçantë në rajonin e Pollogut. Gjithashtu do të ketë të dhëna edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor. Përmes metodave analitike dhe statistikore (tabelave dhe grafikëve) do të jepen të dhëna relevante sasiore për gjendjen e subvencioneve që paraqesin objekt studimi për periudhën 2014-2018. Ndërsa, përmes metodës komparative do të bëhen krahasime midis rezultateve të fituara, krahasime midis formave, mënyrave dhe volumit të subvencioneve, krahasime në mes viteve si dhe krahasime midis rezultateve të ndërmarrjeve që kanë marrë pjesë në shfrytëzimin e masave subvencionuese.

Rezultatet e arritura do të japin pasqyrën reale të gjendjes së politikave, programeve dhe projekteve të ndryshme për subvencionim të NVM-ve nga institucionet relevante në nivele të ndryshme të shtetit. Në bazë të këtyre rezultateve të arritura do të mund të jepen rekomandime të ndryshme që do të mund të kontribuojnë drejtpërdrejtë në rritjen, avancimin dhe përmirësimin e politikave të subvencionimit të NVM-ve me qëllim të ndikimit

më të madh në rritjen dhe zhillimin e sipërmarrësisë, inovacioneve dhe konkurrueshmërisë së NVM-ve në vend dhe rajon.

## 2. Sipërmarrësia, inovacionet dhe konkurrueshmëria e NVM-ve

NVM-të janë motori dhe fuqia kryesore e çdo ekonomie. Ato paraqesin faktorin kryesor të zhvillimit ekonomik, rritjes së punësimeve si dhe rritjes së inovacioneve dhe konkurrueshmërinë së një vendi duke siguruar nje stabilitet të përgjithshëm social dhe ekonomik. Duke pasur parasysh se ata përbëjnë rreth 99% të numrit total të bizneseve në shumicën e vendeve të botës, rrjedhimisht ngel të kuptohet se ata njëherazi janë përgjegjësit dhe kontribuesit kryesor në rritjen e GDP-së, promovimin e eksporteve dhe nxitjen e sipërmarrësisë.

NVM-të sjellin risi në ekonomi. Për shkak të madhësisë së tyre, NVM-të shpeshherë janë më të afta në identifikimin dhe përvetësimin e trendeve të reja në industri të ndryshme dhe ngasjen e këtyre inovacioneve brenda sektorëve të tyre përkatës. Kjo e bën të mundur që NVM-të të jenë gjithmonë pionierë të teknologjive të reja, duke hapur rrugën për investime më të mëdha dhe të guximshme. Në një ekonomi ku sektori i NVM-ve funksionon siç duhet, mund të jemi të sigurtë se produktet dhe shërbimet nuk ngelen prapa konkurrencës dhe se ndërmarrjet në fakt janë në gjendje që të bëjnë ndryshime në treg.

Këta ndërmarrje janë mjaft atraktive për klientët e tyre, pasi që shpeshherë ofrojnë oferta speciale për të inkurajuar biznesin repetitiv. Në përgjithësi, këta ndërmarrje i realizojnë aktivitetet e tyre me çmime relativisht më të ulta, dhe kjo i bën ata shumë atraktive për tu shfytëzuar nga ndërmarrjet më të mëdha në realizimin e disa aspekteve të procesit të prodhimit të tyre.

Një avantazh tjetër i NVM-ve është se ata mund të adaptohen shumë më lehtë ndaj ndryshimeve sesa organizatat më të mëdha dhe më komplekse. Për shkak të kësaj përshtatshmërie, NVM-të kanë shanse më të mira për ti përballuar kushtet e rënda ekonomike dhe janë të prirura për tu rimëkëmbur më shpejtë nga krizat përkatëse.

Këta ndërmarrje poashtu janë në gjendje të maksimizojnë dhe të stimulojnë konkurrencën, e cila është esenciale për revitalizimin e një ekonomie.

Sidoqofte, edhe pse NVM-të janë më fleksibile ndaj ndryshimeve sesa korporatat e mëdha, ata janë shumë më të ndjeshëm ndaj përkeqësimit të mjedisit të biznesit. Ata janë gjithashtu më të ndjeshëm ndaj ngacimeve nga institucionet qeveritare dhe kanë më pak burime për të tërhequr kur kohët janë të vështira.

Një sfidë e madhe për bizneset e vogla është qasja në financat për të cilat kanë nevojë për tu rritur dhe zhvilluar. Çështjet e kolateralit dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit ndikojnë te NVM-të në mënyrë joproportionale, ndërkohë që institucionet

financiare kanë më pak përvojë në kreditimin e segmentit të biznesit të vogël dhe shpesh i perceptojnë ato si më të rrezikshme se sa që është dëshmuar deri tani.

Nje sfide tjetër për NVM-të është gjithashtu pamundësia për të krijuar lidhje dhe partneritete me bizneset e mëdha. Edhe pse ekzistojnë shumë partneritete të tilla, ndërmarrjet e mëdha gjithnjë e më tepër preferojnë ti gëlltisnin ndërmarrjet e vogla duke i blerë ata, dhe duke e pasur parasysh historinë e “peshku i madh i han peshqit e vegjël”, pronarët e ndërmarrjeve të vogla hesitojnë në formimin e këtyre partneriteteve, pasi që kanë frikë se do të humbasin autonominë dhe identitetin e tyre.

Prandaj, në përgjithësi edhe pse gjithçka duket shumë premtuese, nuk është edhe aq lehtë për njerëzit që të marrin vendimin për të hapur bizneset e tyre.

Sektori i NVM-ve është mjaft i rëndësishëm edhe në R. e Maqedonisë. Në bazë të të dhënave për vitin 2017 numri i ndërmarrjeve aktive të biznesit ishte 71419 ku 99.6% e tyre përbëhet nga NVM-të (Krsteva, 2018, f. 1) të cilat kanë angazhuar 74.8% të numrit total të të punësuarve në sektorin privat dhe paraqesin 63.7% të totalit të vlerës së shtuar në sektorin e biznesit në R. e Maqedonisë (Shipovikj, 2018, f. 1). Pikërisht nga keto të dhëna mund të shihet qartë impakti i sektorit të NVM-ve i cili punëson me tepër se  $\frac{3}{4}$  e totalit të fuqisë punëtore në R. e Maqedonisë.

## 2.1 Definimi i NVM-ve

NVM-të janë entitete të pavarura të tregut, definimi i të cilave varet nga më tepër se një faktorë, të tillë si: kultura e biznesit, numri i popullatës së një vendi, industria dhe niveli i integritit internacional ekonomik. Edhe pse shumica e vendeve Europiane përdorin termin NVM – ndërmarrje të vogla dhe të mesme, asnjëri prej tyre nuk kanë një definim kuantitativ i cili i definon NVM-të në mënyrë precize. E gjithë kjo buron nga fakti se të qenurit “i vogël” është një koncept relativ dhe ajo që konsiderohet e vogël mund të dallojë nga sektori në sektor. Kështu që, një ndërmarrje prodhuese me 150 të punësuar mund të pranohet si NVM, por një shitës me pakicë me të njejtin numër të punëtorëve mund të konsiderohet si një ndërmarrje e madhe (Council of Europe, 1994, f. 9).

Në përgjithësi, si kritere bazë për definimin e NVM-ve merren: numri i të punësuarve, qarkullimi vjetor, profitabiliteti etj. Mirëpo, përsëri këta kritere dallojnë nga sektori në sektor, ashtu që një pjesë e ndërmarrjeve në bazë të këtyre kriterëve mund të klasifikohen si të vogla në një sektor apo industri, ndërsa të njejtat të mos bëjnë pjesë në këtë kategori të ndërmarrjeve në një sektor apo industri tjetër (OECD & UNIDO, 2004).

Një ndër problemet kryesore në literaturën e sotshme, është pikërisht terminologjia e cila përdoret për të klasifikuar ndërmarrjet të cilat nuk bëjnë pjesë në kategorinë e ndërmarrjeve të mëdha. Një pjesë e saj u referohet atyre si ndërmarrje të vogla, një pjesë tjetër përdor konceptin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ndërsa ca të tjerë u

rreferohen si ndërmarrje mikro të vogla dhe të mesme, edhe pse bëhet fjalë për të njejtën kategori ndërmarrjesh.

Dallimet kryesore në definimet e ndryshme të NVM-ve burojnë pikërisht nga dallimet që ekzistojnë në definimin e tyre nga institucionet internacionale, ligjet kombëtare dhe industritë përkatëse. Këta qasje shpeshherë e bëjnë të vështirë adaptimin e një definimi univerzal të NVM-ve, prandaj ndoshta do të ishte më e arsyeshme që matja e NVM-ve të bëhej nëpërmjet të vetëm një faktori, si p.sh: shitjet vjetore ose qarkullimi vjetor apo/ose numri i të punësuarve, por duke e përcaktuar madhësinë e tyre varësisht kushteve specifike të vendeve përkatëse në të cilat operojnë.

Në vazhdim do të elaborojmë kriteret sipas të cilave definojnë NVM-të në Evropë dhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe R. e Maqedonisë.

### ***Definimi i NVM-ve në Unionin Evropian***

Në vitin 1996, Komisioni Evropian miratoi rekomandimin i cili përcaktoi definimin e parë të përbashkët për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Unionin Evropian (European Commission, 1996). Ky definim u zëvendësua nga rekomandimi i Komisionit që u referohej ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të datës 6 Maj, 2003 (European Commission, 2003) i cili hyri në fuqi më 1 Janar, 2005 dhe është i detyrueshëm për skemat kombëtare të ndihmave shtetërore dhe programve të komunitetit. Implementuesit e këtij definimi janë vendet anëtare të Unionit Evropian, Banka Evropiane e Investimeve dhe Fondi Evropian i Investimeve.

Sipas Unionit Evropian, kategoria e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM) përbëhet nga ndërmarrjet të cilat punësojnë më pak se 250 persona dhe që kanë një qarkullim vjetor jo më të madh se 50 milion EUR, dhe/ose një bilanc vjetor total jo më të madh se 43 milion EUR (European Commission, 2003). Megjithatë, shpeshherë, duhet të bëhet një analizë më e thellë, në veçanti e ndërmarrjeve me strukturë më komplekse për tu vërtetuar nëse ato në të vërtetë i takojnë kësaj kategorie, për shkak se disa NVM edhe pse janë shumë të vogla në përputhje me kriteret e mësipërme, mund të kenë qasje në resurse shtesë për shkak se posedohen, janë të lidhura apo kanë partneritete me ndërmarrje më të mëdha, andaj dhe mund të mos e meritojnë statusin e të qënurit NVM (European Commission, 2015, f. 4).

***Tabela 1 Kategorizimi i ndërmarrjeve sipas Unionit Evropian***

Kategoria e ndërmarrjes	Numri i të punësuarve	Qarkullimi vjetor	ose	Totali i bilancit vjetor
E mesme	< 250	≤ € 50 m		≤ € 43 m
E vogël	< 50	≤ € 10 m		≤ € 10 m
Mikro	< 10	≤ € 2 m		≤ € 2 m

*Burimi: (European Commission, 2003)*

### **Definimi i NVM-ve në R. e Maqedonisë**

Në R. e Maqedonisë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë të definuara me anë të Ligjit për shoqëri tregtare të vitit 2004, Neni 470 (Gazeta zyrtare e RM-së, Zakon za Trgovskite Društva, 2004). Ata klasifikohen në bazë të numrit të të punësuarve, qarkullimit vjetor dhe vlerës mesatare të totalit të aktiveve në llogaritë vjetore gjatë dy viteve të fundit (vitet e kontabilitetit). Në bazë të këtij ligji, tregtar mikro, i vogël dhe i mesëm llogaritet ai tregtar i cili në dy vitet e fundit të njëpasnjëshme, rrespektivisht gjatë vitit të parë të aktivitetit e ka plotësuar kriterin e parë dhe së paku të dytin ose të tretin nga kriteret në vijim:

*Tabela 2 Kategorizimi i ndërmarrjeve në R. e Maqedonisë*

Kategoria e ndërmarrjes	Numri mesatar i të punësuarve	Qarkullimi vjetor	ose	Vlera mesatare e totalit të mjeteve
E mesme	< 250	< € 10 m		< € 11 m
E vogël	< 50	< € 2 m		< € 2 m
Mikro	< 10	< € 50,000		

*Burimi: (Gazeta zyrtare e RM-së, Zakon za Trgovskite Društva, 2004)*

Ky përkufizim është në përputhje me përkufizimin e mësipërm të BE-së në lidhje me pragon për numrin e të punësuarve, por jo edhe kufijtë e qarkullimit vjetor dhe bilancit të gjendjes. Gjithashtu, agjensionet e ndryshme kanë kriteret e ndryshme për shërbimet e tyre. P.sh. Ligji për themelimin e APPRM-së (Ligji për krijimin e Agjensionit për NVM-të në R. e Maqedonisë), identifikon NVM-të si ndërmarrje të pavarura të cilët kanë më pak se 50 të punësuar, realizojnë qarkullim vjetor i cili nuk tejkalon 1.5 milion EUR në kundërvlerë në denarë, dhe kanë së paku 51% pronësi private (Ministria e Ekonomisë, 2018).

### **Definimi i NVM-ve në Shqipëri, Kosovë dhe Sërbi**

Në Shqipëri, Kosovë dhe Sërbi, kategorizimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme bëhet sipas kriteriumeve në vijim (vetëm në rastin e Sërbisë ndërmarrjet duhet të plotësojnë kriterin e parë dhe së paku kriterin e dytë ose të tretë):

*Tabela 3 Kategorizimi i ndërmarrjeve në R. e Shqipërisë, Kosovës dhe Sërbisë*

Kategoria e ndërmarrjes	Numri i të punësuarve	Shifër afarizmi/ Bilanci total vjetor /Të ardhurat vjetore	ose	Vlera mesatare e mjeteve
<b>SHQIPËRIA</b>				
E mesme	< 250	< ALL 250 m		
E vogël	< 50	< ALL 50 m		
Mikro	< 10	< ALL 10 m		
<b>KOSOVA</b>				

E mesme	< 250		
E vogël	< 50		
Mikro	< 10		
<b>SËRBIA</b>			
E mesme	< 250	< € 35 m	< € 17.5 m
E vogël	< 50	< € 8.8 m	< € 4.4 m
Mikro	< 10	< € 700,000	350,000

*Burimi: (Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2008), (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2008), (Sluzben Glasnik RS, 2018).*

## 2.2 Inovacionet e NVM-ve në R. e Maqedonisë

Inovacionet paraqesin një element mjaft të rëndësishëm në diversifikimin e ekonomisë në mbarë botën si dhe kanë një rol tejet kritik në zhvillimin e qëndrueshëm dhe suksesin e ndërmarrjeve (Drucker, 1985), (Damanpour, 1991), (OECD, 2005, f. 5).

NVM-të varen shumë nga idetë e reja, dhe për të qenë të suksesshme ato gjithnjë duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë nevojat dhe kërkesat e tregut në mënyrë që të krijojnë produkte me vlerë superiore dhe të ngelen konkurrencte në treg për një periudhë më të gjatë, veçanërisht në skenarin e ndryshimeve të shpejta teknologjike, cikleve më të shkurta të jetës së produktit dhe konkurrencës intensive.


Në përgjithësi, shumica e studimeve lidhur me inovacionin janë të fokusuar te ndërmarrjet e mëdha. Pavarësisht studimeve të shumta për NVM-të që janë realizuar kohëve të fundit, çështja e inovacionit të NVM-të nuk është studiuar në përmasa të mëdha, studimet më tepër shtjellojnë faktorët të cilët ndikojnë në rritjen e NVM-ve, dhe jo drejtpërsëdrejti ndikimin e inovacioneve në rritjen e tyre. Sidoqoftë, shumica e teoricientëve përkrahin teorinë se ndërmarrjet të cilat janë më inovative kanë performancë më të mirë. Nga ana tjetër, edhe studimet empirike tregojnë se ekziston një lidhje pozitive në mes të inovacionit dhe rritjes së ndërmarrjes, në qoftë se ekzistojnë financa të vazhdueshme (Hyytinen & Toivanen, 2003). Kjo tregon se në prezencën e inovacionit, performanca e përgjithshme e ndërmarrjes do të përmirësohet në aspekt të shitjeve, depërtimit të tregut, profitabilitetit dhe qëndrueshmërisë së ndërmarrjeve, në veçanti NVM-ve, për shkak të aftësisë dhe fleksibilitetit të tyre për të reaguar shpejt ndaj kërkesave të tregut dhe mundësisë për të bashkëpunuar me ndërmarrje të tjera përmes nënkontraktimeve dhe relacioneve të tjera biznesore.

Si indikator më i përhapur për matjen e inputit të inovacioneve, zakonisht përdoret sasia e investimeve që një vend bën për krijimin e njohurive të reja (OECD, 2011). Sidoqoftë, shpenzimet në H&ZH<sup>1</sup> nuk përfshijnë të gjitha aktivitetet e inovacionit, në veçanti inovacionet teknologjike.

<sup>1</sup> Hulumtim dhe Zhvillim

R. e Maqedonisë është një ndër vendet me shpenzime më të vogla për H&ZH në rajon. Sipas të dhënave të fundit, në vitin 2016, shpenzimet bruto të dedikuara për H&ZH (GERD) paraqesin 0.40% të GDP-së (UNESCO, 2019) dhe janë shumë të ulta krahasuar me UE ku ata paraqesin 2.03% të GDP-së (Eurostat, 2019). Sidoqoftë, nga grafiku 1 mund të vërejmë se në rastin e R. së Maqedonisë ata janë dyfishuar në periudhën prej vitit 2011 deri në vitin 2014, për të shënuar përsëri ulje në vitin 2015. Serbia qëndron në pozitë më të mirë se R. e Maqedonisë, mirëpo përsëri është larg standardeve të EU-së. Sa u përket vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, të dhënat lidhur me këtë indikator nuk janë të plota apo nuk janë fare në dispozicion dhe rrjedhimisht nuk mund të bëjmë krahasimin me këto vende.

*Grafiku 1 Shpenzimet bruto për H&ZH (GERD) si % e GDP-së*



*Adaptuar nga: (UNESCO, 2019) dhe (Eurostat, 2019)*

Analiza me detajore e strukturës së shpenzimeve për H&ZH në RM na tregon se sektori i biznesit ka rol të limituar në H&ZH. Pjesa më e madhe e shpenzimeve për H&ZH u takon institucioneve publike 63.06%, ndërsa ndërmarrjeve të biznesit u takon vetëm 26.39% (BERD) në vitin 2017, që është perafërsisht ¼ e shpenzimeve të përgjithshme, krahasuar me UE ku ndërmarrjeve të biznesit u takonte 66% nga GERD, që do të thotë dyfish me shumë se në RM (UNESCO, 2019).

Ja vlen të përmendet se sipas Tabelës së vlerësimit të inovacionit të Evropës (EIS) shpenzimet të cilat nuk janë të dedikuara për H&ZH në R. e Maqedonisë janë shumë më të larta se shpenzimet për H&ZH, që nënkupton se ndërmarrjet ka gjasë të adaptojnë teknologjitë ekzistuese në vend që të zhvillojnë teknologji të reja.

Për më tepër, në indikatorët me të cilët matet outputi i inovacioneve zakonisht bëjnë pjesë patentat dhe markat tregtare. R. e Maqedonisë me 0.08 aplikime për patenta për bilion GDP qëndron në vendin e fundit nga 36 vendet, ndërsa sa u përket markave tregtare, në vendin e 33 me 3.24 aplikime për bilion GDP. Në kategorinë e parë është shumë më e dobët se mesatarja e EU-së, ndërsa në kategorinë e dytë performon pak më mirë dhe është vetëm dy herë me e dobët se mesatarja e EU-së. R. e Sërbisë qëndron në pozicion me të mirë se R. e Maqedonisë, por më të dobët se mesatarja e EU-së (European Innovation Scoreboard ,

2018). Meqenëse në këtë raport të dhënat për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor nuk janë në dispozicion, do ti referohemi raportit të fundit të OECD-së, 2005-2011 sipas të cilit mund të vërehet se Shqipëria dhe Bosnja Hercegovina ndodhen në pozita më të dobëta se R. e Maqedonisë, ndërsa për Kosovën nuk ka fare të dhëna

### ***Indekset e inovacionit***

Ekzistojnë disa indekse të ndryshme internacionale për të matur nivelin e inovacionit të ekonomisë së një vendi dhe R. e Maqedonisë në përgjithësi ka performancë të dobët në këto indekse (OECD IC, 2013). Sipas Tabelës së vlerësimit të inovacionit të Evropës (EIS), R. e Maqedonisë rangohet si një inovatore modeste e cila ndodhet në vendin e 34 nga 36 vende, me një indeks të përmbledhjes së inovacionit (SII) prej 0.222 shumë më i vogël se 0.504 që reprezenton mesataren e UE.

Sipas të njejtit burim mund të vërehet se në R. e Maqedonisë rreth 25.6% nga totali i NVM-ve kanë inovuar duke krijuar të paktën një produkt apo proces të ri ose të modifikuar, ndërsa rreth 27.8% nga totali i NVM-ve kanë krijuar inovacione të marketingut dhe organizacionale. Në të dy kategoritë ndodhet në vendin e 25 nga 36 vende dhe nuk ndodhet edhe aq larg mesatareve të EU-së (30.9%/34.9%).

Sipas dy indikatorëve të ardhshëm - përqindja e NVM-ve të cilët inovojnë in-house dhe NVM-të të cilët bashkëpunojnë me të tjerët nga totali i NVM-ve në R. e Maqedonisë, rreth 18.7% e NVM-ve inovojnë in-house, ndërsa rreth 7.1% e NVM-ve inovojnë duke bashkëpunuar me të tjerët. Nga kjo mund të kuptojmë se koncepti i inovacionit të hapur është relativisht i ri në R. e Maqedonisë dhe praktikohet nga vetëm një numër i vogël i ndërmarrjeve.

Në të gjitha kategoritë e mësipërme R. e Serbisë<sup>2</sup> qëndron në pozitë më të mirë se R. e Maqedonisë dhe i afrohet shumë më tepër EU-së, përveç në rastin e NVM-ve që inovojnë duke bashkëpunuar me të tjerët ku është në pozicion më të dobët me 4.9%.

Sipas Indeksit global të inovacionit (GII), R. e Maqedonisë është ranguar në vendin e 84 me një GII prej 29.91 dhe ndodhet pas Malit të Zi (vendi i 52-të), Serbisë (vendi i 55-të), Bosnjës dhe Hercegovinës (vendi i 77-të) dhe Shqipërisë (vendi i 83-të).

Nga të dhënat e mësipërme mund të konstatojmë se pavarësisht politikave të deritanishme për nxitjen e inovacionit, R. e Maqedonisë qëndron më dobët në krahasim me vendet me ekonomi të ngjajshme dhe UE. Krahasuar me ekonomitë e vendeve të ngjajshme në regjion, shpenzimet për H&ZH i ka shumë të vogla dhe nga statistikat mund të vërehet se vazhdojnë të kenë tendencë rënëse. Për më tepër, vetëm një pjesë e vogël e tyre realizohen në sektorin e biznesit, ndërsa pjesa më e madhe e tyre është e fokusuar te insitucionet publike, dhe përfaqëson vendin ku qeveria punëson pjesën më të madhe të të punësuarve në H&ZH nga i gjithë regjioni. Rrjedhimisht edhe outputet e inovacionit që reflektohen në numrin e

---

<sup>2</sup> Të dhëna për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor nuk janë në dispozicion.



patentave dhe markave tregtare, por edhe komponentat e inovacionit sipas Global Innovation Index janë relativisht të ulta me vendet fqinje.

### 2.3 Konkurrueshmëria e NVM-ve në R. e Maqedonisë

Kohëve të fundit, rëndësisë së konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve i kushtohet gjithnjë e më tepër vëmendje. Liberalizimi i tregtisë rrit kapacitetin e prodhuesve dhe shitësve të huaj për të depërtuar në tregjet e largëta dhe më pak të zhvilluara, gjë që i prek më shumë NVM-të të cilat operojnë në tregun lokal, produktet dhe shërbimet e të cilave janë ekstremisht të lokalizuara apo segmentuara. Prandaj, ndërmarrjet jokonkurrenente gjithnjë e më tepër zhduken apo janë të detyruara tu nënshtrohen ndryshimeve drastike rristrukturore. Në një ambient të tillë konkurrues biznesor, e vetmja mënyrë që NVM-të të mbijetojnë është duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme biznesin e tyre që të sigurojnë një qëndrueshmëri afatgjate në tregun aktual në të cilin operojnë.

Sipas shumë studiuësve, përmirësimi i konkurrueshmërisë së NVM-ve nënkupton realizimin e ca lëvizjeve dhe aktiviteteve për të siguruar një pozitë më të favorshme konkurruese. Për ta bërë këtë, ndërmarrjet duhet të specifikojnë se në cilin funksion të biznesit janë në gjendje që të krijojnë përparësi konkurruese dhe cilën pozitë konkurruese synojnë ta arrijnë brenda periudhës së caktuar kohore.

Indikatori më gjithëpërfshirës për matjen e konkurrueshmërisë së një vendi është Indeksi global i konkurrueshmërisë (GCI). Sipas këtij indikatori R. e Maqedonisë qëndron në vendin e 84, me 57 pikë (nga 100). Nëse i shqyrtojmë 12 nën indikatorët e këtij indikatori veçmas, R. e Maqedonisë performon më mirë në kategorinë dinamika e biznesit (vendi i 57), si dhe adaptimi i teknologjisë së komunikimit dhe informacionit dhe stabiliteti makroekonomik (vendi i 70), ndërsa një ndër performancat më të dobëta është pikërisht mundësia për inovacione (vendi i 98) (World Economic Forum, 2018, fv. 363-365).

Në qoftë se bëjmë krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, nga tabela më poshtë mund të vërejmë se pozitë më të mirë sipas GCI ka Serbia, duke u ndjekur nga Mali i Zi, Shqipëria, R. e Maqedonisë dhe Bosnja dhe Hercegovina.<sup>3</sup> Në qoftë se bëjmë një vlerësim më të thellë të komponentave të këtij indikatori mund të vërejmë se ekzistojnë shumë ngjajshmëri në regjion, respektivisht këta vende ballafaqohen me problematika përgjithësisht të ngjajshme. Në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, R. e Maqedonisë ka mjedis makroekonomik dhe institucione më të mira, si dhe një treg më efikas të produkteve ndërsa në kategorinë e shëndetësisë dhe edukimit ndodhet pas vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor (World Economic Forum, 2018).

*Tabela 4 GCI për vendet e Ballkanit Perëndimor*

Vendi	Pikët	Rangu
-------	-------	-------


<sup>3</sup> Të dhënat për Kosovën nuk janë në dispozicion.

Sërbia	60.9	65
Mali i Zi	59.6	71
Shqipëria	58.1	76
R. e Maqedonisë	56.6	84
Bosnja dhe Hercegovina	54.2	91
Kosova	-	-

Adaptuar nga: (World Economic Forum, 2018)

Konkurrueshmëria e NVM-ve të vendeve në veçanti, më së miri sqarohet nga raporti Pikëpamjet e konkurrueshmërisë së NVM-ve 2018 (SMECO). Ky raport i përpiluar nga ana e Qendrës tregtare ndërkombëtare, bën klasifikimin e indikatorëve të konkurrueshmërisë së NVM-ve përmes dy dimensioneve: si këta indikatorë ndikojnë në konkurrueshmërinë e tyre (shtyllat) dhe ku ndërhyjnë ata (nivelet). Tre shtyllat e konkurrueshmërisë përfshijnë: kapacitetin për të konkurruar, kapacitetin për tu lidhur dhe kapacitetin për të ndryshuar, ndërsa nivelet e konkurrueshmërisë përfshijnë aftësitë e ndërmarrjes, ekosistemin e biznesit dhe mjedisin kombëtar të cilët kalkuloohen nga mesatarja e shumë nënindikatorëve të tjerë që i ngërthejnë në vete (International Trade Centre, 2018, fv. 87-88). Në vijim mund të vërejmë profilin e R. e Maqedonisë në bazë të këtyre indikatorëve:

Grafiku 2 Profili i konkurrueshmërisë së NVM-ve në RM



Burimi: (International Trade Centre, 2018, f. 144)

NVM-të në R. e Maqedonisë performojnë mirë në aftësitë e tyre për të konkurruar dhe për tu lidhur krahasuar me ndërmarrjet e vendeve të cilat kanë përafërsisht nivel të njëjtë të zhvillimit, ndërsa për sa u përket aftësive të tyre për të ndryshuar, NVM-të mund ti risin ato duke marrë licenca të huaja të teknologjisë dhe auditimit të pasyrave të tyre financiare. Ndërmarrjet e mëdha qëndrojnë mirë sa u përket këtyre dy indikatorëve, që do të thotë se NVM-të mund ta arrijnë shpejtë nivelin e tyre. Në nivelin e ekosistemit të biznesit, për sa u përket procedurave efikase doganore, licencave dhe lejeve për biznes, si dhe cilësisë së mirë të furnizuesve vendor, ndërmarrjet tregojnë performancë e cila është më e mirë se sa pritet nga vendet që kanë nivel të zhvillimit si ai i R. së Maqedonisë (International Trade Centre, 2018, f. 145).

### 3. Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në disa vende të Ballkanit Perëndimor

#### 3.1 Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në Shqipëri

Në Republikën e Shqipërisë përkrahjet financiare dhe jo financiare të NVM-ve, ofrohen nga institucionet në vijim: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Bashkitë, si dhe donatorët e huaj, ndërsa menaxhohen intensivisht nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Në periudhën e studimit 2014-2018, programet mbështetëse të NVM-ve realizohen përmes fondeve në vijim, të themeluara nga Qeveria e Shqipërisë ndërsa të menaxhuara nga AIDA: Fondi i konkurrueshmërisë, Fondi i Ekonomisë Kreative, Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up”, Fondi i Inovacionit, Fondi në Mbështetje të Mikrondërmarrjeve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme që ushtrojnë aktivitete në zona turistike/historike dhe Fondi në mbështetje të grave sipërmarrëse. (AIDA, 2019).

*Tabela 5 Buxhetet vjetore të fondeve të Qeverisë së Shqipërisë për përkrahje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (ALL)*

Fondi	2014	2015	2016	2017	2018
Fondi i konkurrueshmërisë	20,000,000	18,000,000	28,000,000	28,000,000	28,000,000
Fondi i Ekonomisë Kreative				10,000,000	10,000,000
Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up”	2,000,000	4,000,000	10,000,000	9,000,000	10,000,000
Fondi i Inovacionit	-	-	-	-	15,000,000
Fondi në mbështetje të NVM-ve që ushtrojnë aktivitetet në zonat turistike/historike	-	-	29,000,000	10,000,000	10,000,000
Fondi në mbështetje të grave sipërmarrëse	2,500,000	5,000,000	10,000,000	9,000,000	-

*Burimi: (AIDA, 2019)*

#### **Fondi i konkurrueshmërisë**

Fondi i konkurrueshmërisë, i miratuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave, është krijuar për përkrahjen, përmirësimin dhe zhvillimin e kapacitetit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregjet në të cilat veprojnë, dhe njëherit të rrisin edhe punësimin. Ndërmarrjet të cilat do të përkrah ky fond janë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme me fokus në eksport, ndërsa fushat kryesore që mbulon fondi janë prodhimi dhe shërbimi, rrespektivisht (AIDA, 2019): sektori i industrisë së përpunimit aktiv, sektori i industrisë së lehtë, sektori i agropërpunimit dhe, sektori i kërkimit dhe zhvillimit.

Vlera e përgjithshme e këtij fondi për vitet 2016-2018 ka qenë 84,000,000 ALL, rrespektivisht 28,000,000 ALL në vit (Këshilli i Ministrave, Vendim për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë, 2016). Skema e Grantit për ndarje të Kostove të Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë financon vetëm një pjesë të kostove të ndërmarrjeve që kanë aplikuar, rrespektivisht 70% të tyre, por jo më tepër se 1,400,000 ALL për një projekt, ndërsa pjesa tjetër duhet të financohet nga vetë përfituesi i grantit. Kostot të cilat NVM-të aplikuese mund ti mbulojnë nëpërmjet të këtij granti janë si në vijim: kosotot për certifikim produkti, pjesëmarrje në panairë jashtë vendit, promovim dhe publikim të materialit promovues, përshtatje produkti, krijim të uebfaqeve për të zhvilluar tregtinë elektronike, si dhe shërbime konsulente (MFE, Rregullore e funksionimit për Fondin Shqiptar të Konkurrueshmërisë, 2019).

### ***Fondi i Ekonomisë Kreative***

Fondi i Ekonomisë Kreative, i miratuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave, është krijuar për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla të cilat i takojnë sektorit të artizanatit dhe zejtarisë në Shqipëri, me qëllim të krijimit të kushteve dhe mjedisit të favorshëm për realizimin e veprimtarisë së tyre, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës (AIDA, 2019).

Vlera e përgjithshme e këtij fondi për vitet 2017-2019 është 30,000,000 ALL, rrespektivisht 10,000,000 ALL në vit (Këshilli i Ministrave, 2017). Skema e Grantit për ndarje të Kostove të Fondit të Ekonomisë Kreative financon vetëm një pjesë të kostove të ndërmarrjeve që kanë aplikuar, rrespektivisht 80% të tyre, por jo më tepër se 500,000 ALL për një projekt, ndërsa pjesa tjetër duhet të financohet nga vetë përfituesi i grantit. Kostot të cilat NVM-të aplikuese mund ti mbulojnë nëpërmjet të këtij granti janë si në vijim: zhvillimi i produkteve të reja, blerje e pajisjeve për nxitjen e prodhimit, marketingu i produkteve, si dhe kualifikimi dhe ndërtimi i kapaciteteve menaxheriale të ndërmarrjes aplikuese (MZHETTS & MF, 2017).

### ***Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up”***

Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up”, i miratuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave, është krijuar për përkrahjen e sipërmarrjeve të reja apo të sapo krijuara - “Start-up” me qëllim të përmirësimit të kushteve në të cilat ata operojnë, krijimin dhe zhvillimin e një mjedisi më të përshtatshëm ekonomik, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Ndërmarrjet të cilat do ti përkrah ky fond janë ndërmarrjet mikro dhe të vogla që realizojnë veprimtarinë e tyre në sektorët në vijim (AIDA, 2019): Sektorët prodhues dhe të shërbimit, Sektorin e industrisë së lehtë, Sektorin e turizmit, Fushën e kërkimit dhe zhvillimit, Procesin e agropërpunimit, si dhe Fushën e dizajnit, modelimit, artizanatit.

Vlera e përgjithshme e këtij fondi për vitet 2018-2020 është 30,000,000 ALL, rrespektivisht 10,000,000 ALL në vit (Këshilli i ministrave, 2018). Skema e Grantit për ndarje të Kostove të Fondit në mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja “Start-up” financon vetëm një pjesë të

kostove të ndërmarrjeve që kanë aplikuar, rrespektivisht 70% të tyre, por jo më tepër se 500,000 ALL për një projekt, ndërsa pjesa tjetër duhet të financohet nga vetë përfituesi i grantit. Kostot të cilat NVM-të aplikuese mund ti mbulojnë nëpërmjet të këtij granti janë si në vijim: investime në pajisje dhe teknologji për nxitjen e prodhimit/shërbimit, marketing dhe promovim të produktit, kualifikim dhe trajnim për rritjen e aftësive të sipërmarrësit, krijim të uebfaqeve, si dhe pjesëmarrje në panaire dhe ekspozita lokale dhe ndërkombëtare (MFE, 2018).

### ***Fondi i Inovacionit***

Fondi i Inovacionit, i miratuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave, është krijuar për të përkrahur nxitjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në sferat e inovacionit dhe teknologjisë, me qëllim të identifikimit të furnizuesve të teknologjisë dhe partneriteteve nga vendet e tjera, si dhe lehtësimin e promovimit dhe licencimit të invacioneve të NVM-ve (AIDA, 2018).

Vlera e përgjithshme e këtij fondi për vitet 2018-2020 është 45,000,000 ALL, rrespektivisht 15,000,000 ALL në vit (Këshilli i Ministrave, 2018). Skema e Grantit për ndarje të Kostove të Fondit të Inovacionit financon vetëm një pjesë të kostove të ndërmarrjeve që kanë aplikuar, rrespektivisht 50% të tyre, por jo më tepër se 400,000 ALL për një projekt, ndërsa pjesa tjetër duhet të financohet nga vetë përfituesi i grantit. Kostot të cilat NVM-të aplikuese mund ti mbulojnë nëpërmjet të këtij granti janë si në vijim: auditim i kapaciteteve innovative dhe teknologjike, ndërkombëtarizimi i teknologjisë, pjesëmarrje në panaire inovacioni dhe promovime në lidhje me inovacionin e ndërmarrjes, blerje pajisjesh teknologjike, si dhe kostot e licencave ose patentave (MFE, 2018).

### ***Fondi në Mbështetje të Mikrondërmarrjeve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme që ushtrojnë aktivitete në zona turistike/historike***

Fondi në Mbështetje të të Mikrondërmarrjeve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme që ushtrojnë aktivitete në zona turistike/historike, i miratuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave, është krijuar për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të cilat operojnë në zonat turistike dhe historike (AIDA, 2019).

Vlera e përgjithshme e këtij fondi për vitet 2016-2018 është 49,000,000 ALL (Këshilli i Ministrave, 2016). Varësisht nga propozim projekti i dorëzuar, skema e këtij granti mund të mbulojë deri në 50% të shpenzimeve të pranuar, por jo më shumë se 3,000,000 ALL, ndërsa pjesa e mbetur duhet të financohet nga vet ndërmarrja aplikuese (MZHETTS, 2016).

### ***Fondi në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse***

Fondi në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse, i miratuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave, është krijuar për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të cilat drejtohen nga gratë si pronare të tyre (AIDA, 2019).

Vlera e përgjithshme e këtij fondi për vitet 2014-2017 është 26,500,000 ALL (Këshilli i Ministrave, 2014). Skema e këtij granti përfshin pagesën e interesave për kreditë e marra nga ndërmarrjet e drejtuara nga gratë, të cilat do të përdoren për investime në biznes. Kjo përkrahje do të mbulojë 50% të normës së interesit, për katër vite me rradhë, por jo më shumë se 1,000,000 ALL për kredi, edhe atë me kusht që ndërmarrjet ti përkasin ndonjërit nga sektorët në vijim: sektorit prodhues dhe të shërbimit, sektorit të industrisë së lehtë, sektorit të turizmit, fushës së kërkimit dhe zhvillimit, procesit të agropërpunimit, apo fushës së dizajnit, modelimit dhe artizanatit (MZHETTS, 2014).

### ***Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve nga projekte donatore ndërkombëtare***

Në Shqipëri ekzistojnë edhe shumë përkrahje financiare dhe jofinanciare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme nga donatorë ndërkombëtarë, të cilët kanë për qëllim promovimin e sipërmarrësisë dhe inovacionit, si dhe ndarjen e përvojave pozitive të tyre nga të cilat mund të përfitojnë ndërmarrjet në Shqipëri. Për momentin, donatorët aktiv tek të cilët mund të aplikojnë ndërmarrjet apo ndërmarrësit nga Shqipëria, janë si në vijim (AIDA, 2019):

#### **1. Programi COSME – Programi i Europës për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, 2014-2020**

Ky program ka për qëllim përkrahjen e NVM-ve dhe përf forcimin e konkurrueshmërisë së tyre përmes 4 shtyllave kryesore: përmirësimin e qasjes në financa, në tregje, kushteve për konkurrueshmëri të qëndrueshme të NVM-ve dhe promovimin e sipërmarrjes dhe kulturës sipërmarrëse. Buxheti i këtij programi është 2,522 miliardë EURO, dhe nga ky program përfitojnë NVM-të e vendeve anëtare të BE-së, vendet kandidate, vendet që kanë tendenca të përfitojnë statusin kandidat dhe ca vende të tjera.

#### **2. EEN – Rrjeti European i ndërmarrjeve**

Ky rrjet, anëtar i së cilës është edhe Shqipëria, paraqet rrjetin më të madh në botë për konkurrueshmëri dhe sipërmarrje i cili që nga viti 2015 është bërë pjesë e COSME. EEN nxit NVM-të për të përfituar sa më shumë nga mundësitë e ndërmarrësisë në Unionin European përmes përkrahjes së tyre në fushat në vijim: ndërkombëtarizim, transferim të teknologjisë, qasje në financim, financim të kërkimit, këshilla mbi ligjet dhe standardet e BE-së, etj.

#### **3. Skema e Granteve IPARD-LIKE**

Skema e Granteve IPARD-LIKE ka për qëllim mbështetjen e sektorit agro-ushqimor, rrespektivisht rritjen e konkurrueshmërisë së këtij sektori, përgatitjen e tij për

aderimin në BE si dhe mbështetjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse shqiptare për implementimin e këtij programi në të ardhmen. Kjo Skemë e Granteve realizohet në kuadër të projektit IPA 2011 SARD-IPARD, rrespektivisht “Mbështetje e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, e cila bashkëfiancohet me 75% të mjeteve nga BE-ja të cilat i menaxhon GIZ dhe 25% nga Qeveria e Shqipërisë, të cilat i menaxhon AZHBR (Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural).

#### 4. HORIZON 2020

Ky program, i cili vlen edhe për Shqipërinë, ka për qëllim arritjen e konkurrueshmërisë globale të Evropës përmes theksit të veçantë në Kërkim Shkencor dhe Inovacion, rrespektivisht lehtësimin e barrierave të ndërmarrjeve për realizimin e inovacioneve, si dhe lehtësimin e bashkëpunimit në mes sektorit publik dhe privat për nxitjen e mëtejme të inovacionit. Ky program mbështetet nga udhëheqësit e Evropës dhe Parlamenti Evropian dhe ka një buxhet rreth 80 miliard EUR për 7 vite (2014-2020).

#### 5. PRODAPS – Programi Italo-Shqiptar për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme Në Shqipëri

Ky program i nënshkruar në mes Qeverisë Italiane dhe asaj Shqiptare, ka për qëllim të forcojë sektorin privat dhe NVM-të përmes lehtësimit të sistemit të kreditimit bankar të tyre dhe njëherit edhe rritjen ekonomike të Shqipërisë. Ky program përbëhet nga tre komponentat në vijim: Një linjë kredie 25,000,000 EUR, Një fond garancie 2,500,000 EUR dhe Asistencë teknike prej 1,756,000 EUR si fond dhuratë nga Qeveria Italiane për realizimin e këtij programi.

#### 6. GIZ-Albania

##### 6.1. PROSEED – Krijimi i Perspektivave për Punësim, Zhvillim dhe Rritje në Shqipëri, 2017-2020

Ky projekt komisionohet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ), ndërsa menaxhohet nga Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, dhe ka për qëllim promovimin e projekteve të investimit si dhe sistemit arsimor dhe formimit profesional, për të rritur mundësitë e punësimit dhe përmbushur kërkesat e tregut të punës.

- Në të kaluarën e afërme BMZ ka komisionuar edhe dy projekte të tjera, si në vijim:

6.1.1. PROSME – Rritja e konkurrueshmërisë së ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme duke promovuar inovacionin dhe sipërmarrjen, 2014-2016.

6.1.2. PROINVEST – Qeverisja e mirë ekonomike për përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri, 2015-2017.

#### 7. NTERREG - IPA CBC (Greq - Shqipëri 2014-2020)

Ky program i miratuar nga Komisioni Evropian, në vlerë prej 42 milion EUR, nga të cilat 32 milion EUR vijnë nga Instrumenti IPA i BE-së, ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e transportit dhe infrastrukturës publike, si dhe rritjen e ekonomisë lokale në rajonet kufitare Greqi-Shqipëri, duke mbështetur sipërmarrësinë përmes rritjes së konkurrencës.

8. WB EDIF (Zhvillimi i ndërmarrjeve dhe Instrumentit të Inovacionit)

Ky projekt, i ngritur përmes Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) si iniciativë e përbashkët e Komisionit Evropian, Bankës Evropiane të Investimeve, Fondit Evropian të Investimeve dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, ka për qëllim të donojë 140 milion EUR në nivel rajonal për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe Instrumentit të Inovacionit në Vendet e Ballkanit Perëndimor, përmes rritjes së financimit të NVM-ve.

9. Fond Garancie për Kreditimin e NVM-ve, Raiffeisen Bank, 2005-2019

USAID dhe Raiffeisen Bank kanë lidhur një Marrëveshje Garancie të Portofolit të Huasë prej 12 milion USD në Shqipëri, për të mbështetur qasjen e NVM-ve në mjete financiare në mënyrë që të përmirësojnë dhe zhvillojnë veprimtaritë e tyre.

10. Smart Capital, Creative Business Solution, 2016-2019

Ky projekt ka për qëllim përkrahjen e NVM-ve në sferat e përgatitjes së paketave të kredisë, zhvillimin e planeve të biznesit, zhvillimin e marketingut dhe shitjeve, si dhe promovimin e mbajtjes së shënimeve dhe kontabilitetit. Ky projekt u ofron gjithashtu edhe shërbime konsulente bankave dhe institucioneve të tjera financiare me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të cilat i ofrojnë.

11. EASI - Programi për Punësimin dhe Inovacionin Social

Ky program i BE-së ka për qëllim mbështetjen e vendeve anëtare dhe potenciale të BE-së në realizimin e reformave sociale dhe të punësimit në nivel evropian, kombëtar, rajonal dhe lokal. Buxheti i përgjithshëm i këtij programi do të jetë rreth 500 milion EUR për periudhën 2014-2020 dhe është i ndarë në 3 programet në vijim: Progress – 61% e buxhetit, Inovacioni social – 18% dhe Eksperimentimi i politikës sociale – 21%.

12. EURES – Shërbimet Evropiane të Punësimit

Ky projekt financohet nga BE, dhe ka për qëllim ofrimin e mjeteve të modernizuara për vet-shërbim për punëkërkuarit dhe punëdhënësit. Buxheti i përgjithshëm i tij është rreth 20 milion EUR në vit, ku një pjesë e tij është ndarë për modernizimin e Portalit EURES ndërsa pjesa tjetër për Zhvillimin e Skemave të Mobilitetit. Aktivitetet kryesore në nivel ndërkufitare financohen nga EASI, ndërsa ato ndërkombëtare nga Fondi Social Evropian.

13. European Progress Microfinance Facility, 2014-2020



Ky projekt financohet nga BE, dhe ka për qëllim rritjen e përkrahjes për ofruesit e mikrokredisë, rrespektivisht sigurimin e fondeve për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve mikrofinanciare, për zhvilluar tregun e investimeve sociale dhe lehtësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet shoqërore.

Për shumicën programeve të mësipërme, aplikuesit potencial mund të drejtohen për ndihmë tek agjencitë në vijim: Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) dhe Agjenca Rajonale e Zhvillimit (ARZh).

### 3.2 Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në Kosovë

Në Republikën e Kosovës përkrahjet financiare dhe jo financiare të NVM-ve ofrohen nga institucionet në vijim: Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (NIM), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Agjencia e Punësimit (APRK), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe Qendra e Inovacionit (ICK) dhe projektet donatore ndërkombëtare.

*Tabela 6 Buxhetet vjetore të institucioneve të Kosovës për përkrahje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (EUR)*

	2014	2015	2016	2017	2018
MIN <sup>4</sup>	-	-	-	-	20,000,000 <sup>5</sup>
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Agjencia e Punësimit (APRK)	6,152,937	5,859,048	5,206,411	6,607,595	6,330,766
- Shërbimet e punësimit	4,383,511	4,378,288	4,100,948	5,099,019	5,198,479
- Shërbimet e aftësisë profesionale	1,769,426	1,480,760	1,105,463	1,508,576	1,132,287
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)	-	-	-	-	5,200,000
Qendra e Inovacionit (ICK)	400,000	400,000	400,000	400,000	400,000

*Adaptuar nga: Buxhetet vjetore të institucioneve përkatëse*

#### **Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN)**

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë çdo vit harton një program për përkrahje në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë nëpërmjet granteve dhe subvencioneve të ndryshme, me qëllim të promovimit të inovacionit dhe ndërmarrësisë, investimit në

<sup>4</sup> Themeluar në 2018.

<sup>5</sup> Buxheti total (në pamundësi për të gjetur buxhetin e destinuar vetëm për përkrahjet që i ofron)

hulumtim dhe zhvillim, zhvillimit dhe rritjes së kapaciteteve konkurruese të NVM-ve, ngritjes së pjesëmarrjes së të rinjëve në të bërit biznes, rritjen e prodhimtarisë vendore dhe kapaciteteve eksportuese, rritjen e investimeve, hapjes së vendeve të reja të punës, etj. Buxheti i kësaj ministrie financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës (MIN, 2018), (Qeveria e Republikës së Kosovës, 2017).

Përdorues të granteve dhe subvencioneve nga ky program mund të jenë të gjithë Shoqëritë Tregtare vendore dhe ndërkombëtare të regjistruara në RK, si dhe të gjithë personat fizik dhe “start-up”-ët me të cilat MIN lidh marrëveshje për realizimin e projekteve të caktuara të cilët janë në përputhje me qëllimet e këtij institucioni. Këto lloje të përkrahjeve mund të realizohen përmes thirrjeve publike apo konkurseve për projekt-propozime, si dhe përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit mes MIN dhe përfituesit, përmes të cilave përcaktohet njëherit edhe shuma apo lartësia e mjeteve (MIN, 2018).

### ***Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Agjencia e Punësimit (APRK)***

Në R. e Kosovës, Programi vjetor për punësim realizohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit të R. së Kosovës (APRK). Ky program përgatitet nga APRK bazuar në dokumentin e politikave tri vjeçare të punësimit dhe më pas aprovohet nga Ministria, ndërsa financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Burimet plotësuese financiare mund të sigurohen nga donatorë vendas apo të huaj. Qëllimi i këtij programi është rritja e punësimit përmes llojeve të ndryshme të masave në formë të subvencioneve financiare dhe jofinanciare për të papunët (MPMS, 2018).

Masat aktive për punësim të cilat ofrohen nga institucionet e mësipërme, janë si në vijim (MPMS, 2018) (Departamenti i Punës dhe Punësimit (MPMS), 2016): Subvencionimi i pagës, ku për ku për punësimin e një personi të papunë punëdhënësit i ofrohet subvencion prej 50% të pagës mujore bruto, brenda kontratës 1 vjeçare të tij të punës; Trajnimi në punë, ku të papunësuarve të regjistruar u ofrohet trajnim sipas një plani individual të përpiluar nga Qendra e Aftësisit Profesional (QAP) në dakordim me punëdhënësin, në afat deri në 6 muaj dhe jo më shumë se 40 orë në javë dhe gjatë periudhës së trajnimit i papunësuar mund të merr kompensim financiar jo më pak se 70% e pagës minimale, për të mbuluar shpenzimet e trajnimit; Aftësimi dhe riaftësimi profesional, ku të papunëve u ofrohen paketa të ndryshme të trajnimeve pa pagesë nga QAP, ndërmarrjet ose ofruesit e jashtëm të akredituar nga 20 ditë pune deri në 6 muaj; Praktika në punë, ku i papunësuarit i angazhuar në punë praktike tek ndonjë punëdhënësi mund të merr kompensim financiar mujor jo më të vogël se paga minimale në periudhë prej 6 deri në 12 muaj por jo më shumë se 40 orë në javë; Vetëpunësimi, ku të papunët mund të shfrytëzojnë grante në vlerë prej 6000 EUR dhe njëkohësisht të përfitojnë edhe shërbime mentorimi për 12 muaj; Promovimi i ndërmarrësisë, ku të papunët mund të shfrytëzojnë grante në vlerë prej 10,000 EUR dhe njëkohësisht përfitojnë edhe shërbime mentorimi për 6 muaj, me kusht që përfituesit të

kontribuojnë personalisht me së paku 20% të mjeteve të ofruara; Punët publike; si dhe masa të tjera që kanë të bëjnë me tregun e punës.

### ***Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)***

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA është agjenci publike e dedikuar për ofrimin e shërbimeve të mbështetjes së bizneseve, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Kjo agjenci ka për qëllim promovimin dhe mbështetjen e investimeve, eksportit, turizmit, NVM-ve dhe zonave të veçanta ekonomike në Kosovë. Për realizimin e aktiviteteve të saj, në vitin 2018 kjo agjenci kishte një buxhet prej 5.2 milion EUR (OECD/ETD/EU/EBRD, 2019).

Përkrahjet kryesore të cilat u ofrohen NVM-ve dhe sipërmarrësve nga kjo agjenci, janë vauçerët e bashkëfinancimit të cilët mund të shfrytëzohen për tre qëllime: për certifikim të produkteve me një normë bashkëfinancimi prej 75%, por jo më shumë se 10,000 EUR për përfitues, vauçerë për shërbime të konsulencës me një normë bashkëfinancimi prej 50%, por jo më shumë se 50 euro në ditë për periudhë deri në 12 ditë dhe vauçerë për blerje të makinerive për prodhim me një normë bashkëfinancimi prej 75%. Për më tepër, Ministria e Tregtisë dhe industrisë/KIESA ofron edhe mbështetje për ndërmarrësit e rinj dhe gratë përmes programeve në vijim: Punë praktike në ndërmarrje, që u mundëson të sapo diplomuarve dhe studentëve një punë praktike dymojre në komunitetin e biznesit, Gara e biznes planeve, ku ndërmarrësit e rinj mund të konkurrojnë me idetë dhe biznes planet e tyre për të përfituar përkrahje për startim të biznesit, si dhe Panairi “Gratë në biznes” që realizohet për promovimin dhe inkurajimin e mëtjeshëm të grave në biznes. KIESA gjithashtu organizon edhe aktivitete për promovimin e eksportit, nga të cilat përfitojnë NVM-të (OECD/ETD/EU/EBRD, 2019), (KIESA, 2019).

### ***Qendra e Inovacionit (ICK)***

Qendra e Inovacionit Kosovë është themeluar me qëllim të përkrahjes së sipërmarrësisë, inovacionit dhe zhvillimit komercial të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, më së tepërmi të fokusuara në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Kjo qendër ka poashtu për qëllim krijimin e lidhjes në mes të komponentës së hulumtimit & zhvillimit me sektorin e biznesit në mënyrë që të krijojë vende të reja pune. Kjo qendër u ofron përkrahje në forma të ndryshme sipërmarrësve, bizneseve “start-up” dhe ndërmarrjeve ekzistuese me potencial për rritje, të tilla si: shërbime inkubimi, shërbime mentorimi, konsulencë dhe trajnime në fusha të ndryshme relevante si dhe shërbime të transferit të teknologjisë dhe

bashkëpunimit me ndërmarrje të tjera lokale, rajonale dhe ndërkombëtare (ICK, Innovation Centre Kosovo, 2019).

Në kuadër të kësaj qendre, ekziston dhe Fondi i inovacioneve i themeluar në vitin 2018 me një buxhet prej 800,000 EUR të shpërndarë në tre vite, i cili krijon dhe implementon programin e dhënies së granteve ndërmarrjeve të cilat shfrytëzojnë shërbimet e inkubimit tek kjo qendër, në mënyrë që tu ndihmojë të shndërrohen në biznese komerciale dhe të rris suksesin dhe konkurrueshmërinë e tyre. Këto grante mund të shfrytëzohen për blerjen e pajisjeve, mbulimin e pagave, pagesën shërbimeve të jashtme (konsulencë, kontabilitet, etj.), si dhe mbulimin e shpenzimeve të participimit nëpër evente të rëndësishme të biznesit (ICK, 2017). Buxheti i këtij fondi për vitin 2018 ka qenë 7.2 milion EUR, 1.2 milion EUR nga të cilat janë alokuar nga GIZ (OECD/ETD/EU/EBRD, 2019).

Për më tepër, në kuadër të kësaj qendre ekziston edhe Programi i Vauçerëve për përkrahjen e zhvillimit të bizneseve “start-up” dhe sipërmarrësve potencial të cilët do të mbështesin themelimin e “start up” bizneseve, me qëllim të rritjes së aftësive dhe konkurrueshmërisë së tyre në tregjet në të cilat veprojnë, si dhe rritjes së mundësive të vetpunësimit. Ky program poashtu vlen për “start-up”-ët dhe ndërmarrjet të cilat kanë nënshkruar kontratë për shërbime inkubimi, ndërmarrjet të cilët kanë dalë nga procesi i inkubimit, si dhe ndërmarrjet të cilat janë të regjistruara legalisht sipas ligjeve të Kosovës dhe përdorin shërbime nga ICK në momentin e aplikimit. Vauçerët e ofruar mund të shrytëzohen vetëm për shërbime konsulente të personalizuar dhe mund të jenë deri në 6000 EUR për “start-up”. Këto vauçerë do tu ndahen 10 “start-up”-ëve në periudhë prej 2 vitesh. Ky projekt financiohet 85% nga Unioni Evropian në Kosovë dhe 15% nga ICK. Procedura e aplikimit dhe përzgjedhjes është e ngjajshme me programin paraprak (ICK, 2019).

### ***Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve nga projekte donatore ndërkombëtare***

Në Kosovë, përveç formave të përkrahjeve të mësipërme, ekzistojnë edhe disa përkrahje financiare dhe jofinanciare të tjera për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme nga donatorë ndërkombëtarë , që kanë për qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e sektorit të NVM-ve. Disa nga programet aktive të donatorëve ndërkombëtar për momentin, janë si në vijim:

- COSME<sup>6</sup> – realizohet përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (KCGF).
- Horizon 2020<sup>7</sup> – menaxhohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- EASI<sup>8</sup>

---

<sup>6</sup> Projekti është sqaruar më në detaje tek pjesa e Shqipërisë.

<sup>7</sup> Ibid.

<sup>8</sup> Ibid.

- WB EDIF<sup>9</sup> – një shumë prej 35 milion eurosh është ndarë për ProCredit Bank-ën në Kosovë në formë të kredive të cilat mund të shfrytëzohen nga ana e NVM-ve (ProCredit Bank Kosovo, 2017).

### 3.3 Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në Sërbë

Në Republikën e Sërbisë korniza institucionale e përkrahjes financiare dhe jofinanciare të sektorit të NVM-ve nga burimet publike, përmes granteve dhe përmes huave me kushte të favorshme, përbëhet nga Fondi për Zhvillim dhe Agjencia për Sigurim dhe Finansim të Eksporteve (AOFI). Intitucione të tjera të rëndësishme në sistemin e ofrimit të përkrahjeve direkte për NVM-të janë edhe, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, Fondi i Inovacionit, si dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Tradicionalisht, përkrahje të rëndësishme për përmirësimin e sektorit të NVM-ve, ofron edhe Oda Ekonomike e Sërbisë. Implementimi i programeve të institucioneve të mësipërme kryesisht realizohet nga Agjencia Kombëtare për Zhvillim Rajonal (NARR) si dhe Agjencitë e Akredituara për Zhvillim Rajonal (ARRA) (Ministarstvo Privrede RS, 2015).

*Tabela 7 Buxhetet vjetore të institucioneve të Sërbisë për përkrahje të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2018<sup>10</sup> (RSD)*

Institucionet	Viti 2018
<b>Fondi për Zhvillim i Republikës së Sërbisë</b>	<b>Mbi 12,000,000,000</b>
Kredi afatgjata/garancione për subjektet juridike mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha dhe kredi/garancione për sipërmarrësit: <ul style="list-style-type: none"> <li>• kredi për investime</li> <li>• kredi për kapital të përhershëm punues</li> </ul>	
Kredi afatshkura	
Kredi për ruajtjen e likuiditetit	
Kredi për "Start-up"	
<b>Agjencia e Sërbisë për zhvillim (RAS)</b>	
Programi për përkrahje të subjekteve afariste për kyçjen në rrjetin e furnizuesve të ndërmarrjeve multinacionale	463,000,000
Programi për përkrahje financiare për përdoruesit e projekteve IPA – programi për bashkëpunim territorial	40,000,000
Programi për përkrahje të internacionalizimit të NVM-ve përmes pjesëmarrjes individuale në panairët ndërkombëtare	40,000,000
Programi për përkrahje të sektorëve të industrisë së prodhimit	50,000,000
Programi për përkrahje të ndërmarrjeve të vogla për blerjen e pajisjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, bankat tregtare dhe ndërmarrjet e lizingut	1,000,000,000
Programi për përmirësimin e bashkëpunimit dhe ngritjes së kapaciteteve në nivel rajonal dhe lokal	20,000,000
Programi për shërbime të standardizuara të mentorimit për sektorët e industrisë së prodhimit sipas metodologjisë së JICA-s	3,900,000

<sup>9</sup> Ibid.

<sup>10</sup> Në pamundësi për të gjetur buxhetet e institucioneve përkatëse në vitet paraprake

Programi për shërbime të standardizuara të mentorimit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë	25,000,000
<b>Agjencia për Sigurim dhe Finansim të Eksporteve (AOFI)</b>	
Sigurimi i Eksportit	
Lëshimi i Garancive	<b>594,500,000</b>
Kreditë Afatshkurta dhe Afatgjate	
Faktoringu	
<b>Fondi për Inovacione</b>	<b>811,408,000</b>
Programi për zhvillim të hershëm që vlen për ndërmarrjet mikro dhe të vogla private të cilët zhvillojnë inovacion teknologjik dhe të cilat kanë potencial për krijimin e pronës së re intelektuale	
Programi për bashkëfinancim të inovacioneve që vlen për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme private	701,408,000
Programi i bashkëpunimit midis shkencës dhe ekonomisë, rrespektivisht ndërmarrjeve të sektorit privat dhe organizatave publike të hulumtimit shkencor	
Programi i transferimit të teknologjisë	110,000,000
<b>Shërbimi Kombëtar i Punësimit</b>	
Ndërmjetësim në punësimin për personat që kërkojnë punë	
Orientim profesional dhe këshilla rreth planifikimit të karrierës	
Subvencione për punësim	
Përkrahje për vetëpunësim	
Stimuj për përdoruesit (personat e papunë)	
Punët publike	
Masat e politikës aktive të punësimit për personat me nevoja të veçanta	
	<b>4,550,000,000</b>

*Adaptuar nga: Buxhetet vjetore të institucioneve përkatëse*

### **Ministria e Ekonomisë**

Ministria e Ekonomisë, në përputhje me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Serbisë, posedon mjete për përkrahjen e NVM-ve, me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë së tyre dhe zhvillimit të mëtejshëm të këtij sektori, dhe njëherit tërë ekonomisë së Serbisë. Realizues të programeve themelore për përkrahjen e NVM-ve të kësaj ministrie, janë Fondin për Zhvillim, Agjencia e Serbisë për Zhvillim dhe bankat tregtare (Ministarstvo Privrede RS, 2015).

Programet për përkrahje financiare dhe jofinanciare të NVM-ve nga Ministria e Ekonomisë janë si në vijim: Financimi i ndërmarrjeve Start-Up, në bashkëpunim Fondin për Zhvillim; Financimi i përkrahjes së projekteve për zhvillim, në bashkëpunim me Fondin për Zhvillim; Paketë e shërbimeve të standardizuara për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, në bashkëpunim me Agjencinë e Serbisë për Zhvillim; Programi i tërheqjes së investimeve direkte, në bashkëpunim me Agjencinë e Serbisë për Zhvillim; dhe Financimi i përkrahjes për blerjen e pajisjeve, në bashkëpunim me bankat tregtare. Këto programe do të sqarohen më poshtë tek institucionet përkatëse, të cilët janë realizues të tyre.

### **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik është ministria përgjegjëse në Sërbë për përcaktimin dhe zbatimin e politikave të inovacionit, promovimin e ndërmarrjeve teknologjike, transferimin e njohurive dhe teknologjisë tek ndërmarrjet, zhvillimin e sistemit të përgjithshëm të inovacionit në Sërbë, si dhe rregulloret për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Buxheti i kësaj Ministrie sigurohet nga Buxheti i RS dhe projekte të tjera donatore. Kjo Ministri ofron lloje të ndryshme të përkrahjeve financiare dhe jo financiare për NVM-të në fushën e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik nëpërmjet disa programeve në bashkëpunim me institucione të tjera, në veçanti me Fondin për Inovacione.

Përveç tyre, kjo Ministri jep leje për formimin e organizatave në vijim, në të cilat NVM-të mund të anëtarësohen dhe të shfrytëzojnë shërbimet që ata i ofrojnë (MPNTR, 2015): Inkubator teknologjik, Park Teknologjik dhe Shkencor, Organizatë për stimulimin e aktiviteteve të inovacioneve në fushën e shkencës dhe teknologjisë dhe Qendër për transferim të teknologjisë. Programet e kësaj Ministrie do të sqarohen më poshtë tek pjesa e realizuesit kryesor të tyre, rrespektivisht Fondit për Inovacione.

### ***Fondi për Zhvillim i Republikës së Sërbisë***

Fondi për Zhvillim i Republikës së Sërbisë është një ndër institucionet më të vjetra i cili ka një eksperiencë shumë vjeçare në nxitjen e subjekteve afarsite dhe sipërmarrësve në Sërbë. Qëllimi kryesor i tij është inkurajimi i zhvillimit të balancuar rajonal, konkurrencës dhe likuiditetit të ekonomisë së Sërbisë, punësimit, si dhe inkurajimi i prodhimit të mallrave për eksport. Buxheti i këtij fondi sigurohet nga të hyrat e fondit, buxheti i RS, si dhe burime të tjera në përputhje me ligjin (Sluzben Glasnik RS, Zakon o Fondu za razvoj Republike Srbije, 2015).

Fondit për Zhvillim i RS bën përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme përmes shërbimeve në vijim (Fond za Razvoj RS, 2018): Kredi afatgjatë/garancione për subjektet juridike mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha dhe kredi/garancione për sipërmarrësit (në zona të zhvilluara, të pazhvilluara dhe shumë të pazhvilluara), të tilla si kredi për investime (Portal Preduzetnistva, 2019) dhe kredi për kapital të përhershëm punues (Portal Preduzetnistva, 2019), ku varësisht cilës zonë i takojnë subjektet juridike mund të shfrytëzojnë nga 1,000,000 RSD deri në 250,000,000 RSD ndërsa sipërmarrësit nga 300,000 RSD deri në 250,000,000 RSD, ku kthimi i kredisë duhet të bëhet maksimum brenda 10 viteve varësisht grejs periudhës, ndërsa norma e interesit mund të jetë nga 1% deri në 2% në nivel vjetor; kredi afatshkurtë, ku maksimumi i vlerës së kredisë që mund të meret nga institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet është 10,000,000 RSD, me një afat pagese prej 3 deri në 12 muaj dhe normë interesi prej 2.5%; kredi për ruajtjen e likuiditetit, ku maksimumi i vlerës së kredisë që mund të meret nga NVM-të dhe ndërmarrjet e mëdha është 10,000,000 RSD, me një afat pagese deri në 18 muaj dhe normë interesi prej 2.5%; si dhe kredi për "Start-up", ku ekzistojnë dy kombinime të kësaj përkrahjeje që mund të

shfrytëzohen nga NVM-të dhe sipërmarrësit: 30% mjete të pakthyeshme dhe 70% kredi nga Fondi për zhvillim të RS dhe 40% mjete të pakthyeshme dhe 60% kredi nga Fondi për zhvillim të RS për komunat jashtëzakonisht të pazhvilluara, nga totali prej 400,000 RSD deri në 6,000,000 RSD me normë interesi nga 1% deri në 2% në nivel vjetor (Portal Preduzentisva, 2019). Disa lloje të këtyre përkrahjeve ndonjëherë ofrohen në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë.

### ***Agjencia e Sërbisë për zhvillim (RAS)***

Agjencia e Sërbisë për Zhvillim është agjenci e Qeverisë së Republikës së Sërbisë, aktiviteti kryesor i së cilës është përkrahja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësve me qëllim të zhvillimit dhe fuqizimit të ekonomisë serbe nëpërmjet ofrimit të përkrahjeve direkte financiare dhe jofinanciare, promovimit të eksportit dhe zhvillimit rajonal. RAS ka bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe ka për mision kryesor informimin e sipërmarrësve në aplikimin në programe të ndryshme të përkrahjeve, si dhe bashkëpunimin me shoqatat e biznesit për të përmirësuar ekonominë e vendit. Programet dhe aktivitetet e saj, ky institucion i realizon përmes 16 agjencive të tjera rajonale të zhvillimit (RRA) (USAID & RAS, 2018).

Programet aktive për përkrahje financiare dhe jofinanciare të NVM-ve që ofrohen nga kjo agjenci për momentin, janë si në vijim (Razvojna Agencija Srbije, 2019): Programi për përkrahje të subjekteve afariste për kyçjen në rrjetin e furnizuesve të ndërmarrjeve multinacionale, me një buxhet të përgjithshëm prej 463,000,000 RSD, Programi për përkrahje financiare për përdoruesit e projekteve IPA – programi për bashkëpunim territorial, me një buxhet të përgjithshëm prej 40,000,000 RSD, Programi për përkrahje të internacionalizimit të NVM-ve përmes pjesëmarrjes individuale në panairët ndërkombëtare, me një buxhet të përgjithshëm prej 40,000,000 RSD, Programi për përkrahje të sektorëve të industrisë së prodhimit, me një buxhet të përgjithshëm prej 50,000,000 RSD, Programi për përkrahje të ndërmarrjeve të vogla për blerjen e pajisjeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, bankat tregtare dhe ndërmarrjet e lizingut, me një buxhet të përgjithshëm prej 1,000,000,000 RSD, Programi për përmirësimin e bashkëpunimit dhe ngritjes së kapaciteteve në nivel rajonal dhe lokal, me një buxhet të përgjithshëm prej 20,000,000 RSD, Programi për shërbime të standardizuara të mentorimit për sektorët e industrisë së prodhimit sipas metodologjisë së Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), me një buxhet të përgjithshëm prej 3,900,000 RSD, dhe Programi për shërbime të standardizuara të mentorimit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, me një buxhet të përgjithshëm prej 25,000,000 RSD ku procesi i mentorimit zhvillohet sipas metodologjisë së JICA-s, njëllor me programin paraprak.



## ***Agjencia për Sigurim dhe Finansim të Eksporteve (AOFI)***

Agjencia për Sigurim dhe Finansim të Eksporteve (AOFI), është agjencia zyrtare e kredive për eksport në Republikën e Sërbisë. Qëllimi i kësaj agjencie është rritja afatgjate e punësimit në eksportin e mallrave, shërbimeve dhe investimeve jashtë vendit, përkrahja e ndërmarrjeve mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha lokale dhe sipërmarrësve përmes mekanizmave të ndryshme të financimit, krijimi i një kuadri institucional për përkrahjen e eksporteve etj (AOFI, 2018).

Përkrahja e NVM-ve dhe sipërmarrësve nga kjo agjenci, realizohet përmes shërbimeve të mëposhtme (AOFI, 2018):

### **1. Sigurimi i Eksportit**

Kjo formë e përkrahjes u ndihmon ndërmarrjeve në sigurimin e kërkesave të tyre duke bërë pagesën e një përqindjeje të caktuar, në të shumtën e rasteve 85% të vlerës së faturës. Reziqet të cilat i mbulon ky sigurim janë rreziku komercial (domosdoshërisht) dhe rreziku jokomercial (opcional). AOFI përcakton limitin e kredisë për çdo blerës të ndërmarrjes që ka aplikuar për sigurim të këtillë, pasi të ketë kontrolluar bonitetin e tyre.

### **2. Lëshimi i Garancive**

Kjo formë e përkrahjes ofron lëshimin e të gjitha llojeve të garancive në rast kur klienti kërkon ndonjë lloj sigurie që do të mbulojë realizimin e eksportit. Agjencia lëshon garanci me kërkesë të personave juridik dhe sipërmarrësve, me kusht që eksportuesi të ketë realizuar eksport në vlerë prej 100,000 EUR në vitin paraprak, si dhe kontrata aktuale të jetë subjekt i një marrëveshje eksporti prej 100,000 EUR në vitin aktual. Në rastet kur rritet potenciali i klientëve të eksportit, Agjencia paguan provizion prej 0.1% deri në 1% paraprakisht në shumën e garancisë, si dhe tarifë për shqyrtimin e aplikimeve nga 0.1% deri në 1% përnjëherë, në shumën e garancisë.

### **3. Kreditë Afatshkurta dhe Afatgjate**

Kjo formë e përkrahjes ofron burime financiare për financimin e kapitalit punues të ndërmarrjeve eksportuese, si kredi afatshkurta me tarifë të miratimit nga 0.2% deri në 0.9% dhe kamatë vjetore prej 3% deri 6% dhe kredi afatgjate me tarifë të miratimit prej 0.5% deri në 1% dhe kamatë vjetore prej 3% deri 5%.

### **4. Faktoringu**

Kjo formë e përkrahjes u mundëson eksportuesve realizimin e shpejtë dhe të sigurtë të llogarive të arkëtueshme të pamaturuara duke përmirësuar likuiditetin, aftësinë kreditore dhe konkurrueshmërinë e tyre në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Varësisht prej llojeve të faktoringut, tarifat e miratimit mund të jenë prej 0.15% deri në 1% dhe kamatë vjetore prej 2% deri në 9%.

### ***Fondi për Inovacione***

Fondi për Inovacione i RS është i vetmi institucion i specializuar në përkrahjen e zhvillimit të inovacionit në vend përmes intrumenteve të ndryshme të mbështetjes financiare, teknike dhe këshillëdhënëse me qëllim të forcimit të ndërmarrjeve të reja dhe sipërmarrësve dhe forcimit të lidhjes mes kërkimit dhe zhvillimit në një rën anë, dhe sektorit të biznesit në anën tjetër, për të komercializuar inovacionet, produktet dhe shërbimet e reja dhe teknologjinë e nevojshme. E gjithë kjo, për të kontribuar në zhvillimin e tërësishëm ekonomik të vendit. Buxheti i këtij fondi sigurohet nga Buxheti i RS si dhe projekte të ndryshme të huaja donatore, të tilla si nga Unioni Evropian dhe Banka Botërore. Ky fond operon në bashkëpunim dhe nën mbikqyrje të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik (FID, 2018).

Të gjitha aktivitetet e fondit realizohen nëpërmjet programeve në vijim (FID, 2018): Programi për zhvillim të hershëm që vlen për ndërmarrjet mikro dhe të vogla private të cilët zhvillojnë inovacion teknologjik dhe të cilat kanë potencial për krijimin e pronës së re intelektuale, Programi për bashkëfinancim të inovacioneve që vlen për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme private të cilave u nevojiten mjete financiare për realizimin e ciklit të inovacionit teknologjik dhe mbulimit të shpenzimeve të larta për transferimin e kërkimeve dhe hulumtimeve në produkte komercialisht të qëndrueshme, Programi i bashkëpunimit midis shkencës dhe ekonomisë, rrespektivisht ndërmarrjeve të sektorit privat dhe organizatave publike të hulumtimit shkencor, dhe Programi i transferimit të teknologjisë, që ka për qëllim transferimin e teknologjisë me qëllim të mbështetjes së qendrave lokale të transferimit të teknologjisë, organizatave kërkimore shkencore dhe organizatave të tjera që mbështesin inovacionin. Në kuadër të programit të fundit ofrohen edhe shërbimet në vijim: vauçerë për inovacione për NVM-të, hulumtime të autorizuara dhe përkrahje për aplikim për mjete nga donator të projekteve të UE-së.

Varësisht nga programet e mësipërme, Fondi mund të mbulojë 60% deri në 85% të buxhetit të projektit të miratuar por jo më shumë se një vlerë e caktuar tek secili program, ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet nga vet aplikuesi.

Përveç programeve të mësipërme, Fondi gjithashtu realizon edhe ca aktivitete të tjera për përmirësimin e ekosistemit të inovacioneve në bashkëpunim me projekte të huaja donatore.

### ***Shërbimi Kombëtar i Punësimit***

Në Republikën e Serbisë, programi vjetor për punësim realizohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Ky program përfshinë një sërë masash të ndryshme që kanë për qëllim inkurajimin dhe rritjen e punësimit, përmirësimin e kushteve në tregun e punës dhe

institucioneve të tregut të punës, përmirësimin e cilësisë së fuqisë punëtore etj., nëpërmjet llojeve të ndryshme të subvencioneve financiare dhe jofinanciare. Poashtu, me qëllim të zhvillimit të NVM-ve, edhe subjekteve juridike u ofrohet mundësia e shfrytëzimit të ndonjëres prej masave për të lehtësuar realizimin projeksioneve të tyre të biznesit. Përveç aktiviteteve të përmendura, ky institucion kryen edhe një sërë aktivitësh të tjera, të tilla si: shpërndarja e informacioneve të ndryshme lidhur me punësimin, bashkëpunimi ndërkombëtar, menaxhimi i projekteve të ndryshme, analiza të tregut të punës, etj. (Nacionalna sluzba za zaposljavanje, 2018).

Sipas planit financiar të vitit 2019, Shërbimi Kombëtar i Punësimin ka siguruar fonde prej 4 miliard RSD nga mjetet kontribuese për rastet e papunësisë dhe 550 milion RSD nga buxheti i fondit për rehabilitim profesional dhe stimulim të personave me nevoja të veçanta. Masat aktive për punësim të cilat ofrohen nga ky institucion, janë si në vijim (Nacionalna sluzba za zaposljavanje, 2018) (Nacionalna sluzba za zaposljavanje, 2015): Ndërmjetësim në punësimin për personat që kërkojnë punë, Orientim profesional dhe këshilla rreth planifikimit të karrierës, Subvencione për punësim, ku varësisht nga zhvillimi i rajonit, punëdhënësve u ofrohen subvencione të njëhershme prej 150,000, 250,000 ose 250,000 RSD për person të papunë që do ta punësojnë, Përkrahje për vetëpunësim në vlerë prej 200,000 RSD deri në 240,000 RSD për personat e papunë, Arsimit dhe trajnim shtesë për personat e papunë, Stimuj për përdoruesit (personat e papunë) e kompensimit financiar deri në 30% të shumës totale të kompensimit financiar, Punët publike, ku kompensimi për person të anagazhuar mund të jetë deri në 22,000 RSD për muaj, Masat e politikës aktive të punësimin për personat me nevoja të veçanta, si dhe masa të tjera që synojnë punësimin ose mbajtjen e punësimin.

### ***Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve nga projekte donatore ndërkombëtare***

Në Sërbë ekzistojnë edhe shumë përkrahje të tjera financiare dhe jofinanciare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme nga donatorë ndërkombëtarë, të cilët kanë për qëllim zhvillimin e këtij sektori në Sërbë, rrespektivisht rritjen dhe zhvillimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve. Për momentin, donatorët aktiv tek të cilët mund të aplikojnë ndërmarrjet apo ndërmarrësit nga Sërbë, janë si në vijim (Portal Preduzetnistva, 2019):

- COSME<sup>11</sup> - realizohet përmes bankave komerciale në Sërbë.
- HORIZON 2020<sup>12</sup> – menaxhohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik të RS.
- WB EDIF<sup>13</sup> – në kuadër të këtij projekti, Sërbësisë i ofrohet programi i mëposhtëm:

<sup>11</sup> Projekti është sqaruar më në detaje tek pjesa e Shqipërisë.

<sup>12</sup> Ibid.

- EU për Sërbinë – Ky program i ofruar nga Bashkimi Evropian nga Instrumenti kombëtar i ndihmës për para-anëtarësim (IPA), realizues i së cilit janë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë të RS, i ofron Sërbisë një shumë fondesh prej 2 milion EUR, dhe ka për qëllim përmirësimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve përmes të përkrahjes së tyre nëpërmjet shërbimeve konsulente. Implementimi i këtij programi do të realizohet në periudhë prej 48 muaj, ku varësisht nga kategoria e NVM-ve, ata duhet të mbulojnë një pjesë të shpenzimeve të projektit, rrespektivisht deri në 60% të shpenzimeve të shërbimeve konsulente për konsulentë vendor, dhe deri në 18% të tyre për konsulentë ndërkombëtar.
- EASI – në kuadër të këtij programi Fondi Evropian i Investimeve dhe Banka e Sërbisë Erste kanë nënshkruar një marrëveshje për garanci, me qëllim të përkrahjes së ndërmarrjeve mikro në Sërbi. Kontrata do të mbulojë një portofol kredie prej 4.7 milion euro për rreth 850 mikro ndërmarrje sërbe, të cilat do të mund të shfrytëzojnë kredi me kushte të volitshme, pa garanci shtesë.
- APEX - Banka Evropiane për Investime (EIB) i ka miratuar Sërbisë kredinë e pestë me rradhë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Pas kështit të parë prej 150 milion euro të miratuar me sukses, Sërbisë i është miratuar edhe kësti i dytë prej 150 milion EUR të tjera i cili është destinuar për investime për blerjen e aseteve materiale, jomateriale, zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe kapital të përhershëm pune. NVM-ve mund tu aprovohen kredi deri në 12,500,000 EUR, me afat përdorimi së paku dy vite, grejs periudhë 2 vite dhe normë interesi të ndryshueshme, por rrespektivisht rreth 3%.
- EU PRO – Ky program i ofruar nga Unioni Evropian, realizues i së cilit janë Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve (UNOPS) dhe Qeveria e RS, ka filluar nga viti 2018 dhe do të zgjasë në 3 vitet në vijim, dhe ofron një shumë fondesh prej 25 milion EUR për përmirësimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve ekzistuese dhe të reja dhe rritjen e produktivitetit të tyre përmes blerjes së pajisjeve të reja dhe ofrimit të shërbimeve shtesë, si dhe mbështetje për organizatat të cilat do të përkrahin sektorin e biznesit.

---

<sup>13</sup> Ibid.

## 4. Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve në R. e Maqedonisë

Në R. e Maqedonisë ekzistojnë disa institucione të cilat në programet vjetore të tyre kanë buxhete të përcaktuara për mbështetje dhe subvencionim të NVM-ve. Këto buxhete vjetore përgatiten nga vet institucionet, mirëpo më pas aprovohen nga qeveria e R. së Maqedonisë.

Për nevoja të studimit, në vijim do të analizojmë buxhetet e institucioneve përkatëse dhe llojet e përkrahjeve financiare dhe jofinanciare që ata i ofrojnë për mbështetjen e vazhdueshme të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

### 4.1 Ministria e Ekonomisë

Krahas qëllimeve të tjera, Ministria e Ekonomisë ka për qëllim edhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në vend, dhe ky fakt mbështetet nga llojet e ndryshme të përkrahjeve që i ofron, me qëllim të hapjes së vendeve të reja të punës dhe rritjes së nivelit të pagave, rritjes dhe përmirësimit të potencialit të NVM-ve, sigurimit të një sistemi dinamik të sipërmarrjes dhe inovacioneve, si dhe rritjes së konkurrueshmërisë të NVM-ve, si faktorë kyç të rritjes ekonomike (Ministria e Ekonomisë, 2019).

Ministria e Ekonomisë është e përbërë nga sektorë të ndryshëm, por sektori për përkrahje të sipërmarrësisë dhe konkurrueshmëri së NVM-ve, është sektori përgjegjës për mbështetjen e të njejtave në fusha të ndryshme. Programi përkatës i zhvilluar nga ana e Ministrisë për këtë qëllim, buxheti i së cilës sigurohet nga mjetet e buxhetit të qeverisë së R. së Maqedonisë, titullohet “Programi për konkurrueshmëri, inovacione dhe sipërmarrësi”, i cili ngërthen në vete tre kategori të përkrahjes së aktiviteteve të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si në vijim:

- A. Përkrahja dhe zhvillimi i NVM-ve
- B. Implementimi i politikave industriale
- C. Përkrahja dhe zhvillimi i kllasterëve

Në tabelën në vijim janë prezantuar buxhetet vjetore të këtij sektori për periudhën 2014-2018, sipas kategorive të përkrahjeve, gjegjësisht masave të planifikuara dhe implementuara në vitet përkatëse.

*Tabela 8 Buxhetet vjetore të sektorit për përkrahje të sipërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë së NVM-ve pranë ME-së dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (MKD)*

KATEGORITË E MBËSHTETJES SË AKTIVITEVE/VITI	2014	2015	2016	2017	2018
<b>A. PËRKRAHJA DHE ZHVILLIMI I NVM-VE</b>	<b>12,390,000</b>	<b>8,890,000</b>	<b>8,890,000</b>	<b>24,890,000</b>	<b>38,390,000</b>
Masa 1: Përkrahje e zanaetçive në RM	<b>1,300,000</b>	<b>1,000,000</b>	<b>2,510,000</b>	<b>3,510,000</b>	<b>3,410,000</b>
- Bashkefinancim i shpenzimeve të zanaetçive dhe të atyre që ushtrojnë veprimtarinë e zanaetçive	-	1,000,000	1,600,000	2,100,000	2,200,000
- Bashkefinancimi i projekteve të odave të zanaetçive për zhvillim dhe promovim të zanateve në R. e Maqedonisë	-	-	910,000	1,410,000	1,210,000
Masa 2: Përkrahje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme	-	-	-	11,900,000	20,000,000
Masa 3: Përkrahje financiare për gratë sipërmarrëse	2,400,000	1,800,000	2,000,000	2,400,000	2,000,000
Masa 4: Rimbursim i një pjese të shpenzimeve të subjekteve të biznesit për certifikim me sisteme të kualitetit sipas ISO standardeve	300,000	300,000	800,000	800,000	800,000
Masa 5: Përkrahje financiare për certifikim me sistemin HALAL	3,100,000	3,350,000	1,800,000	1,400,000	2,200,000
Masa 6: Bashkefinancim i projekteve për zhvillim dhe përkrahje të NVM-ve dhe promovim të sipërmarrësisë në R. e Maqedonisë	2,000,000	1,000,000	1,200,000	3,500,000	2,000,000
Masa 7: Bashkefinancim i projekteve për aktivitete të programeve të rrjeteve të biznes engjujve	-	-	-	800,000	1,000,000
Masa 8: Përkrahje financiare për themelimin e një parku të ri teknologjik në kuadër të universiteteve në R. e Maqedonisë	-	-	-	-	1,500,000
Masa 9: Bashkefinancim i një pjese të shpenzimeve të projekteve të	-	-	-	-	1,000,000

miratuara sipas programeve EU COSME					
Masa 10: Përkrahje financiare e NVM-ve për shfrytëzimin e shërbimeve konsulente	-	-	-	-	1,200,000
Masa 11: Bashkëfinancim i një pjese të shpenzimeve të ndërmarrjeve për blejen e pajisjeve, instrumenteve, mjeteve të cilat do të përdoren ekskluzivisht për trajnime dhe mësim të personave për fitimin e aftësive dhe kualifikimeve	-	-	-	-	2,400,000
Masa 12: Bashkëfinancim i një pjese të shpenzimeve për edukimin e të punësuarve	-	-	-	-	600,000
Masa 13: Aktivitete promovuese	200,000	50,000	280,000	280,000	280,000
Masa: Përkrahje financiare për HACCP, ekipin për implementim, mirëmbajtje dhe modifikim të HACCP sistemit	200,000	160,000	300,000	300,000	-
Masa: Organizimi i garës "Bëhu perspektiv, fillo biznesin tend"	1,200,000	1,020,000	-	-	-
Masa: Përkrahje financiare për biznese fillestare të themeluara nga sipërmarrës të ri	900,000	-	-	-	-
Masa: Kofinancim i organizimeve të trajnimeve të specializuara për sektorin e automobilistikës, tekstilit, ushqimores dhe përpunimit të metalit	790,000	-	-	-	-
<b>B. IMPLEMENTIMI I POLITIKËS INDUSTRIALE</b>	<b>1,700,000</b>	<b>1,560,000</b>	<b>1,500,000</b>	<b>1,500,000</b>	<b>3,800,000</b>
Masa 1: Përkrahje e rritjes së konkurrueshmërisë së subjekteve afariste të industrisë përpunuese	-	<b>1,240,000</b>	-	-	<b>3,100,000</b>
– Rimbursim i një pjese të shpenzimeve të subjekteve afariste për zhvillimin e hapsirës punuese, të produkteve apo tregut	-	1,240,000	-	-	2,500,000
– Kofinancim i organizimit të trajnimeve speciale - trajnime detajore në fushën e teknologjisë për sektorët në vijim: automobilistikë, tekstil, industrisë së përpunimit të ushqimit dhe asaj të përpunimit të metalit.	-	-	-	-	600,000
Masa 2: Përgatitje e dokumenteve strategjike dhe analizave për nevojat e industrisë	-	-	-	-	700,000
Masa: Përkrahje për zhvillimin e	1,700,000		1,200,000	1,200,000	-

industrië në RM					
Masa : Përkrahje për patenta	-	320,000	300,000	300,000	-
<b>C. PËRKRAHJA DHE ZHVILLIMI I KLLASTERËVE</b>	<b>1,600,000</b>	<b>1,620,000</b>	<b>1,600,000</b>	<b>1,600,000</b>	<b>5,000,000</b>
Masa 1: Përkrahje e projekteve nga organizatat kllastere	1,600,000	1,620,000	1,600,000	1,600,000	5,000,000
<b>TOTALI:</b>	<b>15,690,000</b>	<b>12,070,000</b>	<b>11,990,000</b>	<b>27,990,000</b>	<b>47,190,000</b>

*Adaptuar nga: Buxhetet vjetore të Ministrisë së Ekonomisë*

Nga analiza e të dhënave të mësipërme mund të vërejmë se buxheti i sektorit për përkrahje të sipërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë së NVM-ve në vitet 2014-2016 tregon rrënie kontinuale nga 15,690,000 MKD deri në 11,990,000 MKD. Situata ka qenë e ngjajshme edhe me buxhetin e vitit 2017, i cili në versionin e parë ka qenë plotësisht i ngjajshëm me atë të vitit 2016, mirëpo si rezultat i ribalancimit të buxhetit të qeverisë, për së pari herë janë bërë ndryshime drastike dhe është përcaktuar një buxhet gati se tre herë më i lartë se viti paraprak, rrespektivisht 24,890,000 MKD. Rritja e buxhetit ka vazhduar të rritet edhe për vitin 2018 dhe 2019.

Ndryshimi pozitiv i buxhetit është realizuar vetëm në kategorinë e parë të përkrahjeve, rrespektivisht në kategorinë “A. Përkrahja dhe zhvillimi i NVM-ve”, tek i cili ka rritje të dukshme në dy vitet e fundit, si dhe në planifikimin e buxhetit të vitit 2019. Ky ndryshim i dedikohet masës së re të promovuar në vitin 2017, të titulluar “Përkrahje financiare e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

Sa i përket vitit 2019, Ministria e Ekonomisë ka planifikuar një buxhet prej 53,180,000 MKD për programin për përkrahjen e sipërmarrësisë, inovacionit dhe konkurrueshmërisë së NVM-ve, i cili ndahet në kategoritë përkatëse, si në vijim:

- A. Përkrahja dhe zhvillimi i NVM-ve – 41,280,000 MKD
- B. Implementimi i politikave industriale - 3,700,000 MKD
- C. Përkrahja dhe zhvillimi i kllasterëve – 7,000,000 MKD

Në këtë vit për herë të parë shtohet si kategori e veçantë edhe kategoria në vijim:

- D. Përgjegjësia shoqërore – 1,200,000 MKD

Një elaborim më detajor i masave të mësipërme të Ministrisë së Ekonomisë për përkrahjen e NVM-ve do të bëhet më poshtë, duke u bazuar në programën vjetore të vitit 2018 të këtij institucioni.

A. Përkrahje e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, ku bëjnë pjesë masat në vijim (Gazeta zyrtare e RM-së, 2018):

1. Masa 1: Përkrahje e zanaetçive në R. e Maqedonisë
  - 1.1. Bashkefinansim i shpenzimeve të zanaetçive dhe të atyre që ushtrojnë veprimtarinë e zanaetçive



Për aktivitetet lidhur me këtë masë, rimburohen një pjesë e shpenzimeve në vlerë prej 70% të shpenzimeve të arsyetuara, por jo më shumë se 150,000 MKD për aplikant.

- 1.2. Bashkëfinancimi i projekteve të odave të zanaetçive, fondacioneve dhe shoqërive të qytetarëve për zhvillim dhe promovim të zanateve në R. e Maqedonisë  
Për aktivitetet lidhur me këtë masë, rimburohen një pjesë e shpenzimeve të projektit, por jo më shumë se 150,000 MKD për aplikant
2. Masa 2: Përkrahje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme  
Kjo masë vlen për NVM-të e themeluara nga qytetarët e R. së Maqedonisë, të cilët do të punësojnë më tepër se 3 persona përmes subvencionimit të 70% të shpenzimeve të arsyetuara, por jo më shumë se 300,000 MKD për aplikant (diku edhe më pak).
3. Masa 3: Përkrahje financiare për grate sipërmarrëse  
Kjo masë vlen për NVM-të e themeluara në pronësi (mbi 50%) dhe udhëheqje të pronareve femra, nëpërmjet bashkëfinancimit të 70% të shpenzimeve të arsyetuara, por jo më shumë se 150,000 MKD për aplikant (diku edhe më pak).
4. Masa 4: Rimbursim i një pjese të shpenzimeve të subjekteve të biznesit për certifikim me sisteme të kualitetit sipas ISO standardeve  
Rimbursim i një pjese të shpenzimeve në vlerë prej 70% të shpenzimeve të arsyetuara, por jo më shumë se 100,000 MKD për aplikant/ndërmarrje.
5. Masa 5: Përkrahje financiare për certifikim me sistemin HALAL,  
Rimbursim i një pjese të shpenzimeve në vlerë prej 70% të shpenzimeve të arsyetuara, por jo më shumë se 200,000 MKD për aplikant/ndërmarrje.
6. Masa 6: Bashkëfinancim i projekteve për zhvillim dhe përkrahje të NVM-ve dhe promovim të sipërmarrësisë në R. e Maqedonisë  
Bashkëfinancim i një pjese të shpenzimeve të projektit deri në 200,000 MKD për projekt.
7. Masa 7: Bashkefinancim i projekteve për aktivitete të programeve të rrjeteve të engjujve të biznesit  
Rimbursim i një pjese të shpenzimeve në vlerë prej 70% të shpenzimeve të arsyetuara, por jo më shumë 500,000 MKD për aplikant.
8. Masa 8: Përkrahje financiare për themelimin e një parku të ri teknologjik në kuadër të universiteteve në R. e Maqedonisë  
Bashkëfinancim i 75% të mjeteve të nevojshme, por jo më shumë se 1,500,000 MKD për aplikant.
9. Masa 9: Bashkëfinancim i një pjese të shpenzimeve të projekteve të miratuara sipas programeve EU COSME

Bashkëfinancim deri në 20% të mjeteve të nevojshme të konzorciumeve/ndërmarrjeve që aplikojnë apo kanë aplikuar për programin EU COSME për projekte lidhur me përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si mjete të nevojshme për bashkëfinancimin e projektit, por jo më shumë se 1,000,000 MKD.

10. Masa 10: Përkrahje financiare e NVM-ve për shfrytëzimin e shërbimeve konsulente
  - Përkrahje e projektit për mentorim të agjencisë japoneze JICA në vlerë prej 600,000 MKD
  - Përkrahje e shërbimeve konsulente për NVM-të deri në 70% të mjeteve të arsyetuara, por jo më shumë se 60,000 MKD për aplikant.
11. Masa 11: Bashkëfinancim i një pjese të shpenzimeve të ndërmarrjeve për blejen e pajisjeve, instrumenteve, mjeteve të cilat do të përdoren ekskluzivisht për trajnime dhe mësim të personave për fitimin e aftësive dhe kualifikimeve  
Rimbursim i një pjese të mjeteve në vlerë prej 50% të mjeteve të arsyetuara, por jo më shumë se 1,200,000 MKD veçmas.
12. Masa 12: Bashkëfinancim i një pjese të shpenzimeve për edukimin e të punësuarve  
Bashkëfinancim i një pjese të shpenzimeve për trajnimet që do të ndjekin personat e punësuar për zhvillim profesional, edhe atë deri në 50% të shpenzimeve të arsyetuara, por jo më shumë se 12,000 veçmas.
13. Masa 13: Aktivitete promovuese  
Promovimi i programës së Ministrisë së Ekonomisë për përkrahjet e mësipërme përmes organizimit të prezantimeve në të gjitha rajonet.

Siç mund të vërehet në tabelën e mësipërme, në këtë kategori ekzistojnë edhe disa masa të tjera të cilat kanë qenë aktive të vitet e mëparshme, por jo në vitin 2018, të tilla si Përkrahje financiare për HACCP, ekipin për implementim, mirëmbajtje dhe modifikim të HACCP sistemit, Organizimi i garës "Bëhu perspektiv, fillo biznesin tend", Përkrahje financiare për biznese fillestare të themeluara nga sipërmarrës të ri dhe Kofinancim i organizimeve të trajnimeve të specijalizuara për sektorin e automobilistikës, tekstilit, ushqimores dhe përpunimit të metalit.

## B. Implementimi i politikës industriale

1. Masa 1: Përkrahje e rritjes së konkurrueshmërisë së subjekteve afariste të industrisë përpunuese:
  - 1.1. Rimbursim i një pjese të shpenzimeve të subjekteve afariste për zhvillimin e hapsirës punuese, të produkteve apo tregut  
Rimbursim i shpenzimeve në vlerë prej 75% të shpenzimeve të arsyetuara, por jo më shumë se 180,000 MKD për aplikant.

1.2. Kofinancim i organizimit të trajnimeve speciale - trajnime detajore në fushën e teknologjisë për sektorët në vijim: automobilistikë, tekstil, industrisë së përpunimit të ushqimit dhe asaj të përpunimit të metalit.

Rimbursim i shpenzimeve të trajnimeve në vlerë prej 75% të shpenzimeve të arsyetuara

## 2. Përgatitje e dokumenteve strategjike dhe analizave për nevojat e industrisë

Kjo masë nenkupton angazhimin e konsultantëve për zhvillimin e dokumenteve strategjike dhe analizave të nevojshme.

Siç mund të vërmë në tabelën e mësipërme në këtë kategori ekzistojnë edhe disa masa të tjera të cilat kanë qenë aktive të vitet e mëparshme, por jo në vitin 2018, të tilla si përkrahje për zhvillimin e industrisë në RM dhe përkrahje për patenta.

## C. Përkrahje dhe zhvillim i shoqatave të kllastereve

### 1. Masa 1: Përkrahje e projekteve të shoqatave të kllastereve

Rimbursim i një pjese të shpenzimeve të arsyetuara në vlerë prej 75% të projektit, por jo më shumë se 1,000,000 MKD për aplikant.

Informimi i ndërmarrjeve për të konkurruar për ndonjë nga masat e mësipërme bëhet përmes shpalljeve publike. Varësisht nga masa e caktuar, dokumentacioni i cili në përgjithësi kërkohet për të aplikuar për ndonjë prej tyre, është si në vijim: Formulari për kërkesë, Formulari për projekt, Formulari për deklaratë për përdorim ose jo përdorim të ndonjë subvencionit paraprak nga ME, lista momentale e të punësuarve marrë nga Agjensioni për punësim, statusi i aplikantit, certifikatë biznesi nga Regjistri qendror, si dhe vëtetimi nga DAP. Dokumentacioni përkatës dërgohet tek Ministria e Ekonomisë dhe më pas shqyrtohet nga Komisioni i cili formohet nga ministri i ekonomisë. Përzgjedhja e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet sipas shpalljes publike bëhet sipas principit “i pari vjen, i pari shërbehet”, rrespektivisht sipas rradhës së dorëzimit të dokumentacionit, deri sa ka mjete në disponim. Në momentin kur përfundojnë mjetet, Ministria informon publikun përmes ueb faqes së saj (Ministria e Ekonomisë, 2019).

## 4.2 Ministria për Punë dhe Politikë sociale, Agjencia e Punësimit dhe UNDP (Programi zhvillimor i Kombeve të Bashkuara) – Masat aktive për punësim

Në R. e Maqedonisë, masat aktive për punësim realizohen nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me Agjencinë e Punësimit dhe UNDP-në (Programi i Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara) dhe kanë për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës dhe zvogëlimin e papunësisë në RM, përmes llojeve të ndryshme të përkrahjeve financiare dhe jofinanciare të cilat kontribuojnë në realizimin e këtij qëllimi. Kështu, kandidatëve potencial, u ofrohet mundësia që të kalojnë nëpër trajnime të ndryshme, të rikualifikohen, si dhe të kualifikohen më tej, ndërsa menjëherë pas kësaj kanë të drejtën të shfrytëzojnë

ndonjë masë tjetër që do tu sigurojë një punësim të drejtëpërdrejtë (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, 2014-2018). Gjithashtu, prioritet i qeverisë së RM-së mbi të gjitha, është zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, prandaj nëpërmjet këtyre masave, edhe subjekteve juridike u ofrohet mundësia e shfrytëzimit të ndonjërës prej tyre, me qëllim të realizimit të projeksioneve të biznesit që kanë.

Kjo kornizë e politikave për punësim në R. e Maqedonisë është definuar përmes Programës së Qeverisë së R. së Maqedonisë, Programës për reforma në punësim dhe politikën sociale 2020, Strategjisë nacionale për punësim në RM 2016-2020 dhe Planit akcional për punësim të rinjëve 2016-2020, në korrelacion me obligimet që dalin nga Pakti global për vende pune i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), reformave në sistemin e mbrojtjes sociale, etj. Buxheti për këto masa sigurohet përsëri nga qeveria e RM-së kurse menaxhimi i procesit të implementimit realizohet nga UNDP në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e punësimit dhe Agjencinë për përkrahje të sipërmarrësisë.

Në tabelën në vijim janë prezantuar buxhetet vjetore të masave aktive për punësim për periudhën 2014-2018.

*Tabela 9 Buxhetet vjetore të Planit operativ për masat aktive për punësim dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (MKD)*

KATEGORITË E MBËSHTETJES SË AKTIVITEVE/VITI	2014	2015	2016	2017	2018
1. Programi për vetëpunësim	200,649,847	202,454,100	257,218,300	313,354,350	382,415,418
2. Përkrahje financiare për subjektet juridike (ndërmarrjet mikro dhe të vogla dhe zanaetçinjtë) për krijimin e vendeve të reja të punës <sup>14</sup>	10,725,653	-	-	-	-
3. Subvencionimi i punësimit <sup>15</sup>	240,170,000	236,400,000	240,182,200	229,642,650	468,326,500
4. Programi për përgatitje për punësim <sup>16</sup>	59,250,900	161,296,260	162,754,550	218,121,100	99,399,000
5. Anketë për vende të lira pune	161,200	161,200	-	-	-
6. Programi për punë të dobishme komunale <sup>17</sup> /Programi për angazhim në punë në 2018	3,600,000	11,600,000	8,940,000	7,170,000	40,719,500

<sup>14</sup> Shndërruar në "Përkrahje e rritjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për krijimin e vendeve të reja të punës" nga viti 2015 e më pas, dhe bëhet pjese e kategorisë "Subvencionimi i punësimit"

<sup>15</sup> Shdërruar në "Subvencionimi i vendeve të punës" në vitin 2016, dhe më pas në "Përkrahje për krijimin e vendeve të reja të punës" në vitin 2018.

<sup>16</sup> Shndërruar në "Trajnime" në vitin 2016 e më pas.

<sup>17</sup> Shndërruar në "Programi për angazhim në punë" në vitin 2018.

7.	Pilot programe të ndryshme	8,030,640	17,255,052	24,192,000	4,926,000	-
8.	Shërbime për punësim	-	13,264,800	14,164,800	34,774,800	9,886,200
9.	Promovimi i programeve dhe masave nga Plani Operativ	2,700,000	2,495,825	1,680,000	5,118,900	-
10.	Shpallje dhe njoftime publike	500,000	500,000	500,000	500,000	-
11.	Anketë për nevojat e aftësive në tregun e punës	-	-	-	3,000,000	-
12.	Detyrime të mbetura nga viti paraprak	-	15,000,000	-	56,600,000	-
<b>TOTALI:</b>		<b>525,788,840</b>	<b>660,427,237</b>	<b>709,631,850</b>	<b>873,207,800</b>	<b>1,000,746,618</b>

*Adaptuar nga: Buxhetet vjetore të Planit operativ për masat aktive për punësim*

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, mund të vërejmë se buxheti për masat aktive për punësim ka pasur rritje kontinuale nga viti 2014, ku ky buxhet ishte vetëm 525,788,240 MKD, deri në vitin 2018, ku ky buxhet ka tejkaluar shumë prej 1 miliard MKD. Në qoftë se bëjmë krahasim të buxhetit të vitit 2018 me atë fillestar të vitit 2007 (297,600,000), mund të vërejmë se ka pasur rritje më shumë se 3.5 herë.

Për më tepër, është evidente se me kalimin e viteve, gjithashtu janë implementuar disa pilot projekte të ndryshme me qëllim të stimulimit të vendeve të reja të punës dhe mbështetjes së afaristëve në forma të ndryshme që të formalizojnë punësimet dhe të hapin vende të reja të punës.

Shtylla e parë dhe më e rëndësishme e Planit operativ është masa e Vetëpunësimit/Formalizimit të bizneseve, poashtu me një buxhet në rritje kontinuale nga fillimi i saj në vitin 2007. Kjo masë, brenda një viti kalendarik siguron krijimin e rreth 1000 deri në 1300 bizneseve të reja si dhe krijimin e rreth 1500 vendeve të reja të punës.

Shtylla e dytë më e rëndësishme e Planit operativ janë punësimet e subvencionuara, të cilat kanë pasur një buxhet pothuajse konstant gjatë viteve të implementimit, rrespektivisht rreth 250 milion MKD. Në vitin 2018, kjo masë është rritulluar si masa për krijimin e vendeve të reja të punës, në të cilën janë inkorporuar masat standarde që implementoheshin në vitet paraprake, si dhe janë shtuar masat nga Plani ekonomik i qeverisë për rritje dhe zhvillim të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Ky ndryshim mund të vërehet lehtë edhe nga tabela, ku buxheti për këtë masë në vitin 2018 është dyfish më i lartë se në vitet paraprake, rrespektivisht 468,326,500 MKD.

Një elaborim më detajor i masave aktive për punësim nga tabela e mësipërme, mund të shihet në vijim (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, 2014-2018):

#### 1. Programi për vetëpunësim

Përdorues të kësaj mase mund të jenë personat e papunësuar, personat e papunësuar deri në 29 vjet si dhe personat e papunësuar me nevoja të veçanta. Gjatë periudhës së studimit grantet kanë variuar nga 201,600 MKD deri në 307,500 MKD për aplikant të cilët mund të shfrytëzohen për blerjen e pajisjeve apo repromaterialeve, punësime shtesë si dhe shërbime mentorimi deri në 120 orë. Në vitet kur në kuadër të kësaj mase ka ekzistuar edhe mundësia e punësimit të një personi shtesë, ndërmarrjet që janë përgjedhur në nivel të shtetit për të punësuar edhe një person shtesë, kanë fituar grante shtesë prej 92,000 MKD të cilat kanë mundur ti shfrytëzojnë për të njejtat qëllime. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të konkurrencës, si dhe ndjekjes me sukses së të gjitha aktiviteteve në të gjitha fazat e kësaj mase. Si dokumentacion për aplikim, kërkohet vetëm Formulari për aplikim, i plotësuar si duhet.

2. Përkrahje financiare për subjektet juridike (ndërmarrjet mikro dhe të vogla dhe zanaetçinjtë) për krijimin e vendeve të reja të punës

Përdorues të kësaj mase mund të jenë ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme dhe zanaetçitë, me qëllim që nëpërmjet përkrahjes që do të marrin, do të krijojnë vende të reja pune, me ç'rast do të përmirësojnë kualitetin e produkteve dhe shërbimeve të tyre dhe do të qasen në tregje të reja. Përkrahja financiare në formë të granteve të pakthyeshme është 92,000 MKD për çdo vend të ri të hapur pune nga ana e ndërmarrjes aplikuese dhe mund të shfrytëzohet për blerjen e pajisjeve apo materialeve, ndërsa ndërmarrja është e detyruar ta mbajë në punë të punësuarin e ri për së paku 12 muaj. Nga viti 2015, kjo masë është bërë pjesë e kategorisë së 3 – Subvencionimi i punësimit.

3. Subvencionimi i punësimit / Subvencionimi i vendeve të punës / Përkrahje për krijimin e vendeve të reja të punës

Përdorues të kësaj mase mund të jenë personat e papunë të cilët u përkasin kategorive të ndryshme dhe kërkojnë punë në mënyrë aktive, si dhe ndërmarrjet të cilët do ti punësojnë të njejtët dhe njëherit do të marrin grante për punësimin e tyre. Gjatë periudhës 2014-2018, në këtë kategori të përkrahjes kanë marrë pjesë masa të cilat janë përsëritur nga viti në vit, por edhe masa të tjera të cilat kanë qenë aktive vetëm në vite të caktuara. Një përmbledhje e tyre është si në vijim: Subvencionimi i punësimit, Subvencionimi i punësimit të fëmijëve pa prindër, Përkrahje e punësimeve të personave me nevoja të veçanta, Subvencionimi i punësimit të personave të rinj deri në 29 vjet, Programi për kompensim parash me kusht për subvencionimin e punësimit të personave me rrezik social, Subvencionimi i punësimit të personave të rinj deri në 29 vjet përmes lirimimit nga kontributet, Përkrahje financiare për mobilitet të fuqisë punëtore, Subvencionimi i punësimit të personave të rinj deri në 29 vjet përmes lirimimit nga kontributet/tatami personal - Projekti "Maqedonia punëson", Subvencionimi i punësimit për personat e papunë – Projekti "Maqedonia punëson 2", Përkrahje për ndërmarrjet

me rritje të shpejtë - “Gazellë”, Përkrahje financiare për çerdhet private të fëmijëve, Përkrahje financiare për shtëpitë private të pleqve, Subvencionimi i pagave, Punësim dhe rritje e subjekteve juridike dhe Programi i qeverisë – “Krijimi i vendeve të reja të punës”.

#### 4. Programi për përgatitje për punësim / Trajnime

Përdorues të trajnimeve të mëposhtme mund të jenë personat e evidentuar si të papunë tek Agjencia e Punësimit dhe punëdhënësit. Gjatë periudhës 2014-2018, në këtë kategori të përkrahjes kanë marrë pjesë trajnime të cilat janë përsëritur nga viti në vit, por edhe trajnime të tjera të cilat kanë qenë aktive vetëm në vite të caktuara. Një përmbledhje e tyre është si në vijim: Trajnim në vendin e punës për punëdhënësit të njohur, Trajnim në vendin e punës për punëdhënësit të njohur me punësim të subvencionuar, Trajnim për përmbushjen e profesioneve të kërkuara në tregun e punës, Trajnim për përmbushjen e profesioneve të kërkuara në tregun e punës nga sfera e komunikacionit, Trajnim për aftësi të avancuara në fushën e IT-së, Punë praktike, Edukim për fillim të biznesit, Trajnime motivuese, Trajnim për përmbushjen e profesioneve të kërkuara në tregun e punës në qendra private të trajnimit, Anketë për nevojat e aftësive në tregun e punës, Trajnim për aftësi themelore për punësim (gjuhë të huaja dhe kompjuterë), Trajnim për përmbushjen e profesioneve të kërkuara në tregun e punës (për persona të shurdhër dhe verbër), Trajnim për vozitës të kategorive C dhe E, Trajnim për përfitimin e aftësive në zanate të vjetra, Punë praktike 1 dhe 2, Përgatitje për punë për personat në proces edukativo-arsimor (nxënës të shkollave të mesme dhe student), Trajnim për përfitimin e kualifikimeve sipas kërkesave momentale të tregut të punës (sektori i shërbimeve dhe industrisë), Trajnim në sferën e sigurimit, Trajnim në sferën e turizmit, Trajnim për përmbushjen e profesioneve të kërkuara në tregun e punës për persona me invaliditet, Trajnim për vozitës të kategorive C, D dhe E, Trajnime për gjuhë të huaja me certifikim, Trajnim dhe këshillim për sipërmarrësi për të rinjtë deri në 29 vjet, Trajnim për kualifikim profesional sipas kërkesës së punëdhënësve, Trajnim për profesione dhe zanate të kërkuara, si dhe Trajnim për përvetësim të aftësive. Në përgjithësi, kompensimi mujor për personat të cilët kanë ndjekur ndonjërin nga trajnimet e mësipërme, gjatë periudhës së studimit ka variuar nga 6200 MKD deri në 9000 MKD për person, ndërsa realizuesit e trajnimeve janë kompensuar në bazë të shumës së miratuar paraprakisht për person të trajnuar.

#### 5. Anketë për vende të lira pune

Përdorues të kësaj mase do të jenë personat e papunë të cilët kërkojnë punë në mënyrë aktive, të cilët do të angazhohen nga ana e Agjencisë së Punësimit për mbledhjen e informacioneve më të fundit në lidhje me kërkesat e tregut për fuqinë e nevojshme punëtore. Personat e angazhuar duhet të anketojnë punëdhënësit e ndryshëm përmes telefonit duke përdorur një pyetësor të përgatitur paraprakisht, dhe për këtë punë do të kompensohen në vlerë prej 6200 MKD për një muaj.

## 6. Programi për punë të dobishme komunale / Programi për angazhim në punë

Përdorues të kësaj mase mund të jenë: personat e papunë, përdoruesit e fundit të shërbimeve sociale, si dhe komunat. Gjatë periudhës së studimit kjo masë ka ofruar kompensim prej 6000 MKD deri në 9000 MKD në muaj për person të angazhuar në periudhe prej 6 deri në 9 muaj për një angazhim prej 20 orësh në javë, përfshirë sigurimin në punë dhe tatimin personal.

## 7. Pilot programe të ndryshme

Gjatë periudhës së studimit institucionet në fjalë kanë ofruar edhe disa pilot programe të ndryshme të cilat ose kanë qenë aktive vetëm në një vit, ose janë përsëritur edhe në ndonjë vit tjetër. Një përmbledhje e tyre mund të shihet në vijim: Programi për subvencionim të përdoruesve të tokës bujqësore shtetërore, Programi për punësim të anëtarëve të komunitetit etnik rom, Inkubator i zanaetçive, Themelimi i bizneseve në mese multietnike, Trajnime për shtim të aftësive për ndërtimin e ndërtesave me efikasitet energjetik, Trajnime në sferën e sigurisë, Trajnime në sferën e turizmit, Trajnime për aftësi jetësore, Përkrahje e ndërmarrjeve me rritje të shpejtë “Gazellë”, Subvencionimi i punësimit për personat fizik të papunë për kujdesin dhe ruajtjen e fëmijëve në kushte shtëpiake që kanë moshë deri në 6 vjeç, Trajnime për personat të cilët janë në marrëdhënie pune, Përkrahje financiare për hapjen e çerdheve private për fëmijë, Përkrahje financiare për hapjen e shtëpive private të pleqve, Zhvillim dhe implementim i pilot programeve për persona të rinj sipas kërkesave lokale.

## 8. Shërbime për punësim

Përveç masave të mësipërme, institucionet në fjalë gjatë periudhës së studimit kanë ofruar edhe shumë shërbime të tjera për punësim, të tilla si: lloje të ndryshme të trajnimeve, orientim profesional dhe këshilla rreth karrierës, ndërmjetësime në punësim, shërbime për punëdhënësit, etj.

Pikat 9, 10, 11, 12 nga tabela e mësipërme nuk do të elaborohen në detaje pasi që nuk janë të rëndësishme për këtë studim.

Aplikimi për ndonjërin nga masat e mësipërme bëhet tek Agjencia për Punësim. Informimin e subjekteve të interesuara për ndonjërin nga masat të cilat janë aktive për momentin, Agjencia për Punësim e bën përmes shpalljeve publike në media të shtypura dhe ueb faqes së saj, si dhe takime të shpeshta direkte me odat ekonomike, organizatat e biznesit dhe të qytetarëve, dhe të gjithë të interesuarit të cilët dëshirojnë të konkurrojnë për ndonjërin nga masat e ofruara. Kusht i vetëm për aplikim për ndonjërin masë, është që personat të jenë të regjistruar si kërkues aktiv të punës te kjo Agjenci, të paktën një ditë përpara shpalljes publike. Për të aplikuar, subjektet duhet të paraqiten në Agjenci dhe eventualisht të mbushin një kërkesë për aplikim, dhe në raste të caktuara të sjellin edhe ndonjë dokumentacion shtesë. Varësisht nga masa përkatëse, përzgjedhja e kandidatëve të cilët i



plotësojnë kushtet sipas shpalljes publike bëhet nga referentë të autorizuar në Agjencitë lokale për punësim ndërsa vendimi final meret nga Bordi Udhëheqës (i përbërë nga 9 anëtarë, 5 nga të cilët janë nga Qeveria e RM-së), ku varësisht nga masa përkatëse përzgjedhja mund të jetë sipas principit “i pari vjen, i pari shërbehet”, rrespektivisht sipas rradhës së dorëzimit të dokumentacionit deri sa ka mjete në disponim, në bazë konkurruese ose në vazhdimësi deri sa ka aplikime (AVRM, 2019).

#### 4.3 Agjencia për përkrahjen e sipërmarrësisë së Republikës së Maqedonisë (APSRM)

Agjencia për përkrahjen e sipërmarrësisë në RM, ka për qëllim dhe mision përkrahjen e zhvillimit të NVM-ve nëpërmjet të realizimit të projekteve të ndryshme, si dhe rritjen dhe zhvillimin e konkurrueshmërisë dhe inovacioneve të të njejtave.

Ky institucion poashtu shërben si qendër për distribuim të informacioneve relevante për sektorin e NVM-ve, si urë lidhëse në mes qendrave rajonale për përkrahje të sipërmarrësisë, krijimin e lidhjeve të biznesit me botën e jashtme, organizimin e konferencave dhe forumeve të biznesit, si dhe realizimin e programeve të ndryshme për financim dhe kofinancim të NVM-ve në bashkëpunim me investitor të vendit dhe të huaj (APSRM, 2019).

Programi vjetor i APSRM-së titullohet si “Programi për përkrahje të sipërmarrësisë, konkurrueshmërisë dhe inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”. Edhe buxheti i përcaktuar për këtë program, sigurohet nga buxheti i qeverisë së R. së Maqedonisë dhe i njejtë duhet të implementohet gjatë vitit kalendarik të përcaktuar.

Në tabelën në vijim është prezantuar shpërndarja e buxhetit të APSRM-së për periudhën 2014-2018.

*Tabela 10 Buxhetet vjetore të APSRM-së dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (MKD)*

	KATEGORITË E MBËSHTETJES SË AKTIVITEVE/VITI	2014	2015	2016	2017	2018
1.	Konsulencë përmes sistemit të vauçerëve	900,000	900,000	900,000	900,000	900,000
2.	Info pult	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000
3.	Organizimi i trajnimeve për përgatitje të biznes planit	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000
4.	Organizimi i trajnimeve për arsimtarë/profesorë të cilët e ligjerojnë lëndën e sipërmarrësisë dhe biznesit	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000
5.	Edukim mbi sipërmarrësinë	300,000	300,000	300,000	300,000	300,000

6.	Kofinancim i javës Evropiane të NVM-ve	150,000	150,000	150,000	150,000	100.000
7.	Organizimi i mentorimit në mes sipërmarrësve me eksperiencë dhe firmave “start-up”	200,000	200,000	200,000	200,000	200.000
8.	Organizimi i trajnimeve për konsulentë lokal	250,000	250,000	250,000	250,000	250.000
9.	Organizimi i trajnimeve për rritjen e konkurrueshmërisë së NVM-ve	300,000	300,000	300,000	300,000	300.000
10.	Përgatitje e raportit vjetor – Observatoriumi i NVM-ve	200,000	200,000	200,000	200,000	200.000
11.	Organizimi i trajnimeve për promovimin e përgjegjësish dhe sipërmarrësisë shoqërore			250,000	200,000	200.000
12.	Përkrahje e sipërmarrësisë së femrave	150,000	150,000	150,000	100,000	150.000
13.	Kofinancim i projekteve donatore	250,000	250,000		100,000	400.000
<b>TOTALI:</b>		<b>3.900.000</b>	<b>3,900,000</b>	<b>3,900,000</b>	<b>3,900,000</b>	<b>3,900,000</b>

*Adaptuar nga: Buxhetet vjetore të APSRM-së*

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, mund të vërejmë se buxheti i APRSM-së nuk ka ndryshuar aspak në 5 vitet e fundit, rrespektivisht ka kapur vlerën prej 3,900,000 MKD për vit. Shpërndarja e buxhetit bëhet gjithashtu në kategori të përcaktuara paraprakisht, vlerat e të cilave nuk kanë ndryshuar aspak apo kanë ndryshuar në masë të vogël në bazë të trendeve dhe kërkesave aktuale vjetore gjatë implementimit praktik të buxhetit.

Kjo analizë poashtu vë në pah faktin se qeveria nuk tregon kreativitet dhe gadishmëri për rritjen e buxhetit nga ana e saj, rrespektivisht nuk ka gadishmëri për ndarjen e më tepër mjeteve për APRSRM-në si institucion kryesor përgjegjës për mbështetjen e NVM-vë, gjë që do të kishte impakt të lartë në zhvillimin dhe rritjen e inovacionit dhe konkurrueshmërisë së NVM-ve, në tregun vendor dhe atë të jashtëm.

Një elaborim më detajor i instrumenteve të mësipërme të APSRM-së lidhur me përkrahjen e sipërmarrësisë, konkurrueshmërisë dhe inovacionit të NVM-ve, mund të shihet në vijim (APPRM, 2014-2018):

#### 1. Konsulencë përmes sistemit të vauçerëve

Ofrimi i shërbimeve konsulente përmes sistemit të vauçerëve për 30 klientë, rrespektivisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme apo sipërmarrës potencial, me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve ekzistuese dhe hapjes së ndërmarrjeve të reja. Për ndërmarrjet aktive do të ketë subvencione deri në 50% të vlerës neto të shërbimeve konsulente, por jo më shumë se 45,000 MKD, përveç se në rastet kur bëhet fjalë për NVM me projekte inovative të cilat kanë të drejtë për vauçer shtesë deri në

90,000 MKD si dhe personat e papunësuar/sipërmarrësit potencial për të cilët mbulohet 100% e vlerës së shërbimeve konsulente, por jo më shumë se 31,500 MKD me kusht që të punësohet brenda 6 muajve.

2. Info pult – projekt në bashkëpunim me qendrat rajonale  
Përkrahje e qendrave rajonale në funksionin e mëtejshëm të tyre, lidhur me realizimin e programeve të ndryshme për ndihmë, konsulencë dhe informim të 400 NVM-ve dhe sipërmarrësve potencial të cilët dëshirojnë të vetpunësohen.
3. Organizimi i trajnimeve për përgatitje të biznes planit  
Organizimi i dhjetë trajnimve që do të përfshijnë rreth 300 studentë dhe nxënës të shkollave të mesme, që do të mbulojnë tema relevante lidhur me përgatitjen e një biznesi.
4. Organizimi i trajnimeve për arsimtarë/profesorë të cilët e ligjerojnë lëndën e sipërmarrësisë dhe biznesit  
Organizimi i dy trajnimeve njëditore për së paku 100 profesorë të shkollave të mesme dhe fakulteteve të cilët e ligjerojnë këtë lëndë, për të zgjeruar mëtej njohuritë e tyre.
5. Edukim mbi sipërmarrësinë  
Organizimi dhe realizimi i pesë mbledhjeve të punës për promovim të sipërmarrësisë dhe zhvillim të shkathtësive dhe kulturës së nevojshme për hapjen e biznesit personal tek të rinjtë, rrespektivisht 150 pjesëmarrës (nxënës dhe student).
6. Kofinancim i javës Evropiane të NVM-ve  
Përkrahje e organizimit të javës Evropiane të NVM-ve me qëllim të rritjes së motivimit dhe pjesëmarrjes së tyre në këtë event, si dhe të rinjve dhe sipërmarrësve potencial.
7. Organizimi i mentorimit në mes sipërmarrësve me eksperiencë dhe firmave “start-up”  
Organizimi i tre seminareve tek të cilët sipërmarrësit me eksperiencë do të prezantojnë sfidat e tyre lidhur me hapat e hapjes së biznesit të tyre me qëllim të inkurajimit të sipërmarrësve të ri dhe ngritjes së vetëbesimit të tyre.
8. Organizimi i trajnimeve për konsulentë lokal  
Organizimi i një trajnimi tre ditor për së paku 25 konsulentë lokal, për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të tyre, në mënyrë që të jenë në gjendje të ndihmojnë sa më tepër ndërmarrjeve dhe të sigurojnë rritjen e konkurrueshmërisë së tyre.
9. Organizimi i trajnimeve për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme  
Organizimi i pesë trajnimeve një ditore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për gjithësej 150 pjesëmarrës/ndërmarrje, me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë së tyre, investimeve, inovacioneve, internacionalizimit dhe kapacitetit të të punësuarve.
10. Përgatitje e raportit vjetor – Observatoriumi i NVM-ve

Përgatitja e raportit vjetor në lidhje me gjendjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe trendet e këtij sektori në vitin paraprak.

11. Organizimi i trajnimeve për promovimin e përgjegjësisë dhe sipërmarrësisë shoqërore  
Organizimi i tre trajnimeve një ditore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për gjithësej 60 pjesëmarrës/ndërmarrje, lidhur me tema të përgjegjësisë dhe sipërmarrësisë shoqërore.

12. Përkrahje e sipërmarrësisë së femrave  
Organizimi i dy trajnimeve për sipërmarrëset ekzistuese dhe sipërmarrëset potencijale femra për gjithësej 40 pjesëmarrëse, për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve në pronësi dhe udhëheqje të sipërmarrësve femra.

13. Kofinancim i projekteve donatore  
Përmirësimi i konkurrueshmërisë së NVM-ve përmes pjesëmarrjes në projekte donatore. Implementimi i projektit “Krijimi dhe promovimi i shërbimeve mentoriale për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor”, në bashkëpunim me Agjensionin japonez për bashkëpunim ndërkombëtar (JICA), si dhe pjesëmarrje në kofinancimin e projektit “Aleanca e dijes në ndërmarrjet eko-inovative me qëllim të nxitjes së konkurrueshmërisë së NVM-ve”, në suaza të Programës transnacionale për bashkëpunim – INTEREG dhe Programës Ballkano-mediterane 2014-2012, ku APPRM është parnter në realizimin e projektit.

Përveç masave të mësipërme, në vitet paraprake (2014-2017) ka ekzistuar edhe një masë tjetër e cila nuk ka qenë aktive gjatë vitit 2018. Bëhet fjalë për masën lidhur me trajnimin e studentëve për përgatitje të aplikimeve për konkurrim për punësim për të cilën janë ndarë rreth 300,000 MKD në nivel vjetor.

APSRM programin e saj vjetor, rrespektivisht masat e mësipërme, i realizon përmes institucioneve kompetente të cilat përzgjidhen për implementimin e të njejtave përmes shpalljeve publike në bazë të kriteriumeve paraprakisht të parashtruara. Ndër institucionet të cilat rregullisht janë përzgjedhur viteve të fundit për implementimin tyre janë: ESA Tetovë për rajonin e Pollogut, ESA Ohër, Qendra rajonale për përkrahje të bizneseve në Shkup, Manastir, Veles, Kumanovë dhe Strumicë (RESC), Konfederata e Punëdhënësve, Qendra nacionale për zhvillim të inovacionit dhe sipërmarrësisë (NCDIEL), American College, etj.

Informimin e subjekteve të interesuara për ndonjërin nga masat të cilat janë aktive për momentin, APSRM e bën përmes shpalljeve publike në media të shtypura dhe ueb faqes së saj, si dhe thirrjes së sipërmarrësve potencial dhe ndërmarrjeve aktive të vogla dhe të mesme për të aplikuar për ndonjërin nga masat. Procedura e aplikimit nga ndërmarrjet dhe sipërmarrësit e interesuar për ndonjërin masë bëhet drejtëpërsëdrejti në nivel lokal tek qendrat e mësipërme të cilat janë të përzgjedhura dhe autorizuara për implementimin e masës përkatëse. Varësisht nga masa, ndërmarrjet dhe sipërmarrësit potencial duhet të

dorëzojnë Formular për aplikim, llogaritë përfundimtare për dy vitet e fundit, certifikate biznesi nga regjistri qëndror dhe ndonjë dokumentacion shtesë. Përzgjedhja e përfituesve të masave bëhet nga menaxhmenti i qendrave implementuese, ndërsa këta qendra duhet në mënyrë kontinue të dorëzojnë raporte mujore dhe raport final në fund të vitit të APSRM. Përfaqësues të autorizuar të APSRM-së në mënyrë të vazhdueshme i monitorojnë qendrat implementuese me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së procesit.

#### 4.4 Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik (FEZ) dhe Agjencia për Investime të Huaja dhe promovimin të Eksportit të RM-së.

Qeveria e R. së Maqedonisë, me qëllim të nxitjes së rritjes dhe zhvillimit ekonomik, solli Ligjin për përkrahje financiare të investimeve në Maj 2018, i cili do të kontribuojë në rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve dhe punësimit në R. e Maqedonisë përmes disa llojeve të ndryshme të përkrahjeve financiare për subjektet juridike. Organe kompetente për implementimin e këtyre përkrahjeve janë Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik (FEZ) dhe Agjencia për Investime të Huaja dhe promovimin të Eksportit të RM-së, varësisht llojit të projektit investiv. Për projektet investive në zonat e zhvillimit industrial teknologjik, subjektet duhet të aplikojnë tek Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik, ndërsa për projektet investive jashta këtyre zonave, subjektet duhet të aplikojnë tek Agjencia për Investime të Huaja dhe promovimin të Eksportit të RM-së (Gazeta Zyrtare e RM-së, 2018), (Direkcija za Tehnoloski Industriski Razvojni Zoni, 2019).

Përdorues të këtyre përkrahjeve financiare mund të jenë subjektet juridike të regjistruara në RM që realizojnë veprimtari prodhuese. Projekti investiv i cili pretendon të shfrytëzojë këtë lloj të përkrahjes nuk mund të zgjasë më tepër se 5 vite, ndërsa participimi i shfrytëzuesit në investim duhet të jetë minimum 25% e vlerës totale të projektit investiv. Shumat e përkrahjes të cilat mund të shfrytëzohen nga ndërmarrjet investive nuk mund të jenë më tepër se 50% e shpenzimeve të realizuara dhe pranuar. Për projekte investive të mëdha shumat e përkrahjes mund të jenë si në vijim: deri në 50% e shpenzimeve të realizuara dhe pranuar të projektit që ka vlerë 50,000,000 EUR, deri në 25% për një pjesë të shpenzimeve të realizuara dhe pranuar të projektit që ka vlerë 50,000,000 EUR deri në 100,000,000 EUR, si dhe deri në 17% për një pjesë të shpenzimeve të realizuara dhe pranuar të projekteve vlera e të cilave tejkalon 100,000,000 EUR. Llojet e përkrahjeve ndahen në dy kategori: Përkrahje financiare për investime, të tilla si: Përkrahje për punësime të reja, Përkrahje për krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënies me furnitorët e RM-së, Përkrahje për projekte investive që kanë interes të rëndësishëm ekonomik, Përkrahje për rritje të investimeve kapitale dhe të hyrave, Përkrahje për blerjen e pajisjeve për ndërmarrjet që kanë vështirësi, si dhe Përkrahje financiare për konkurrueshmëri, të tilla si: Përkrahje për rritjen e konkurrueshmërisë së tregut dhe Përkrahje për pushtimin e tregut dhe rritjes së shitjeve (Gazeta Zyrtare e RM-së, 2018).

Për të shfrytëzuar ndonjëherë nga përkrahjet e mësipërme, subjektet duhet të dorëzojnë kërkesë deri tek organet kompetente (Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik (FEZ) dhe Agjencia për Investime të Huaja dhe promovimin të Eksportit të RM-së), e cila përfshin Letrën e Qëllimit, biznes planin për projektin investiv dhe raportin financiar për tre (ose më pak) vitet e fundit të veprimtarisë. Me raste mund të kërkohej edhe dokumentacion shtesë. Organet kompetente brenda 15 ditësh duhet të përpilojnë raport që përfshinë të gjitha kërkesat e dorëzuara nga subjektet të cilat i plotësojnë kushtet e shpalljes dhe t'ia dorëzojnë Komisionit të Evaluimit të formuar nga Qeveria e RM-së. Komisioni i Evaluimit shqyrton këtë raport dhe brenda 15 ditësh krijon një raport më të detajuar në lidhje me subjektet që i plotësojnë kushtet dhe të njëjtën ua dërgon përsëri organeve kompetente. Organet kompetente në afat prej 30 ditësh pas pranimit të këtij raporti duhet të krijojnë një draft marrëveshje për marrjen e pëlqimit nga Qeveria e RM-së për ndarjen e këtyre përkrahjeve. Pasi merret vendimi final, njoftohen subjektet të cilat i kanë fituar këto përkrahje dhe nënshkruhet një marrëveshje me kushtet të cilat duhet ti plotësojnë të njëjtat. Nëse subjektet i plotësojnë kushtet e marrëveshjes, deri në Qershor të vitit përkatës duhet të dorëzojnë një kërkesë shtesë dhe dokumentacionin përkatës për lëshimin e përkrahjes financiare te organet kompetente, të cilët duhet tua lëshojnë të njëjtat për një periudhë jo më të gjatë se 60 ditë nga dita e shtrimit të kërkesës (Gazeta Zyrtare e RM-së, 2018).

#### 4.5 Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik

Fondi për inovacione dhe zhvillim teknologjik, ka për qëllim të promovojë, inkurajojë dhe mbështes aktivitetet e inovacionit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, përmirësimin e qasjes në shërbime të ndryshme financiare, zhvillimin e infrastrukturës për inovacione dhe zhvillim teknologjik, si dhe krijimin e partneriteteve në mes të universiteteve dhe qendrave hulumtuese dhe sektorit privat të R. së Maqedonisë. E gjithë kjo, për të kontribuar në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit duke zhvilluar konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve (Fond za inovacii i tehnoloski razvoj, 2019).

Në tabelën në vijim janë prezantuar buxhetet vjetore të instrumenteve të FITR-it për përkrahje të NVM-ve dhe sipërmarrësisë për periudhën 2014-2018.

*Tabela 11 Buxhetet vjetore të FITR-it dhe shpërndarja e tyre për periudhën 2014-2018 (EUR)*

	KATEGORITË E MBËSHTETJES SË AKTIVITEVE/VITI	2014	2015	2016	2017	2018
1.	Instrumentet për përkrahje financiare në kuadër të shtyllës së 3-të të Planit për rritje ekonomike: a) Grante të bashkëfinancuara për ndërmarrjet e vogla dhe					3,000,000

	të mesme me tendencë rritjeje të shpejtë ("Gazellë")					
	b) Grante të bashkëfinancuara për mikro ndërmarrjet					
	c) Grante të bashkëfinancuara për përmirësimin e inovacionit					
	d) Grante të bashkëfinancuara për zhvillim profesional dhe trajnim për të rinjtë e sapo punësuar					
2.	Grante të bashkëfinancuara për fillimin e ndërmarrjeve të reja "start-up" dhe "spin-off"		876,639	450,000	450,000	1,000,000
3.	Grante të bashkëfinancuara dhe kredi të kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve		535,296		1,000,000	
4.	Grante të bashkëfinancuara për ekstenziona teknologjike					1,700,000
5.	Grante të bashkëfinancuara për krijimin, funksionimin dhe investimin në akseleratorë të teknologjisë së biznesit					1,700,000
<b>TOTALI:</b>			<b>1,411,935</b>	<b>450,000</b>	<b>1,450,000</b>	<b>7,400,000</b>

*Adaptuar nga: Buxhetet vjetore të FITR-it*

Një elaborim më detajor i instrumenteve të mësipërme të FITR-it për përkrahjen e NVM-ve do të bëhet më poshtë, duke u bazuar në programën vjetore të vitit 2018 të këtij institucioni:

1. Instrumentet për përkrahje financiare në kuadër të shtyllës së 3-të të Planit për rritje ekonomike

a) Grante të bashkëfinancuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me tendencë rritjeje të shpejtë ("Gazellë")

Ky instrument siguron financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme deri në 30% të buxhetit total të projektit investues, por jo më shumë se 10,000,000 MKD për aplikant, me qëllim të zhvillimit teknologjik të këtyre ndërmarrjeve të cilat kanë tendencë të rritjes së shpejtë dhe shëndrimit në ("Gazellë"). Pjesa e mbetur prej 70% e buxhetit të projektit investues duhet të mbulohet nga vetë aplikanti (FITR, 2018).

b) Grante të bashkëfinancuara për mikro ndërmarrjet

Ky instrument siguron financimin e ndërmarrjeve mikro deri në 30% të buxhetit total të projektit investues, por jo më shumë se 5,000,000 MKD për aplikant, me qëllim të zhvillimit teknologjik të kësaj kategorije të ndërmarrjeve. Pjesa e

mbetur prej 70% e buxhetit të projektit investues duhet të mbulohet nga vetë aplikanti (FITR, 2018).

- c) Grante të bashkëfinancuara për përmirësimin e inovacionit  
Ky instrument siguron financimin e ndërmarrjeve deri në 70% të buxhetit total të projektit investues, por jo më shumë se 20,000,000 MKD për aplikant, me qëllim të zhvillimit dhe aplikimit të zgjidhjeve inovative të ndërmarrjeve. Pjesa e mbetur prej 30% e buxhetit të projektit investues duhet të mbulohet nga vetë aplikanti (FITR, 2018).
- d) Grante të bashkëfinancuara për zhvillim profesional dhe trajnim për të rinjtë e sapo punësuar  
Ky instrument siguron financimin e ndërmarrjeve deri në 30% të buxhetit total të projektit investues, por jo më shumë se 1,000,000 MKD për aplikant, me qëllim mbështetjes së zhvillimit profesional dhe trajnimit të rinjve të sapo punësuar deri 29 vjet. Pjesa e mbetur prej 70% e buxhetit të projektit investues duhet të mbulohet nga vetë aplikanti (FITR, 2018)

Për të aplikuar për ndonjërin nga kategoritë e këtij instrumenti, pas shpalles publike nga Fondi, në afat prej 60 ditësh duhet të dorëzohet propozim projekti i ndërmarrjes. Për ta dorëzuar atë, aplikanti duhet të dorëzojë dy lloje të dokumentacionit:

- Dokumentacionin e projektit, që përfshinë: Formular për aplikim për projekt, Formular për buxhetin e projektit, Deklaratë të aplikantit për pranim të kushteve të fondit, dhe plotësim i Pyetësorit për ambientin jetësor;
- Dokumentacionin lidhur me aplikantin: biografi e shkurtër e personave të kyçur në projekt, certifikate biznesi nga regjistri qëndror, bilanc të gjendjes dhe bilanc të suksesit, listë të numrit të të punësuarve tek aplikanti.

## 2. Grante të bashkëfinancuara për fillimin e ndërmarrjeve të reja “start-up” dhe “spin-off”

Ky instrument ka për qëllim financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, të sapo formuara – “start up” dhe “spin-off”, jo më të vjetra se gjashtë vite, të cilat kanë një ide inovative e cila ndodhet në një fazë të “konceptit të konfirmuar” dhe para komercializimit, por me tendenca reale për komercializim. Gjithashtu, ky instrument vlen vetëm për ndërmarrjet me pronësi domuese maqedonase, 50,1% ose më tepër. Nëpërmjet të këtij granti, fondi mund të financojë deri në 85% të totalit të buxhetit të projektit, por jo më shumë se 30,000 EUR.

Për të aplikuar për këtë lloj instrumenti, pas shpalles publike nga Fondi, në afat prej 30 deri në 90 ditë duhet të dorëzohet propozim projekti i ndërmarrjes. Për ta dorëzuar atë, ndërmarrjet duhet të dorëzojnë Formularin për aplikim për projekt dhe Buxhetin e projektit, së bashku me dokumentacionin shtesë që mund të kërkohet sipas rregullores së fondit apo shpalljes publike (FITR, 2015-2018).



### 3. Grante të bashkëfinancuara dhe kredi të kushtëzuara për komercializimin e inovacioneve

Ky instrument ka për qëllim mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një produkt, shërbim apo proces inovativ, me një qëllim të qartë komercial, të cilat janë në fazë të prototipit e deri në fazë të parakomercializimit, vet ose në bashkëpunim me ndonjë ndërmarrje tjetër apo me ndonjë institucion të arsimit të lartë, rrespektivisht qendre hulumtuese. Nëpërmjet të këtij granti, fondi mund të financojë deri në 70% të totalit të buxhetit të projektit, por jo më shumë se 100,000 EUR. Financimi mund të jetë në formë të grantit të bashkëfinancuar nëse të ardhurat vjetore të ndërmarrjes nuk i kanë kaluar 500,000 EUR në dy vitet e fundit, apo kredisë së kushtëzuar nëse të ardhurat vjetore të ndërmarrjes i kanë kaluar 500,000 EUR në dy vitet e fundit.

Ngjajshëm me instrumentin paraprak, edhe për këtë lloj instrumenti, pas shpalles publike nga Fondi, në afat prej 30 deri në 90 ditë duhet të dorëzohet propozim projekti i ndërmarrjes. Për ta dorëzuar atë, ndërmarrjet në këtë rast duhet të dorëzojnë përveç Formularit për aplikim për projekt dhe Buxhetit të projektit edhe Projeksionin financiar, dhe dokumentacionin shtesë që mund të kërkohet sipas rregullores së fondit apo shpalljes publike (FITR, 2015, 2017).

### 4. Grante të bashkëfinancuara për ekstenzione teknologjike

Ky instrument ka për qëllim përkrahjen e procesit të adaptimit të teknologjive inovative dhe të përparuara dhe përmirësimin e proceseve biznesore të ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Ky lloj i përkrahjes mund të jepet në dy faza të ekstenzionit teknologjik: Faza 1 – Diagnostikë dhe plani për përmirësim dhe Faza 2 – Zbatimi i planit të përmirësimit, ku në rast se veçse ekziston diagnostika dhe plani për përmirësim, ndërmarrjet mund të aplikojnë vetëm për fazën e dytë. Nëpërmjet të këtij granti, fondi mund të financojë deri në 50% të totalit të buxhetit të projektit, por jo më shumë se 500,000 EUR për të dyja fazat, ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet nga vet aplikanti. Për projektet që përbëhen nga të dyja fazat, fondi mund të mbulojë tërësisht fazën e parë nëse ajo nuk tejkalon 50,000 EUR, ndërsa për projektet që përbëhen vetëm nga faza e dytë, fondi mund të bashkëfinancojë të njejtat deri në vlerë prej 200,000 EUR për aplikant.

Ngjajshëm me instrumentin paraprak, edhe për këtë lloj instrumenti, pas shpalles publike nga Fondi, në afat prej 30 deri në 90 ditë duhet të dorëzohet propozim projekti i ndërmarrjes. Për ta dorëzuar atë, ndërmarrjet në këtë rast duhet të dorëzojnë përveç Formularit për aplikim për projekt dhe Buxhetit të projektit, dhe dokumentacionin shtesë që mund të kërkohet sipas rregullores së fondit apo shpalljes publike. Ndërmarrjet që do të aplikojnë vetëm për fazën e dytë, duhet të dorëzojnë edhe Diagnostikën dhe Planin për përmirësim dhe kornizën e monitorimit dhe vlerësimit, si dhe një deklaratë të pajtueshmërisë (FITR, 2018).

#### 5. Grante të bashkëfinancuara për krijimin, funksionimin dhe investimin në akseleratorë të teknologjisë së biznesit

Ky instrument ka për qëllim përkrahjen e NVM-ve në krijimin dhe funksionimin e akseleratorëve, implementimin e programeve para-investuese si dhe investimin në akseleratorë, që do të kontribuojnë në rritjen e përsheptuar dhe të qëndrueshme të ndërmarrjeve “start-up”. Shërbimet për “start up” – et e sapo formuara që do të ofrohen nga akseleratorët, janë si në vijim: hapësirë zyre dhe përkrahje administrative, trajnime, këshilla dhe mentorim, qasje në resurse për përkrahje të biznesit, si dhe investime financiare. Akseleratorët duhet ti organizojnë aktivitetet e tyre në 3 faza, edhe atë: Faza 1 – Programi para-investiv, Faza 2 – Investimet fillestare dhe Faza 3 – Investimet e mëtejme. Nëpërmjet të këtij granti, fondi mund të financojë deri në 75% të totalit të buxhetit të projektit, por jo më shumë se 500,000 EUR për kostot operationale (shumica në fazën 1 dhe një pjesë në fazën 2 dhe 3) dhe investimet (në fazat 2 dhe 3), ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet nga vetë aplikanti.

Ngjajshëm me instrumentin paraprak, edhe për këtë lloj instrumenti, pas shpalles publike nga Fondi, në afat prej 30 deri në 90 ditë duhet të dorëzohet propozim projekti i ndërmarrjes. Për ta dorëzuar atë, ndërmarrjet në këtë rast duhet të dorëzojnë përveç Formularit për aplikim për projekt dhe Buxhetit të projektit edhe Projeksionin financiar, dhe dokumentacionin shtesë që mund të kërkohe sipas rregullores së fondit apo shpalljes publike (FITR, 2018).

FITR-i ofron edhe disa përkrahje më të vogla për disa aktivitete të tjera, të cilat meqenëse nuk janë të destinuara për NVM-të nuk do ti sqarojmë më në detaje.

#### 4.6 Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve nga projekte donatore ndërkombëtare

Në R. e Maqedonisë, përveç formave të përkrahjeve të mësipërme, ekzistojnë edhe disa përkrahje financiare dhe jofinanciare të tjera për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme nga donatorë ndërkombëtarë, që kanë për qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e sektorit të NVM-ve. Disa nga programet aktive të donatorëve ndërkombëtar për momentin, janë si në vijim:

- COSME<sup>18</sup> - menaxhohet nga Ministria e Ekonomisë.
- Horizon 2020<sup>19</sup> - menaxhohet nga Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (FITR) dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

<sup>18</sup> Projekti është sqaruar më në detaje tek pjesa e Shqipërisë.

<sup>19</sup> Ibid.

- WB EDIF<sup>20</sup> – ndan fonde për ProCredit Bank në R. e Maqedonisë në formë të kredive të cilat mund të shfrytëzohen nga ana e NVM-ve. Deri më tani ka shpërndarë fonde prej 13.04 milion EUR (WB EDIF, 2019).
- WBIF  
Korniza e investimeve të Ballkanin Perëndimor (WBIF) është një strukturë rajonale e cila përkrah rritjen e UE-së dhe zhvillimin socio-ekonomik të shteteve të Ballkanit Perëndimor si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, R. e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia. E themeluar në vitin 2009, kjo kornizë është një iniciativë e përbashkët e Komisionit Evropian, Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Bankës Evropiane për Investime dhe disa donatorëve të tjerë bilateral. Grupi i Bankës Botërore (WBG), Banka për Zhvillim KfW dhe AFD (Agjencia Franceze për Zhvillim gjithashtu ju bashkangjiten kësaj kornize pak më vonë. Kjo kornizë ka për qëllim financimin dhe ndihmën teknike të investimeve në energji, mjedis, shoqëri, transport dhe infrastrukturë digjitale, mirëpo gjithashtu ofron edhe përkrahje për zhvillimin e sektorit privat (Western Balkans Investment Framework, 2019). Disa nga projektet aktive të institucioneve të kësaj kornize janë si në vijim:
  - Grupi i Bankës Botërore (WBG), Zhvillimi i Aftësive dhe Përkrahja e Inovacionit (SDIS) 2014-2019 - përkrah FITR-in në R. e Maqedonisë në sferën e inovacioneve, me çka FITR-i këto fonde i ndanë si mini grante për ndërmarrjet inovative “start-up” dhe “spin-off” dhe për komercializimin e inovacioneve të ndërmarrjeve ekzistuese (Naceva, 2019).
  - EBRD – sapo ka vazhduar përkrahjen e sektorit të NVM-ve në R. e Maqedonisë me një fond të ri prej 30 milion EUR (prej të cilave 4.5 milion EUR janë grante) për bankat vendase të cilin ata mund tua shpërndajnë në formë të kredisë NVM-ve me qëllim të përmirësimit të kapacitetit dhe kualitetit të tyre. Për momentin në këtë program janë të përfshirë bankat në vijim: Sparkasse, Ohridska SG dhe Banka Komercijale (Gajic, 2019).
  - KfW – në bashkëpunim me Bankën Maqedonase për Promovimin e Zhvillimit, synon tu jep qasje ndërmarrjeve të vogla në kredi dhe shërbime të tjera financiare. Këtp kredi u jepen në dizpozicion bankave të përzgjedhura komerciale, të cilat më pas ua shpërndajnë NVM-ve sipas kushteve të tregut. KfW gjithashtu kishte gisht në themelimin e ProCredit Bank Shkup AD (KfW, 2019).
- USAID BEP (Projekti për Ekostistemin e Biznesit) – ky projekt është i fokusuar në mbështetjen e sektorit privat në RM përmes përmirësimit të konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. Aktitetet kryesore të tij janë të orientuara në forcimin ekosistemit që mbështet rritjen e MNVM-ve dhe njëherit edhe të punësimit.

---

<sup>20</sup> Ibid.

Ky projekt funksionon në bashkëpunim dhe partneritet me Ministrinë e Ekonomisë dhe atë të Punës dhe Fondin për Inovacione. Deri tani, një numër i madh i ndërmarrjeve dhe sipërmarrësve kanë përfituar përkrahje nga ky projekt në formë të ndihmës për sigurimin e kredive nga institucionet financiare, trajnimeve, përmirësimit të praktikave të menaxhimit dhe teknologjisë, krijimit të lidhjeve me blerës të ri, etj (USAID, 2019).

Përkrahje të tjera më të vogla ofrohen edhe nga Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) në formë të kredive për NVM-të, përmes bankave në vijim: HalkBank, Fondacioni për Mikrokredi Horizonti dhe Ohridska, Fondi “Green for Growth” i cili në bashkëpunim me Halk Bank ofron kredi për projekte në fushën e energjisë, Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA), Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Ministria Federale Gjermanie për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim (BMZ), etj.

## 5. Analiza dhe diskutimi i rezultateve

### 5.1 Karakteristika të përgjithshme të ndërmarrjeve në R. e Maqedonisë - në veçanti në Rajonin e Pollogut

Në R. e Maqedonisë, numri total i ndërmarrjeve ka pasur një rritje graduale gjatë viteve, rrespektivisht është rritur nga 70,659 në vitin 2015 në 72,315 në vitin 2018. Nga tabela e mëposhtme, poashtu mund të vërejmë se e njëjta vlen edhe për numrin e ndërmarrjeve në Rajonin e Pollogut, ku numri i tyre është rritur nga 7323 në vitin 2014 në 8272 në vitin 2018. Sa i përket Rajonit të Pollogut, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve janë të koncentruara në Komunën e Tetovës dhe të Gostivarit. Më pas vijojnë Komuna e Vrapçishtit, Bogovinës, Tearcës, Zhelinës, Bërvenicës, ndërsa Komuna e Jegunovcës dhe e Mavrovës dhe Rostushës kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve. Për më tepër, nga tabela e mëposhtme mund të vërejmë se pjesa dërrmuese e ndërmarrjeve bëjnë pjesë në kategorinë e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla.

*Tabela 12 Ndërmarrjet aktive sipas madhësisë, komunave dhe viteve në R. e Maqedonisë, dhe në veçanti Rajonin e Pollogut, për periudhën 2014-2018*

Vitet	Kategoritë e ndërmarrjeve sipas madhësisë	Republika e Maqedonisë	Rajoni i Pollogut	Tetovë	Bogovinë	Bërvenicë	Zhelinë	Jegunovcë	Tearcë	Gostivar	Vrapçisht	Mavrovë dhe Rostushë
2014	Totali	70659	7323	3109	340	291	273	157	292	2339	365	157
	Mikro	49539	5751	2358	263	241	201	121	237	1894	312	124
	Të vogla	19937	1520	722	75	48	69	34	54	435	53	30
	Të mesme	724	40	20	2	2	2	1	1	10	-	2

	Të mëdha	459	12	9	-	-	1	1	-	-	-	1
2015	Totali	70139	7554	3234	356	293	278	178	311	2362	387	155
	Mikro	48611	5947	2473	275	244	202	140	254	1912	326	121
	Të vogla	20313	1553	733	78	47	74	35	56	439	60	31
	Të mesme	725	43	20	3	2	1	2	1	11	1	2
	Të mëdha	490	11	8	-	-	1	1	-	-	-	1
2016	Totali	71519	8033	3430	397	293	276	178	352	2513	447	147
	Mikro	49364	6391	2630	312	237	205	139	294	2075	384	115
	Të vogla	20892	1585	771	82	54	69	36	57	426	62	28
	Të mesme	746	46	22	3	2	1	2	1	11	1	3
	Të mëdha	517	11	7	-	-	1	1	-	1	-	1
2017	Totali	71419	8118	3480	400	280	287	182	384	2519	447	139
	Mikro	48577	6380	2651	314	217	209	143	323	2038	382	103
	Të vogla	21543	1671	795	82	59	73	36	59	471	63	33
	Të mesme	776	55	25	4	4	4	2	2	9	2	3
	Të mëdha	523	12	9	-	-	1	1	-	1	-	-
2018	Totali	72315	8272	3595	403	273	291	184	385	2544	465	132
	Mikro	48778	6434	2715	310	209	212	141	321	2037	394	95
	Të vogla	22138	1764	841	89	61	73	40	62	495	70	33
	Të mesme	840	59	26	4	3	5	3	2	11	1	4
	Të mëdha	559	15	13	0	0	1	0	0	1	0	0

*Adaptuar nga: Enti Shtetëror i Statistikës - MAKSTAT*

Nga tabela në vijim mund të vërehet se sipas strukturës së veprimtarive të ndërmarrjeve/subjekteve afariste në R. e Maqedonisë në vitin 2018, pjesa më e madhe e tyre i takojnë Tregtisë me shumicë dhe pakicë; rregullim i mjeteve motorike dhe motociklave, pasuar nga Industria e përpunimit, Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike, Transporti dhe deponimi/magazinimi, Ndërtimtaria, Objekte për vendosje dhe veprimtari shërbyese me ushqim, etj, Sa i përket Rajonit të Pollogut, mund të themi se rënditja pothuajse është e njejtë.

*Tabela 13 Ndërmarrjet aktive sipas veprimtarive në R. e Maqedonisë, dhe në veçanti rajonin e Pollogut, në vitin 2018*

Viti	Subjektet afariste sipas veprimtarive	Republika e Maqedonisë	Rajoni i Pollogut	Tetovë	Bogovinë	Brvenicë	Zhelinë	Jegunovcë	Tearcë	Gostivar	Vrapçishtë	Mavrova dhe Rostusha
2018	Total	72315	8272	3595	403	273	291	184	385	2544	465	132
	A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	2546	189	44	17	17	12	14	22	43	17	3
	B - Miniera dhe nxerrje të gurit	205	17	4	0	0	2	2	1	8	0	0
	C - Industria e përpunimit	8033	1109	437	73	43	35	21	66	330	86	18
	D - Furnizim me energji elektrike, gas, avull dhe klimatizim	186	19	10	0	3	1	0	0	4	1	0
	E - Furnizim me ujë; largim i ujrave të zeza, menaxhim me mbeturina; sanim i rrethinës	250	31	5	4	1	5	2	1	9	3	1
	F - Ndërtimtari	4938	832	289	57	35	64	16	63	229	67	12
	G - Tregti me shumicë dhe tregti me pakicë; rregullim i mjeteve motorike dhe motociklave	22950	2943	1344	141	98	95	55	114	919	143	34
	I - Transport dhe deponimi/magazinimi	5667	453	119	18	22	30	30	18	167	39	10
	J - Objekte për vendosje dhe veprimtari shërbyese me ushqim	4597	749	319	35	21	18	22	39	225	43	27
	K - Informata dhe komunikime	1856	102	66	1	2	0	2	3	25	1	2

L - Veprimtari financiarë dhe veprimtari të sigurimeve	448	34	24	0	0	1	0	0	8	1	0
M - Veprimtari në lidhje me pasuri të patundshme	575	23	12	0	2	0	0	0	8	1	0
N - Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	7261	605	335	11	5	4	5	8	224	12	1
O - Veprimtari administrative dhe të shërbimeve ndihmëse	1752	140	87	4	2	3	0	3	36	5	0
P - Drejtoria publike dhe mbrojtja; sigurimi social i obliguar	264	18	5	1	1	1	2	1	5	1	1
Q - Arsimimi	1222	119	53	6	4	6	3	5	31	5	6
R - Veprimtari të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale	3357	399	168	23	6	11	5	22	131	24	9
S - Art, zbavitje dhe rekreacion	1404	103	54	1	4	0	1	4	27	8	4
T - veprimtari tjera shërbyese	4804	387	220	11	7	3	4	15	115	8	4

*Adaptuar nga: Enti Shtetëror i Statistikës - MAKSTAT*

## 5.1 Analiza dhe diskutimi i rezultateve nga hulumtimi/anketimi i NVM-ve në Rajonin e Pollogut

Për sigurimin e të dhënave sekondare për nevojat e studimit të Analizës së ndikimit të subvencioneve financiare dhe jofinanciare në performancën e NVM-ve në R. e Maqedonisë, është realizuar një anketë gjatë muajve Mars, Prill dhe Maj, 2019 në Rajonin e Pollogut, për të identifikuar se sa ndikojnë këta subvencione në rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve tek ata të cilët i kanë shfrytëzuar dhe cilat janë problemet dhe pengesat që pamundësojnë aplikimin për ta tek ndërmarrjet të cilat deri më tani nuk kanë shfrytëzuar ndonjë lloj përkrahjeje.


Janë anketuar gjithësej 51 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, ku 2/3 rrespektivisht 34 ndërmarrje janë nga ato të cilat kanë shfrytëzuar ndonjë lloj të përkrahjeve financiare apo jofinanciare dhe 1/3 rrespektivisht 17 ndërmarrje janë nga ato të cilat deri më tani nuk kanë shfrytëzuar asnjë lloj përkrahjeje.

### ***Karakterisitika të përgjithshme të ndërmarrjeve të anketuara***

Nga ndërmarrjet e anketuara 30 janë nga komuna e Tetovës, 6 nga komuna e Tearcës, 6 nga komuna e Gostivarit, 4 nga komuna e Zhelinës, 2 nga komuna e Brvenicës, 2 nga komuna e Bogovinës dhe 1 nga komuna e Jegunovcës.

Struktura e veprimtarisë së ndërmarrjeve të anketuara është si në vijim: 39% e ndërmarrjeve i takojnë degës së shërbimeve, 24% e ndërmarrjeve i takojnë degës së prodhimit, 16% e ndërmarrjeve i takojnë degës së tregtisë, 2% e ndërmarrjeve i takojnë degës së bujqësisë dhe 20% e ndërmarrjeve u takojnë veprimtarive të tjera si: ndërtimtari, hoteleri dhe shëndetësi.


*Grafiku 3 Struktura e veprimtarisë së ndërmarrjeve*




Nga ndërmarrjet e anketuara, pjesa më e madhe e tyre apo 60.78% janë të regjistruara si SHPKNJ, 25.49% si SHPK, 9.80% si tregtar individual dhe 1.96% si ISHP.

Për më tepër, 86.27% e ndërmarrjeve janë në pronësi të pronarëve/CEO-ve meshkuj dhe vetëm 13% në pronësi të pronareve/CEO-ve femra.

Grafiku 5 Pronësia e ndërmarrjeve




Grafiku 4 Forma e regjistrimit të ndërmarrjeve




Në vijim, rreth 43.14% e ndërmarrjeve të anketuara ekzistojnë në treg mbi 10 vite, 37.8 % e ndërmarrjeve nga 1 deri në 5 vite, 17.65% e ndërmarrjeve nga 5 deri në 10 vite dhe 1.96% e ndërmarrjeve më pak se një vit.

**Grafiku 6 Kohëzgjatja e ekzistimit të ndërmarrjeve**



Sipas kategorizimit ligjor, 66.67% e ndërmarrjeve të anketuara bëjnë pjesë në kategorinë e ndërmarrjeve mikro (0 deri 9 të punësuar), 27.45% në kategorinë e ndërmarrjeve të vogla (10 deri 49 të punësuar) dhe vetëm 5.88% në kategorinë e ndërmarrjeve të mesme (50 deri 249 të punësuar).

**Grafiku 7 Kategorizimi ligjor i ndërmarrjeve**



Shumica e ndërmarrjeve të anketuara - rreth 58.82% nuk e konsiderojnë biznesin e tyre si biznes familjar, 35.29% e konsiderojnë si të tillë, ndërsa 5.88% nuk mund ta vlerësojnë.

Gjithashtu, për sa i përket posedimit të biznes planit, shumica e ndërmarrjeve me rreth 70.59% posedojnë një të tillë, ndërsa pjesa e mbetur e tyre prej 29.41% e tyre nuk posedojnë biznes plane për ndërmarrjet e tyre.

### **Qarkullimi vjetor i NVM-ve**


Në qoftë se analizojmë të dhënat e qarkullimit vjetor të ndërmarrjeve në 5 vitet e fundit, 2014-2018, mund të vërejmë se në cilën kategori bëjnë pjesë ndërmarrjet sipas këtij indikatorit.

Siç mund të vërehet nga grafiku në vijim, në dy vitet e para të analizës, dominojnë ndërmarrjet e vogla, rrespektivisht 57.14% në vitin 2014 dhe 52.50% në vitin 2015. Rezultati




i këtillë del në pah si rrjedhojë e gjendjes momentale të analizës, respektivisht nga fakti se disa nga ndërmarrjt e anketuara nuk kanë ekzistuar dhe operuar në këto vite. Me rritjen e numrit të ndërmarrjeve aktive, në 3 vitet në vijim, pasqyrohet gjendja më reale, ku numri i ndërmarrjeve mikro edhe sipas qarkullimit vjetor është më i madh se ato të vogla dhe njëkohësisht ato të mesme.

**Grafiku 8 Kategorizimi i ndërmarrjeve në bazë zë qarkullimit vjetor në 5 vitet e fundit**



Grafiku tjetër në vijim tregon ndryshimin vjetor të qarkullimit të ndërmarrjeve, ku mund të vërejmë se shumica e tyre në 5 vitet e analizës kanë pasur ndryshim pozitiv të qarkullimit vjetor në mes 0-20%, pasuar nga ndryshimi pozitiv në mes 20-40%, ndërsa sa i përket ndryshimit negativ të qarkullimit vjetor, përsëri shumica e tyre kanë pasur ndryshim negativ në mes 0-20%. Ndryshim pozitiv më të madh se 100% kanë pasur një përqindje jashtëzakonisht e vogël e ndërmarrjeve.


**Grafiku 9 Ndryshimi vjetor i qarkullimit të ndërmarrjeve në 5 vitet e fundit, 2014-2018**



\*- % e ndërmarrjeve të cilat nuk kanë ekzistuar në vitin përkatës

Lidhur me pritjet për lëvizjen e qarkullimit vjetor në 3-5 vitet e ardhshme, 2019-2023, 39.22% e ndërmarrjeve besojnë se qarkullimi vjetor i ndërmarrjeve të tyre do të pësojë rritje të moderuar – nën 20% në vjet në terma të qarkullimit vjetor, 29.41% e tyre besojnë se nuk do të ketë ndryshim, 17.65% besojnë se do të ketë rritje të ndjeshme – mbi 20% në vjet në terma të qarkullimit vjetor, një pjesë me vogël prej 9.80% janë deklaruar se nuk e dinë se çka do të ndodh me të dhe vetëm 3.92% janë mendimit se do të zvogëlohet.


**Grafiku 10 Pritjet për rritje të qarkullimit vjetor në 3-5 vitet e ardhshme**



**Numri i të punësuarve te NVM-të**

Grafiku në vijim tregon ndryshimin vjetor në numrin e të punësuarve të ndërmarrjeve, ku mund të vërejmë se shumica e tyre në 5 vitet e analizës kanë pasur ndryshim pozitiv në numrin e të punësuarve në mes 0-20%, pasuar nga ndryshimi pozitiv në mes 20-40%. Ndryshim pozitiv më të madh se 100% kanë pasur një përqindje jashtëzakonisht e vogël e ndërmarrjeve.

**Grafiku 11 Ndryshimi vjetor i numrit të të punësuarve në 5 vitet e fundit, 2014-2018**



\*- % e ndërmarrjeve të cilat nuk kanë ekzistuar në vitin përkatës

Lidhur me pritjet për lëvizjen e numrit të të punësuarve në 3-5 vitet e ardhshme, 2019-2023, 45.10% e ndërmarrjeve besojnë se numri i të punësuarve në ndërmarrjet e tyre nuk do të ketë ndryshim, 29.41% besojnë se do të pësojë rritje të moderuar – nën 20% në vjet në terma të numrit të të punësuarve, 19.61% e tyre besojnë se do të ketë rritje të ndjeshme – mbi 20% në vjet në terma të numrit të të punësuarve, dhe një pjesë e vogël prej 5.88% janë deklaruar se nuk e dinë se çka do të ndodh me të.

*Grafiku 12 Pritjet për rritje të numrit të të punësuarve në 3-5 vitet e ardhshme*




### ***Faktorët problematik në udhëheqjen e biznesit të NVM-ve***

Identifikimi i faktorëve problematik në udhëheqjen e bizneseve është realizuar përmes pyetjes në vijim, ku NVM-të kishin mundësinë e zgjedhjes së më tepër përgjigjeve nga ato të propozuara. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 188, përgjigjja më e zgjedhur nga ana e NVM-ve, rrespektivisht 28 herë, është jostabiliteti i politikave ekonomike që paraqet 14.89% nga totali i përgjigjeve. Si faktorë i dytë më problematik, konsiderohet qasja deri te mjetet financiare, e përzgjedhur 23 herë, që rrespektivisht paraqet 12.23% nga totali i përgjigjeve. Në vijim, analiza tregon se si faktorë të tjerë problematik nga ana e NVM-ve konsiderohen gjithashtu edhe fuqia punëtore me edukim të papërshtatshëm dhe mungesa e besimit në relacionet e biznesit të përzgjedhura nga 18 herë, rrespektivisht 9.57%, etikë pune e pamjaftueshme e fuqisë punëtore e përzgjedhur 16 herë, që reprezenton 8.51%, administrata joefikase shtetërore dhe infrastruktura jo e përshtatshme të përzgjedhura nga 15 herë, që reprezentojnë nga 7.89%, shkallët tatimore të përzgjedhura 13 herë, që reprezentojnë 6.91%, etj.

Sa u përket rregullativave devizore dhe inflacionit, asnjëra nga ndërmarrjet nuk i konsideron këta faktorë si problematik në udhëheqjen e biznesit të tyre.

*Grafiku 13 Faktorët më problematik në udhëheqjen e biznesit të NVM-ve*




### **Anëtarësimi i NVM-ve në odat ekonomike**

Sa i përket anëtarësimit në odat ekonomike, 82.35% e ndërmarrjeve janë deklaruar se nuk janë anëtare në asnjë odë ekonomike, ndërsa vetëm 17.65% janë anëtare.

Në bazë të pyetësorit, ndërmarrjet të cilat janë të anëtarësuara kishin opSION të lirë për të listuar të gjithë odat e ekonomike tek të cilat janë anëtare, ashtu që disa NVM janë anëtare në më tepër se një odë ekonomike, dhe rezultatet janë si në vijim: 8 ndërmarrje, rrespektivisht 72.73% nga totali i përgjigjeve, deklarojnë se janë anëtare në Odën ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP), 2 ndërmarrje, rrespektivisht 18.18% në Odën ekonomike të Maqedonisë Veriore (OEMV), dhe 1 ndërmarrje, rrespektivisht 9.09% në Odën ekonomike të Maqedonisë të teknologjive të informacionit dhe komunikimit (MASIT).

Për më tepër, nga ndërmarrjet e anëtarësuara, 88.89% janë deklaruar se i fitojnë shërbimet e duhura për të cilat kanë nevojë, ndërsa vetëm 11.11% kanë deklaruar të kundërtën.

*Grafiku 14 Odat ekonomike në të cilat janë të anëtarësuara NVM-të*



### ***Niveli i përkrahjes së NVM-ve nga institucionet relevante***

Sa i përket qeverisjes qendrore, shumica e ndërmarrjeve me rreth 47.06% janë deklaruar se rallë herë kanë përkrahje nga këto institucione, 35.29% janë deklaruar se vetëm ndonjëherë kanë përkrahje, ndërsa 17.65% janë deklaruar se asnjëherë nuk kanë përkrahje. Asnjë ndërmarrje nuk është deklaruar se ka pasur përkrahje shpesh apo gjithmonë nga qeverisja qendrore.

Sa i përket qeverisjes lokale, shumica e ndërmarrjeve me rreth 68.63% janë deklaruar se asnjëherë nuk kanë përkrahje nga këto institucione, 23.53% janë deklaruar se vetëm rrallë kanë përkrahje, 5.88% ndonjëherë, ndërsa 1.96% janë deklaruar se gjithmonë kanë përkrahje. Asnjë ndërmarrje nuk është deklaruar se ka pasur përkrahje shpesh nga qeverisja lokale.

- Në kontakt me përfaqësues të Zyrave për zhvillim ekonomik lokal, konstatimi i përgjithshëm është se këto zyra nuk kanë buxhet të dedikuar për mbështetjen financiare dhe jofinanciare të NVM-ve. Mirëpo, pasi që në mënyrë kontinuele kanë pasur dhe kanë mbështetje nga donatorë të huaj, si pjesë e këtyre projekteve ndonjëherë benefitet i vjelin NVM-të, por në formë të ndonjë përkrahjeje jofinanciare, të tilla si: trajnime, këshilla, konsulencë, etj., ndërsa për sa u përket përkrahjeve financiare në periudhën e analizuar, e vetmja formë e përkrahjes së tillë është realizuar nga komuna e Tetovës në bashkëpunim me USAID, të cilët formuan fondin për përkrahjen e femrës sipërmarrëse në shume prej 30,000 EUR në periudhën 2016-2017. Përkrahje financiare të tjera nga qeverisja lokale nuk ka pasur.

Sa i përket QZHRP-së<sup>21</sup>, gati se të gjithë ndërmarrjet me rreth 96.08% janë deklaruar se asnjëherë nuk kanë përkrahje nga ky institucion, vetëm 1.96% janë deklaruar se rrallë kanë përkrahje, si dhe 1.96% të tjera janë deklaruar se shpesh kanë përkrahje. Asnjë ndërmarrje nuk është deklaruar se ka pasur përkrahje ndonjëherë apo gjithmonë nga QZHRP.

- Në kontakt me udhëheqësin e QZHRP-së, konstatimi i përgjithshëm është se QZHRP është më shumë e koncentruar në realizimin e programës së saj vjetore, në


<sup>21</sup> Qendra për zhvillim rajonal të Pollogut

bashkëpunim të ngushtë me Byronë për zhvillim të barabartë rajonal, dhe në implementimin e projekteve të fituara nga IPA fondet dhe institucionet tjera në R. e Maqedonisë. Ky program përshinë lëmi të ndryshme të zhvillimi të rajonit, të tilla si: infrastruktura, mbrojtja e ambientit, arsimit, ekonomia, etj. Organi kompetent për bashkëpunim me NVM-të është qendra e biznesit e themeluar në kuadër të QZHRP-së në vitin 2016, me mbështetje nga UNDP. Në periudhën 1 vjeçare të themelimit të kësaj qendre, UNDP-ja e ka mbështetur atë në mënyrë teknike në përgatitjen e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal dhe krijimin e doracakut për investime në rajonin e Pollogut. Mirëpo, problemi qëndron në faktin se kapaciteti i kësaj qendre është i limituar, për shkak se ka vetëm një të punësuar, si dhe nuk ka buxhet vetanak për aktivitete përkrahëse të NVM-ve.

Sa u përket odave ekonomike, përsëri shumica e ndërmarrjeve me rreth 64.71% janë deklaruar se asnjëherë nuk kanë përkrahje nga to, 17.65% janë deklaruar se vetëm ndonjëherë kanë përkrahje, 13.73% rrallë, ndërsa 3.92% janë deklaruar se gjithmonë kanë përkrahje. Asnjë ndërmarrje nuk është deklaruar se ka pasur përkrahje shpesh nga odat ekonomike.

Dhe në fund, sa i përket sektorit joqeveritar, përsëri shumica e ndërmarrjeve, rreth gjysma e tyre me 49.02% janë deklaruar se asnjëherë nuk kanë përkrahje nga ai, 21.57% janë deklaruar se vetëm rrallë kanë përkrahje, 15.69% ndonjëherë, 9.80% shpesh, ndërsa 3.92% janë deklaruar se gjithmonë kanë përkrahje.

*Grafiku 15 Përkrahja e NVM-ve nga institucionet relevante*



**Përkrahjet financiare dhe jofinanciare të NVM-ve**


Lidhur me aplikimin për ndonjë lloj përkrahje nga institucionet relevante, ashtu siç është përzgjedhur edhe mostra fillestare, rreth 2/3 apo 68.63% e ndërmarrjeve janë deklaruar se kanë aplikuar për një të tillë, ndërsa rreth 1/3 apo 31.7% e ndërmarrjeve janë deklaruar se nuk kanë aplikuar për asnjë lloj përkrahje.

Nga ndërmarrjet të cilat janë deklaruar se kanë aplikuar për ndonjë lloj përkrahje, rrespektivisht 35 ndërmarrje, të gjitha kanë aplikuar për përkrahje financiare, ndërsa vetëm 7 prej tyre kanë aplikuar edhe për përkrahje jofinanciare në të njejtën kohë. Asnjë nga ndërmarrjet nuk ka aplikuar vetëm për përkrahje jofinanciare.

### ***Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për ndonjë lloj përkrahjeje***

Sa i përket dokumentacionit i cili në përgjithësi kërkohej gjatë procesit të aplikimit për përkrahjen e marrë, sipas pyetësorit NVM-të kanë pasur mundësinë e përzgjedhjes së më tepër opsioneve nga ato të propozuara. Nga numri total i përgjigjeve, rrespektivisht 171, natyrisht në 35 raste është kërkuar kërkesa apo fletëaplikimi që reprezenton 20.47% nga të njejtat. Dokumentacioni i dytë më i kërkuar në 27 raste, rrespektivisht 15.79% nga totali i përgjigjeve, janë llogaritë përfundimtare (bilanci i gjendjes dhe i suksesit) dhe vërtetimi nga DAP. Në vijim pasojnë certifikata e biznesit nga regjistri qëndror në 26 raste, rrespektivisht 15.20%, boniteti i ndërmarrjes në 21 raste, rrespetivisht 12.28%, biznesi plani në 18 raste, rrespektivisht 10.53%, fatura për furnizimin e makinave/pajisjeve në 13 raste, rrespektivisht 7.60%. Më pak e kërkuar dhe vetëm në 3 raste është pjesëmarrja në investim, rrespektivisht 1.75%, si dhe në 1 rast, rrespektivisht 0.58% janë kërkuar dokumente të tjera të paspecifikuara.

***Grafiku 16 Dokumentacioni i kërkuar gjatë aplikimit për përkrahjet relevante***



Nga ndërmarrjet të cilat kanë aplikuar për ndonjë lloj përkrahje, 88.57% kanë deklaruar se nuk kanë hasur vështirësi gjatë përgatitjes së dokumentacionit për aplikim, ndërsa 11.43% kanë deklaruar se kanë hasur në vështirësi.

Nga ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar se kanë hasur vështirësi gjatë përgatitjes së dokumentacionit për aplikim për ndonjë lloj përkrahjeje, vetëm 75% kanë dhënë arsytim për të njejtën. Ndër arsyet e dhëna janë: shpalljet nga institucionet shtetërore shpesh janë të paqarta dhe në thelb egzistojnë nënkushte me të cilat NVM-të përballen gjatë procesit të


aplikimit, vështirësi të tjera teknike dhe permbajtësore varësisht nga aplikimi, joplanifikim i mirë i buxhetit.

### ***Institucionet nga ku është marrë përkrahja e shfrytëzuar dhe lartësia e mjeteve***

Sa u përket institucioneve prej ku më së tepërmi janë shfrytëzuar përkrahje, ndërmarrjet e anketuara kanë pasur mundësinë e të zgjedhurit të më tepër opsioneve nga ato të propozuara. Nga të dhënat e pyetësorit mund të vërejmë se disa ndërmarrje kanë shfrytëzuar përkrahje nga më tepër se një institucion. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 49, institucionet më të përzgjedhura, në 33 raste, nga të cilat është fituar përkrahje janë UNDP, Ministria për punë dhe politik sociale dhe Agjensioni për punësim, rrespektivisht përmes masave aktive për punësim, të cilat reprezentojnë 67.35% nga totali i përgjigjeve. Në vijim, në 4 raste, rrespektivisht 8.16% nga totali i përgjigjeve, është shfrytëzuar përkrahje nga Agjensioni për përkrahjen e sipërmarrësisë në RM, në 3 raste, rrespektivisht 6.12% është shfrytëzuar përkrahje nga projekte nga organizata joqeveritare, ndërsa në nga 2 raste, rrespektivisht 4.08% nga EU fonde dhe SDC në kategorinë e projekteve nga donatorë të huaj. Institucionet prej ku më së paku janë shfrytëzuar përkrahje nga ndërmarrjet, me nga 1 rast, rrespektivisht 02.04% janë Fondi për zhvillim të inovacioneve dhe zhvillimit teknologjik, Agjensioni për financim të bujqësisë dhe zhvillimit rural, dhe USAID, GTZ dhe UNDP në kategorinë e projekteve nga donatorë të huaj. Sa u përket Ministrisë së ekonomisë dhe sektorëve të saj të posaçëm, Bankës Maqedonase për përkrahje të zhvillimit dhe projekteve nga dhomat ekonomike, asnjë nga ndërmarrjet e anketuara nuk ka shfrytëzuar ndonjë lloj përkrahje nga këto institucione.


*Grafiku 17 Institucionet nga ku është marrë përkrahja e shfrytëzuar*






Në rastet kur është shfrytëzuar ndonjëra nga masat aktive për punësim si formë e përkrahjes, ndërmarrjet përsëri kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së më tepër opsioneve nga ato të propozuara. Nga të dhënat e pyetësorit, përsëri mund të vërejmë se ka ndërmarrje të cilat kanë shfrytëzuar më tepër se një masë nga të mëposhtmet. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 50, masa më e shfrytëzuar, në 20 raste, është “Maqedonia punëson 1 dhe 2”, që reprezenton 40% nga totali i përgjigjeve. Në vijim, në 11 raste, rrespektivisht 22% nga totali i përgjigjeve, është shfrytëzuar masa e punësimeve me subvencionim, në 6 raste, rrespektivisht 12% masa e vetëpunësimit, në nga 4 raste, rrespektivisht 8% masa për formalizim të biznesit dhe masa për praktikantë. Masa më pak të shfrytëzuara nga ndërmarrjet janë përkrahja e NVM-ve për krijim të vendeve të reja të punës përfaqësuar nga 3 raste, rrespektivisht 6%, kredi për punësime të reja përfaqësuar nga 1 rast, rrespektivisht 2%, dhe punësimi i personave me nevoja të veçanta në kategorinë të tjera, gjithashtu përfaqësuar nga 1 rast, që rrespektivisht reprezenton 2% nga totali i përgjigjeve. Masa të cilat nuk janë përdorur aspak nga asnjëra prej ndërmarrjeve të anketuara janë trajnime për të punësuarit dhe kredi për startim të biznesit.

Grafiku 18 Masat aktive për punësim të shfrytëzuara nga NVM-të



Sa i përket lartësisë së mjeteve financiare apo jofinanciare që ndërmarrjet i kanë shfrytëzuar për bizneset e tyre nga institucionet relevante, 41.18% e ndërmarrjeve kanë shfrytëzuar përkrahje në vlerë 3000-5000 EUR, 20.59% në vlerë 0-3000 EUR, 20.59% të tjera në vlerë 5000-10000 EUR, 11.76% në vlerë 10000-20000 EUR dhe 5.88% në vlerë 20000-30000 EUR. Asnjë nga ndërmarrjet e anketuara nuk ka shfrytëzuar ndonjë përkrahje në vlerë më të madhe se 30000 EUR.

*Grafiku 19 Lartësia e mjeteve financiare apo jofinanciare të shfrytëzuara nga NVM-të në formë të përkrahjes*




**Qëllimet për të cilat janë shfrytëzuar përkrahjet financiare dhe jofinanciare**

Në rastet kur ndërmarrjet kanë shfrytëzuar ndonjë lloj të përkrahjeve financiare, në pyetësor kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së më tepër opsioneve nga ato të propozuara, si qëllime për të cilat janë shfrytëzuar këto përkrahje. Nga të dhënat e pyetësorit, mund të vërejmë se ka ndërmarrje të cilat i kanë shfrytëzuar këto përkrahje për më tepër se një qëllim. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 65, qëllimet për të cilat më së tepërmi janë shfrytëzuar ky lloj i përkrahjeve janë për kontribute të rrogave për të punësuarit në 21 raste, që reprezentojnë 32.31% të totalit të përgjigjeve dhe për punësime


të reja në 19 raste, që reprezentojnë 29.23% të totalit të përgjigjeve. Qëllimet në vijim janë: maqina dhe pajisje në 14 raste, rrespektivisht 21.54%, furnizim me lëndë të parë në 5 raste, rrespektivisht 7.69%, si dhe adaptim/renovim i objektit/ve afariste në 3 raste, rrespektivisht 4.62%. Përkrahjet financiare më pak janë shfrytëzuar për qëllim të zhvillimit të produkteve apo shërbimeve të reja, në vetëm 2 raste, rrespektivisht 3.08% dhe rifinancim apo pagesa të detyrimeve, në vetëm në 1 rast, që rrespektivisht reprezenton 1.54% nga totali i përgjigjeve. Asnjë nga ndërmarrjet e anketuara nuk i ka shfrytëzuar këto përkrahje për implementim të standardeve ndërkombëtare apo për ndonjë qëllim tjetër.

*Grafiku 20 Qëllimet e shfrytëzimit të përkrahjes financiare nga NVM-të*



Në rastet kur ndërmarrjet kanë shfrytëzuar ndonjë lloj të përkrahjeve jofinanciare, në pyetësor kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së më tepër opsioneve nga ato të propozuara si qëllime për të cilat janë shfrytëzuar këto përkrahje. Nga të dhënat e pyetësorit, mund të vërejmë se ka ndërmarrje të cilat i kanë shfrytëzuar këto përkrahje për më tepër se një qëllim. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 12, qëllimet për të cilat më së tepërmi janë shfrytëzuar ky lloj i përkrahjeve janë për këshilla/ konsulencë afariste në 6 raste, që reprezentojnë 50% të totalit të përgjigjeve dhe për trajnime seminare, punëtori dhe konferenca në 5 raste, që reprezentojnë 41.67% të totalit të përgjigjeve. Përkrahjet jofinanciare më pak janë shfrytëzuar për shërbime konsulente për përgatitje të dokumentacionit për implementim të standardeve ndërkombëtare, në vetëm 1 rast, që rrespektivisht reprezenton 8.33% nga totali i përgjigjeve. Asnjë nga ndërmarrjet e anketuara nuk i ka shfrytëzuar këto lloj të përkrahjeve për pjesëmarrje në panairë vendore apo ndërkombëtare apo për ndonjë qëllim tjetër.

*Grafiku 21 Qëllimet e shfrytëzimit të përkrahjes jofinanciare nga NVM-të*



### ***Mjaftueshmëria e mjeteve të shfrytëzuara në formë të përkrahjes***


Sa i përket mjaftueshmërisë së mjeteve të marra në formë të përkrahjes financiare apo jofinanciare nga ana e ndërmarrjeve, 85.29% e tyre kanë deklaruar se këto mjete kanë qenë të mjaftueshme, ndërsa 14.71% kanë deklaruar të kundërtën.

Nga ndërmarrjet të cilat deklarojnë se mjetet e marra në formë të përkrahjes nuk kanë qenë të mjaftueshme, vetëm 80% e tyre kanë dhënë arsytim për të njejtën. Ndër arsyet e dhëna janë: përqindja e ulët e financimit, furnizimi me maqina apo materiale kapin shuma shumë më të mëdha në krahasim me përkrahjet që ofrohen nga shteti, mjetet kanë qenë të mjaftueshme në fillim të veprimtarisë por më pas nuk ka pasur përkrahje shtesë, ose mjetet nuk kanë qenë fare të mjaftueshme për fillimin e veprimtarisë.

### ***Vlerësimi i eksperiencës së përgjithshme të procedurës për sigurimin e përkrahjes financiare/jofinanciare***

Sa i përket vlerësimit të eksperiencës së përgjithshme të procedurës për sigurimin e përkrahjes financiare/jofinanciare nga ndërmarrjet të cilat kanë shfrytëzuar ndonjë lloj të tyre, shumica e ndërmarrjeve, rrespektivisht 32.35% e kanë vlerësuar procesin shumë mirë, 26.47% shkëlqyeshëm, 20.59% mjaftueshëm dhe 17.65% mirë. Vetëm 2.94% e ndërmarrjes e kanë vlerësuar procesin dobët.

***Grafiku 22 Vlerësimi i eksperiencës së përgjithshme të procedurës për sigurimin e përkrahjes financiare/jofinanciare***




### ***NVM-të të cilat nuk e kanë fituar përkrahjen për të cilën kanë aplikuar***

Nga ndërmarrjet të cilat kanë pasur rast të aplikojnë por të mos e fitojnë përkrahjen për të cilën është aplikuar, 66.67% e tyre kanë deklaruar se si arsye për mos fitimin e përkrahjes është jo-transparenca në procesin e zgjedhjes, 16.67% kanë deklaruar se aplikimi nuk i plotësonte kushtet, dhe 16.67% të tjera se aplikimi nuk ishte i mbushur në mënyrë të saktë. Asnjëra nga ndërmarrjet nuk e ka deklaruar si arsye mungesën e dokumentacionit apo pamundësinë e sigurimit të përqindjes së pjesëmarrjes vetanake.

Nga ndërmarrjet e mësipërme, 66.67% nuk pajtohen me arsyen që ju është dhënë, ndërsa vetëm 33.33% pajtohen me të.


Gjithashtu, nga ndërmarrjet të cilat deklarojnë se nuk pajtohen me arsyen që u është dhënë për mos fitimin e përkrahjes për të cilën është aplikuar, vetëm 50% e tyre kanë dhënë arsyetim për të njëjtën. Ndër arsyet e dhëna janë: nuk kanë mundur të garojnë për grant tjetër përderisa kanë qenë shfrytëzues të një granti, nuk ka pasur mjete të mjaftueshme apo nuk u është dhënë asnjë përgjigje apo arsyetim për mos fitimin e përkrahjes për të cilën është aplikuar.

*Grafiku 22 Arsyeja e mos fitimit të përkrahjes për të cilën është aplikuar*



Për më tepër, impakti nga mospranimi i kërkesës/aplikimit për përkrahje financiare/jofinanciare për ndërmarrjet të cilat kanë aplikuar por nuk e kanë fituar përkrahjen e caktuar është si në vijim: 33.33% e këtyre ndërmarrjeve është dashur ti shtyjnë planet, por eventualisht i kanë realizuar, te 33.33% të tjera nuk ka pasur impakt, 16.67% është dashur ti shtyjnë planet dhe tek 16.67% të tjera ngelet për tu parë. Asnjëra nga ndërmarrjet në fjalë nuk ka pasur vështirësi financiare nga mospranimi i aplikimit për përkrahjen e caktuar apo ndonjë impakt tjetër.


*Grafiku 23 Impakti nga mospranimi i kërkesës/aplikimit për përkrahje financiare/jofinanciare*



### ***NVM-të të cilat nuk kanë aplikuar fare për asnjë lloj përkrahjeje***

Lidhur me ndërmarrjet të cilat nuk kanë aplikuar fare për asnjë lloj të përkrahjes, në pyetësor ata kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së më tepër arsyeve për mos aplikim nga ato të propozuara. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 26, si arsye më të shpeshta për mos aplikim janë promovimi i dobët i masave përkrahëse nga institucionet relevante në 9 raste, që reprezentojnë 34.62% nga totali i përgjigjeve dhe mosbesimi në procesin e selektimit në 7 raste, që reprezentojnë 26.92% nga totali i përgjigjeve. Arsyet e tjera për mos aplikim janë si në vijim: mos pasja nevojë për përkrahje të tilla, deklaruar në 4 raste, që reprezentojnë 15.38%, vëllimi i mbështetjes është minor në 3 raste, që reprezentojnë 11.54% dhe jo informimi i duhur nga ana pronarit/ndërmarrjes në 2 raste që reprezentojnë 7.69% nga totali i përgjigjeve. Asnjë nga ndërmarrjet nuk e ka konsideruar si arsye për mos aplikim mos plotësimin e kushteve të kërkuara në shpallje, ndërsa vetëm në një rast nuk është aplikuar për arsye të tjera, të tilla si mos përshtatja e përkrahjeve me nevojat e tyre.

### ***Grafiku 24 Arsyet për mos aplikim për asnjë lloj përkrahjeje***



### ***Lloji i përkrahjes që preferohet më shumë nga NVM-të***

Në rast se të gjitha ndërmarrjeve do tu jepej mundësia që të shfrytëzonin ndonjë lloj përkrahjeje në të ardhmen, 84.31% kanë deklaruar se do të preferonin përkrahjen financiare,

ndërsa vetëm 5.88% atë jo financiare. Pjesa e mbetur prej 9.80% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se do të preferonin të dy llojet e përkrahjeve.


Për më tepër, vetëm 43.14% e ndërmarrjeve kanë dhënë një arsytim për preferimin e njëjës lloji të përkrahjes në krahasim me tjetrën.

Nga ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar se preferojnë përkrahjen financiare, arsyet e dhëna janë si në vijim: ky lloji i përkrahjes i ndihmon ato në procesin e zhvillimit të veprimtarisë dhe rritjes së kapacitetit tyre, në stabilitetin e punës dhe konkurrenshëmërisë në tregjet ku veprojnë, furnizimin me maqina, pajisje dhe repromateriale, për inovacione dhe zhvillim teknologjik, për punësimin e punëtorëve nëpërmjet të subvencionimit të rrogave dhe kontributeve, për të realizuar dhe planifikuar investimet, për të ruajtur likuiditetin, si dhe disa ndërmarrje kanë zgjedhur këtë lloji të përkrahjes për arsye se riallokimi i resurseve mund të bëhet sipas nevojës dhe planifikimit të tyre.

Nga ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar se preferojnë përkrahjen jofinanciare, arsyet e dhëna janë si në vijim: ky lloji i përkrahjes i ndihmon ato në stimulimin e të rinjëve me më shumë trajnime për një të ardhme profesionale dhe në këtë mënyrë për të avancuar fuqinë punëtore që të rrisin efikasitetin dhe shpejtësinë e prodhimit. Një arsye tjetër është edhe mospasja nevojë për përkrahje financiare.

Nga ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar se preferojnë të dy llojet e përkrahjeve, arsyet e dhëna janë si në vijim: për ta nuk ka rëndësi nëse përkrahja është financiare apo jo financiare, me rëndësi është që përkrahja të shkojë në favor të ndërmarrjes (shoqërisë), rrespektivisht të dy llojet e përkrahjes kanë ndikim në rritjen dhe zhvillimin e biznesit.

*Grafiku 25 Lloji i përkrahjes që preferohet më shumë nga NVM-të*




***Qëllimet e shfrytëzimit dhe lartësia e mjeteve të përkrahjeve financiare dhe jofinanciare të cilat NVM-të do të kishin dashur ti shfrytëzoheshin nëse do të jepej mundësia në të ardhmen***

Sa i përket pyetjes lidhur me qëllimet e shfrytëzimit të ndonjë përkrahjeje financiare apo jofinanciare nga institucionet relevante nëse do të jepej mundësia, ndërmarrjet në pyetësor kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së më tepër opsioneve nga ato të propozuara si qëllime për të cilat do të shfrytëzoheshin këto përkrahje. Nga të dhënat e pyetësorit, mund të

vërejmë se ka ndërmarrje të cilat do ti kishin shfrytëzuar këto përkrahje për më tepër se një qëllim. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 153, qëllimi për të cilin më së tepërmi do të shfrytëzoheshin këto përkrahje është për maqina dhe pajisje në 32 raste, që reprezentojnë 20.92% nga totali i përgjigjeve. Në vijim, në 22 raste që reprezentojnë 14.38% nga totali i përgjigjeve do të shfrytëzoheshin për furnizim me lëndë të parë, në 21 raste, rrespektivisht 13.73% për zhvillimin e produkteve apo shërbimeve të reja, në 15 raste, rrespektivisht 9.80% do të shfrytëzoheshin për punësime të reja, në 13 raste, rrespektivisht 8.50% për këshilla/konsulencë afariste, në 11 raste, rrespektivisht 7.19% për kontribute të rrogave të të punësuarve, në nga 10 raste, rrespektivisht 6.54% për adaptim/renovim të objektit/ve afariste dhe për trajnime, seminare, punëtori dhe konferenca. Qëllimet për të cilat do të përdoreshin më pak këto përkrahje janë: implementimi i standardeve ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në panairë vendore apo ndërkombëtare në nga 7 raste, rrespektivisht 4.58%, rifinancim apo pagesa të detyrimeve, në 4 raste, rrespektivisht 2.61% dhe qëllime të tjera të paspecifikuara në 1 rast, që rrespektivisht reprezenton 0.65 nga totali i përgjigjeve.


*Grafiku 26 Qëllimet e shfrytëzimit të përkrahjeve financiare/jofinanciare nga NVM-të nëse do tu jepej mundësia*



Nëse do tu ofrohej mundësia për të shfrytëzuar ndonjë përkrahje financiare/jofinanciare nga institucionet relevante, vlera për të cilën më tepër kanë nevojë ndërmarrjet është 5000-10000 EUR, deklaruar nga 27.45% e ndërmarrjeve. Më pas vijon vlera 20000-30000 EUR, deklaruar nga 23.53% e ndërmarrjeve, 10000-20000 EUR nga 21.57% e ndërmarrjeve dhe mbi 30000 EUR nga 19.61% e ndërmarrjeve. Vlera për të cilën më pak kanë nevojë ndërmarrjet është 3000-5000 EUR, deklaruar nga 7.84% e ndërmarrjeve, ndërsa asnjë prej tyre nuk është deklaruar se ka nevojë për vlerën 0-3000 EUR.




**Grafiku 27** Vlera e përkrahjes për të cilën NVM-të kanë nevojë nëse do tu jepej mundësia e shfrytëzimit të tyre



**Ndikimi i përkrahjeve te NVM-të**

Sa i përket pyetjes lidhur me ndikimin pozitiv që ka pasur/do të kishte shfrytëzimi i përkrahjeve paraprake, ndërmarrjet në pyetësor kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së më tepër opsioneve nga ato të propozuara. Nga të dhënat e pyetësorit, mund të vërejmë se ka ndërmarrje të cilat deklarojnë se përkrahjet paraprake kanë pasur/do të kishin ndikim pozitiv në më tepër se një sferë nga të mëposhtmet. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 153, ndërmarrjet janë deklaruar se ndikim pozitiv kanë pasur/do të kishin më së tepërmi në sferën e rritjes së numrit të vendeve të reja të punës në 31 raste që reprezentojnë 60.78% nga totali i përgjigjeve, rritjen e qarkullimit vjetor të ndërmarrjes në 26 raste, rrespektivisht 50.98% dhe përmirësimin e teknologjisë së punës në 21 raste, rrespektivisht 13.73% nga totali i përgjigjeve. Në vijim pasojnë përmirësimi i kualitetit të produktit/shërbimit i përzgjedhur në 17 raste, rrespektivisht 11.11%, furnizimi me lëndë të parë në 14 raste, rrespektivisht 9.15%, përmirësimi i kushteve të punës në objektin/et afariste dhe përmirësimi i aftësive/shkathtësive të të punësuarve të përzgjedhura në nga 13 raste, rrespektivisht 8.50% dhe depërtimi në tregje të reja lokale/rajonale në 12 raste, që rrespektivisht reprezentojnë 7.84% nga totali i përgjigjeve. Opsioni i cili nuk është përzgjedhur në asnjë rast është themelimi i biznesit.


**Grafiku 28** Ndikimi pozitiv që ka pasur/do të kishte shfrytëzimi i përkrahjeve financiare/jofinanciare nga ana e NVM-ve



### **Nevoja e NVM-ve për përkrahje financiare dhe jofinanciare në 5 vitet e fundit**

Sa i përket nevojës për përkrahje financiare dhe jofinanciare, 64.71% e ndërmarrjeve, apo më tepër se gjysma e tyre, kanë deklaruar se ajo është rritur në 5 vitet e fundit, 33.33% thonë se nuk ka ndryshuar dhe vetëm 1.96% e tyre kanë deklaruar se kjo nevojë është zvogëluar.


*Grafiku 29 Nevoja për përkrahje financiare dhe jofinanciare në 5 vitet e fundit*



### **Kanalet e informimit të NVM-ve për përkrahjet e disponueshme financiare dhe jofinanciare**

Lidhur me kanalet e informimit të ndërmarrjeve për përkrahjet e disponueshme financiare dhe jofinanciare, në pyetësor ata kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së më tepër kanaleve nga ato të propozuara. Në bazë të të dhënave nga pyetësorët, nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 83, opsionet më të përzgjedhura janë kontaktet personale të biznesit në 34 raste që reprezentojnë 40.96% nga totali i përgjigjeve dhe komunikimi masiv i medias në 28 raste që reprezentojnë 33.73% nga totali i përgjigjeve. Në vijim, në 8 raste është përzgjedhur opsioni burime nga qeveria, respektivisht 9,64%, në 5 raste anëtarësimi në asociacione tregtare që reprezentojnë 6.02%, dhe burime të tjera si: nga kontabilisti, ueb faqet e institucioneve përkatëse dhe ESA TE.

*Grafiku 30 Kanalet e informimit për përkrahjet e disponueshme financiare/jofinanciare*




### **Masat e domosdoshme që sipas NVM-ve nevojiten për përmirësimin e performancës së tyre në tregjet ku veprojnë**

Lidhur me masat e domosdoshme që sipas NVM-ve nevojiten për përmirësimin e performancës së tyre në tregjet ku veprojnë, në pyetësor ata përsëri kanë pasur mundësinë

e zgjedhjes së më tepër masave nga ato të propozuara. Nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve, gjithësej 172, masat më të përzgjedhura janë subvencionimi i investimeve të reja nga institucionet qendrore/vendore dhe zhvillimi i përgjithshëm i fushave të ndryshme të shoqërisë (ekonomisë, teknologjisë, arsimit, ekologjisë, bujqësisë, etj.) në 24 raste që reprezentojnë nga 13.95% nga totali i përgjigjeve, edukimi (rikualifikimi, kualifikimi i mëtutjeshëm dhe trajnimi) i kuadrove, në 22 raste, rrespektivisht 12.79%, mjetet stimuluuese, masat aktive për themelimin e bizneseve, punësimet dhe trajnimet në 21 raste, rrespektivisht 12.21, fondet për përkrahjen e inovacioneve në ndërmarrje në 20 raste, rrespektivisht 11.63% nga totali i përgjigjeve, etj. Si masë më pak të domosdoshme për përmirësimin e performancës në tregjet në të cilat veprojnë, NVM-të kanë zgjedhur përmirësimin e menaxhmentit të ndërmarrjes, deklaruar në 11 raste, që rrespektivisht reprezenton 6.40% nga totali i përgjigjeve.

*Grafiku 31 Masat e domosdoshme që sipas NVM-ve nevojiten për përmirësimin e performancës së tyre në tregjet ku veprojnë*



***Propozime për shërbimet të cilat duhet ti sigurojë pushteti qëndror/lokal për përmirësimin e bashkëpunimit me sektorin afarist***

Sa u përket propozimeve shtesë për shërbimet të cilat duhet ti sigurojë pushteti qëndror/lokal për përmirësimin e bashkëpunimit me sektorin afarist, vetëm 21.57% nga totali i ndërmarrjeve të anketuara kanë dhënë ndonjë propozim. Propozimet e dhëna janë si në vijim: të ketë kushte konkurruese reale në praktikë, për të gjithë ndërmarrjet, takime sa më të shpeshta në zyrat e pushtetit lokal në lidhje me bizneset apo risitë e reja ligjore, takime më të shpeshta me odat ekonomike dhe bizneset si dhe shpërndarja e drejtë e mjeteve, të ritet shuma e mbështetjes financiare që jep Ministria e Ekonomisë dhe të ketë lehtësime në aplikimin e IPARD fondeve, pushteti lokal dhe qendror duhet të mos perzihen në biznese (të mos kerkojnë rryshfet) dhe ti lehtësojnë ata me infrastrukturë dhe klimë për biznes, beneficionet që u jepen investitorëve të huaj, po të njëjtat tu ofrohen edhe

investitorëve/ndërmarrjeve vendore, të ketë lehtësim të procedurave për licencim dhe rilicencim, rregullat e njëjta të vlejshme për të gjithë ndërmarrjet, të organizohen më shumë trajnime profesionale, seminare për të përmirësuar gjendjen e çdo ndërmarrjeje, edukim i kuadrove në institucionet shtetërore, alokimi i të punësuarve në vende të punës sipas drejtimit të tyre profesional, administratë më efikase, zhvillim i teknologjisë në administratë, zhvillim i punëtorëve të moshës më të vjetër nëpërmjet trajnimeve për përdorim të mjeteve të reja teknologjike si dhe organizimi i panairëve me qëllim të njoftimit të konsumatorëve me ofertat e biznesit.

## 6. Përfundime, rekomandime dhe kufizimet e studimit

### 6.1 Përfundime

Analiza e të dhënave nga ky studim vërteton hipotezën e parë se subvencionet financiare dhe jofinanciare kanë një rol të rëndësishëm në performancën ekonomike të NVM-ve. Duke pasur parasysh se 2-3 vitet e para të ekzistencës së bizneseve paraqesin periudhën më të vështirë të performimit të tyre, rëndësia më e madhe këtyre përkrahjeve qëndron pikërisht në këtë periudhë kur ndërmarrjet ende nuk e kanë zhvilluar si duhet rrjetin e furnitorëve, kapacitetin e prodhimit, nuk kanë definuar mirë tregun në të cilin veprojnë, kanë mungesë të mjeteve financiare, pajisjeve, resurseve njerëzore, etj. Për këtë arsye, përkrahjet të cilat u ofrohen NVM-ve, në veçanti ato financiare, janë të mirëseardhura nga to dhe u ndihmojnë

në nivel signifikant që të tejkalojnë më me lehtësi këtë periudhë të veprimtarisë së ndërmarrjes. Krahas ndërmarrjeve fillestare edhe ndërmarrjet të cilat veprojnë në treg mbi tre vite, poashtu kanë nevojë për përkrahje financiare dhe jofinanciare. Nevojat e këtyre ndërmarrjeve janë të ndryshme, por kryesisht kanë të bëjnë me sigurimin e mjeteve financiare që do të kenë ndikim në rritjen dhe zhvillimin e ndërmarrjes apo të rruajtjes së konkurrueshmërisë së tyre në tregun ku veprojnë. Për më tepër, nga të dhënat e pyetësorit mund të vërejmë se shfrytëzimi i përkrahjeve financiare dhe jofinanciare, më së tepërmi ka pasur ndikim në rritjen e numrit të të punësuarve, rritjen e qarkullimit vjetor të ndërmarrjes, përmirësimin e teknologjisë së punës, përmirësimin e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve, etj., (Grafiku 28).

Ky studim poashtu reflekton pozitivisht edhe situatën në lidhje me vëllimin dhe dinamikën e përkrahjeve financiare dhe jofinanciare të cilat nuk i plotësojnë nevojat reale të NVM-ve në funksion të realizimit të objektivave biznesore, që njëherit paraqet edhe hipotezën e dytë me rradhë. Vërtetimi i kësaj hipoteze mund të vërehet nga analiza e të dhënave nga buxhetet vjetore (Tabela 6, 7, 8) të institucioneve relevante që i sigurojnë këto përkrahje financiare dhe jofinanciare për NVM-të dhe të dhënat nga pyetësi lidhur me vëllimet e mjeteve të shfrytëzuara (Grafiku 19) nga ana e ndërmarrjeve dhe vëllimet e mjeteve të cilat ndërmarrjet do të kishin dëshiruar ti shfrytëzojnë në formë të përkrahjes po tu jepej mundësia (Grafiku 27) për zhvillim të mëtutjeshëm të biznesit të tyre. Pavarësisht se shumica e ndërmarrjeve që kanë shfrytëzuar ndonjë lloj të përkrahjes, kanë shfrytëzuar përkrahje në vlerë prej 3000-5000 EUR dhe kanë deklaruar së keto mjete kanë qenë të mjaftueshme në momentin që janë marrë, në pyetjen e rradhës se sa do të kishin dashur të marrin mjete në formë të përkrahjes, gati se të gjithë kanë deklaruar shuma më të mëdha sesa ajo që kanë shfrytëzuar, duke pohuar në të njëjtën kohë se nevoja për përkrahje të tilla është rritur në 5 vitet e fundit (Grafiku 29). Për më tepër, dinamika e realizimit të përkrahjeve bëhet kryekëput sipas programeve realizuese të institucioneve relevante, dhe jo në bazë të kërkesave të ndërmarrjeve dhe tregut. Kështu që, ndodh që shpalljet për përkrahje të këtilla të mos bëhen në fillim të vitit (janar/shkurt) por kah mesi i vitit (maj/qershor) ose në pjesën e dytë të vitit, për arsye të pakuptimta, të tilla si: vonesa teknike, zgjedhje të shpeshta të parakohshme, ndryshime të shpeshta të organeve udhëheqëse të institucioneve përkatëse, mungesë e komisioneve për vlerësim, mos nënshkrimi i marrëveshjeve në mes të bashkëpunëtorëve, mungesë e mjeteve financiare për sigurimin e përkrahjeve, etj. Si rezultat i pengesave të mësipërme, si dhe vonesave në procedurat e selektimit të ndërmarrjeve kandidatë për përfitimin e ndonjë lloj përkrahjeje dhe pagesave të vonuara të përkrahjeve të fituara, është e pamundur që programet dhe projektet për përkrahje financiare dhe jofinanciare të realizohen brenda vitit kalendarik dhe të njëjtat prolongohen për periudha të caktuara të cilat janë jo të përshtatshme dhe jofrytëdhënëse për NVM-të.

Për më tepër, në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor që ishin pjesë e këtij studimi, sa i përket vëllimit dhe dinamikës së përkrahjeve financiare dhe jofinanciare, R. e

Maqedonisë qëndron në pozitë më të mirë se Shqipëria dhe Kosova, por më dobët se Serbia, tek e cila si për nga volumi, ashtu edhe nga lloji, ekzistojnë më shumë forma të përkrahjeve financiare dhe jofinanciare të NVM-ve nga më tepër institucione relevante.

Në vijim, ky studim vërteton edhe hipotezën e tretë me rradhë, lidhur me mungesën e kapaciteteve funksionale të qendrave rajonale për përkrahje të NVM-ve që pamundëson shfrytëzimin më voluminoz të subvencioneve të ofruara nga institucionet qëndrore në rajonin e Pollogut. Kjo më së miri mund të vërehet nga të dhënat e pyetësorit (Grafiku 15), ku më tepër se gjysma e ndërmarrjeve deklarojnë se asnjëherë ose rallë kanë pasur përkrahje nga institucionet relevante. Në kontakt me përfaqësues të Zyrave për zhvillim ekonomik lokal, konstatimi i përgjithshëm është se këto zyra nuk kanë buxhet të dedikuar për mbështetjen financiare dhe jofinanciare të NVM-ve. Mirëpo, pasi që në mënyrë kontinuele kanë pasur dhe kanë mbështetje nga donatorë të huaj, si pjesë e këtyre projekteve ndonjëherë benefitet i vjelin NVM-të, por në formë të ndonjë përkrahjeje jofinanciare. Për më tepër, Në kontakt me udhëheqësin e QZHRP-së, konstatimi i përgjithshëm është se QZHRP është më shumë e koncentruar në realizimin e programës së saj vjetore, në bashkëpunim të ngushtë me Byronë për zhvillim të barabartë rajonal, dhe në implementimin e projekteve të fituara nga IPA fondet dhe institucionet tjera në R. e Maqedonisë. Organi kompetent për bashkëpunim me NVM-të është qendra e biznesit e themeluar në kuadër të QZHRP-së në vitin 2016, me mbështetje nga UNDP. Mirëpo, problemi qëndron në faktin se kapaciteti i kësaj qendre është i limituar, për shkak se ka vetëm një të punësuar, si dhe nuk ka buxhet vetanak për aktivitete përkrahëse të NVM-ve. Gjithashtu, hulumtimi tregon se ekziston një mungesë e lidhshmërisë në mes të institucioneve qëndrore të cilat kanë programe buxhetore për sigurimin e përkrahjeve financiare dhe jofinanciare të NVM-ve, me ato rajonale/lokale të cilët duhet të bëjnë implementimin praktik të këtyre përkrahjeve. E gjithë kjo, më së miri mund të vërehet nga faktet në vijim: në rastin e Ministrisë së Ekonomisë, Drejtorisë për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik dhe Agjencisë për Investime të Huaja dhe Promovimin e Eksportit të RM-së si dhe Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik, nëse ndërmarrjet duan të aplikojnë për ndonjë lloj të përkrahjes, duhet që aplikimet ti dërgojnë direkt te këto institucione, respektivisht nuk ekziston mundësia e aplikimit tek ndonjë qendër rajonale/lokale prej ku vijnë ndërmarrjet, ndërsa në rastin e Masave aktive për punësim, ato implementohen në bashkëpunim me Agjencitë për punësim të cilat janë të centralizuara dhe i raportojnë qendrës në Shkup, të cilat poashtu nuk kanë aspak lidhshmëri me institucionet komunale dhe rajonale. Momentalisht, APSRM është i vetmi institucion i cili e realizon programën e tij vjetore në bashkëpunim me qendrat rajonale për përkrahje të ndërmarrjeve, mirëpo përzgjedhja e këtyre institucioneve për bashkëpunim realizohet përmes shpalljes publike dhe jo si pjesë e ndonjë sistemi praktik dhe funksional për përkrahjen e vazhdueshme të NVM-ve.

Në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor, që ishin pjesë e këtij studimi, R. e Maqedonisë qëndron në pozitë pak më të mirë se Shqipëria, ku sistemi i aplikimeve për

çfarëdo lloj përkrahjeje nga NVM-të është totalisht i centralizuar dhe realizohet dhe menaxhohet vetëm nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), si dhe pak më mirë se Kosova, ku përsëri për çfarëdo lloj përkrahjeje ndërmarrjet duhet të aplikojnë tek institucionet përkatëse që i ofrojnë të njejtat, dhe jo përmes qendrave rajonale/lokale. Sërbia, është e vetmja për tu marrë shembull, pasi që implementimin e të gjithë programeve të institucioneve përkatëse e realizon përmes Agjencisë Kombëtare për Zhvillim Rajonal (NARR) si dhe Agjencitë e Akredituara për Zhvillim Rajonal (ARRA).

## 6.2 Rekomandime

Disa rekomandime lidhur me përmirësimin e procesit të ofrimit dhe implementimit të përkrahjeve financiare dhe jofinanciare në RM, janë si në vijim:

- Përcaktimi i një dinamike optimale dhe strikte në implementimin e programeve dhe projekteve për përkrahje financiare dhe jofinanciare, rrespektivisht të mos ketë prolongime të panevojshme të cilat do të zbehnin interesimin dhe besimin për realizimin praktik të të njejtave nga ana e NVM-ve.
- Implementimi i procedurave formale për realizimin praktik të përkrahjeve të jetë transparent dhe pa ndikime anësore (të tilla si politike, etnike, etj.), me qëllim që të rritet besueshmëria e NVM-ve në sistemin e ofrimit të këtyre përkrahjeve dhe të rritet numri i aplikuesve.
- Të zhvillohen trajnime kontinuale për avancimin e njohurive dhe aftësive të të gjithë atyre që janë të kyçur në sistemin e përkrahjeve financiare dhe jofinanciare të ndërmarrjeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore.
- Përcaktimi dhe aprovimi i masave për përkrahje financiare dhe jofinanciare të bëhet në bazë të hulumtimeve të tregut të realizuara nga institucionet relevante në periudha 2 deri 4 vjeçare, me qëllim të inçizimit të situatës reale dhe aktuale që do të ndihmonte në gjetjen e problemeve, nevojave dhe kërkesave të ndërmarrjeve bazuar në trendet e zhvillimit ekonomik. Në këtë mënyrë definimi i politikave dhe programeve të përkrahjeve do të ishte më real se sa ai që bëhet tani pa ndonjë strategji të definuar.
- Ndërtimi i një sistemi apo rrjeti funksional për realizimin e përkrahjeve financiare dhe jofinanciare nga niveli qendror deri te ai lokal me përgjegjësi të definuara, si dhe formimi i qendrave rajonale formale si pjesë e këtij rrjeti. Qendrat rajonale mund të formohen në bazë të principit të ndarjes territoriale për zhvillim të barabartë të RM-së (8 rajone ekzistuese), ashtu që në secilin rajon të ketë një qendër që posedon me kapacitetet e nevojshme teknike, njerëzore dhe financiare të cilat do të mund të realizonin programet dhe projektet e institucioneve qendrore dhe rajonale/lokale të dedikuara për përkrahje të NVM-ve.



- Monitorimi dhe analiza e trendeve dhe standardeve Evropiane dhe globale në këtë fushë dhe propozimi i iniciativave shtesë për implementim në RM.

### 6.3 Kufizimet e studimit dhe hulumtimet e ardhshme

Gjatë procesit të realizimit praktik të këtij studimi nuk ka pasur kufizime të cilat drejtpërsëdrejti kanë ndikuar në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave relevante.

Lidhur me hulumtimet e ardhshme të cilat mund të realizohen në këtë drejtim që të fitohet një pasyrë më reale, është zgjerimi i territorit të studimit, në kuptim të analizës së ndikimit të përkrahjeve financiare dhe jofinanciare të NVM-të në R. e Maqedonisë Veriperëndimore si dhe në nivel të shtetit.

## 7. Literatura

AIDA. (2018). Retrieved from Fondi i Inovacionit: <http://aida.gov.al/faqe/fondi-i-inovacionit>

AIDA. (2019). Retrieved from Fondi i konkurrueshmërisë: <http://aida.gov.al/faqe/fondi-i-konkurrueshmerise>

AIDA. (2019). Retrieved from Programe Mbështetëse dhe Instrumentet Financiare Qeveritare: <http://aida.gov.al/faqe/programe-mbeshtetese-dhe-instrumentat-qeveritare>

AIDA. (2019). Retrieved from Fondi i Ekonomisë Kreative: <http://aida.gov.al/faqe/fondi-i-ekonomise-kreative>

- AIDA. (2019). Retrieved from *Fondi në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja "Start-up"*: <http://aida.gov.al/faqe/fondi-ne-mbeshtetje-te-sipermarrjeve-te-reja-startup>
- AOFI. (2018). *Agencija za osiguranje i finansiranje izvoza - Program poslovanja za 2018 godinu*. AOFI.
- APPRM. (2018). *Programa za podrška na pretpriemnistvoto, konkurentnosta i inovativnosta na malite i srednite pretpriatija*. *Gazeta Zyrtare e RMV*.
- APPRM. (2019). *Izvestaj za realizacija na programata za podrška na pretpriemnistvo, konkurentnosta i inovativnosta na MSP vo 2018 godina*.
- AVRM. (2019). *Programa za rabota za 2019 godina*. Skopje: AVRМ.
- Carter, S., & Jones-Evans, D. (2006). *Enterprise and Small Business: Principles, Practice and Policy* (2nd ed.). Harlow: Pearson Education.
- Chesbrough, H. W. (2003). *Open innovation: The new imperative for creating and profiting from technology*. Boston: Harvard Business School Press.
- Council of Europe. (1994). *The promotion of small and medium-sized enterprises in Europe*. Strasbourg Cedex.
- Damanpour, F. (1991). *Organizational innovation: a meta analysis of effects of determinants and moderators*. *Academy of Management Journal*, 34.
- Departamenti i Punës dhe Punësimit (MPMS). (2016). *Raporti Vjetor - Puna dhe Punësimi në Kosovë*. MPMS.
- Direkcija za Tehnoloski Industriski Razvojni Zoni. (2019). Retrieved from <http://fez.gov.mk/?lang=MK>
- Drucker, P. (1985). *Innovation and Entrepreneurship*. New York: HarperCollins Publishers, Inc.
- ESA Tetovë. (2016). *Analiza e gjendjes dhe nevojave të sektorit të biznesit në komunën e Tetovës*.
- European Commission. (1996, April 30). L 107. *Official Journal of the European Union*.
- European Commission. (2003). *Commission Recommendation 2003/361/EC of 6 May 2003 concerning the definition of micro, small, and medium enterprises*. *Official Journal of the European Union*, L 124, 36-41.
- European Commission. (2015). *User guide to the SME Definition*. Luxembourg: Publications Office of the EU.
- European Commission. (2018). *European Innovation Scoreboard*. Luxembourg: Publication Office of the European Union.
- European Investment Bank. (2016). *Assessment of financing needs of SMEs in the Western Balkan countries. Country Report: Kosovo*. Luxembourg: European Investment Bank.
- European Investment Bank. (2018). *CESEE Bank Lending Survey - H2 2018*. Luxembourg: European Investment Bank.
- Eurostat. (2019). *R&D Expenditures*. Retrieved from <https://ec.europa.eu/eurostat>
- FID. (2018). *Program Rada Fonda za Inovacionu Delatnost za 2019 Godinu*. Beograd: FID.
- FITR. (2018). *Pravilnik za instrumentot za podrška - Kofinancirani grantovi za mali i sredni pretpriatija so tendencija na brz porast "(Gazeli)"*.

- FITR. (2018). *Pravilnik za instrumentot za podrska - Kofinansirani grantovi a podobruvanje na inovativnosta.*
- FITR. (2018). *Pravilnik za instrumentot za podrska - Kofinansirani grantovi i usloveni zaemi za komercijalizacija na inovacii.*
- FITR. (2018). *Pravilnik za instrumentot za podrska - Kofinansirani grantovi za mikro pretpriatija.*
- FITR. (2018). *Pravilnik za instrumentot za podrska - Kofinansirani grantovi za novoosnovani trgovski drustva "start up" i "spin off".*
- FITR. (2018). *Pravilnik za instrumentot za podrska - Kofinansirani grantovi za strucno usovrsuvanje i praksa za novovraboteni mladi lica.*
- FITR. (2018). *Pravilnik za instrumentot za podrska - Kofinansirani grantovi za tehnoloska ekstenzija.*
- FITR. (2018). *Pravilnik za instrumentot za podrska - Kofinansirani grantovi za vospostavuvanje, rabotenje i investicii na delovno-tehnoloski akseleratori.*
- Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. (2008). *Ligji nr.10183/2008 për ndryshimin e ligjit nr. 8957/2002 për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 199.*
- Fond za inovacii i tehnoloski razvoj. (2019). Retrieved from <http://www.fitr.mk>
- Fond za Razvoj RS. (2018). *Program Fonda za Razvoj Republike Srbije. Fond za Razvoj RS.*
- Gajic, B. (2019). EBRD. Retrieved from EBRD and EU extend support for SMEs to the Republic of North Macedonia: <https://www.ebrd.com/news/2019/ebrd-and-eu-extend-support-for-smes-to-the-republic-of-north-macedonia-.html>
- Gaynor, G. H. (2002). *Innovation by Design: What it Takes to Keep Your Company on the Cutting Edge.* New York: AMACOM.
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji 03/L-031 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Gazeta Zyrtare e Repuplikës së Kosovës.*
- Gazeta zyrtare e RM-së. (2004). *Zakon za Trgovskite Drustva. Gazeta zyrtare e RM-së, 28.* Retrieved 2018, from *Zakon za trgovskite drustva.*
- Gazeta zyrtare e RM-së. (2018). *Programa za konkurentnost, inovacii i pretpriemnistvo za 2018 godina. Gazeta zyrtare e RM-së.*
- Gazeta Zyrtare e RM-së. (2018). *Zakon za Finansiska Podrska na Investicii. Gazeta Zyrtare e RM-së(83).*
- Gazeta Zyrtare e RMV. (2018). *Zakon za Finansiska Podrska na Investicii. Gazeta Zyrtare e RMV.*
- Hyytinen, A., & Toivanen, O. (2003). *Do financial constraints hold back innovation and growth? Evidence on the role of public policy. ETLA Discussion Papers, N. 820.*
- ICK. (2017). *ICK Innovation Fund Grant Manual. ICK.*
- ICK. (2019). *Innovation Centre Kosovo. Retrieved from https://ickosovo.com*
- ICK. (2019). *Voucher support for Business Development Services to start-up teams and prospective entrepreneurs to support start-up establishment. ICK.*

- IEG. (2008). *Financing micro, small and medium enterprises: An Independent Evaluation of IFC's Experience with Financial Intermediaries in Frontier Countries*. Washington: International Finance Corporation, World Bank Group.
- International Trade Centre. (2018). *SME Competitiveness Outlook*. Geneva: International Trade Centre.
- Kadocsa, G. (2006). *Research of Competitiveness Factors of SME*. *Acta Polytechnica Hungarica*, 3, 71-84.
- Këshilli i Ministrave. (2016). *Vendim për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë*. KM.
- Këshilli i Ministrave. (2017). *Vendim për krijimin e Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanatit)*. KM.
- Këshilli i ministrave. (2018). *Vendim për krijimin e Fondit në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja "Start Up"*. KM.
- Këshilli i Ministrave. (2018). *Vendim për krijimin e Fondit të Inovacionit*. KM.
- KfW. (2019). Retrieved from North Macedonia: <https://www.kfw-entwicklungsbank.de/International-financing/KfW-Development-Bank/Local-presence/Europe/Macedonia/>
- KIESA. (2019). Retrieved from Përkrahja e NVM-ve: <https://kiesa.rks-gov.net/>
- Kotler, P. (1991). *Marketing Management*. Prentice Hall.
- Kotler, P., & Keller, K. L. (2006). *Marketing Management*. Upper Saddle River: Prentice Hall.
- Krsteva, V. (2018). *Broj na aktivni delovni subjekti*. Shkup: Enti i shtetëror i statistikës së RM-së. Retrieved from <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?rbtxt=79>
- Manole, D. S., Nisipeanu, E., & Decuseara, R. (2014). *Study on the competitiveness of Small and Medium-sized Enterprises*. *Theoretical and Applied Economics*, XXI.
- MFE. (2018). *Rregullore e funksionimit për Fondin e Inovacionit*. MFE.
- MFE. (2018). *Rregullore e funksionimit për Fondin në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja "Start-up"*. MFE.
- MFE. (2019). *Rregullore e funksionimit për Fondin Shqiptar të Konkurrueshmërisë*. MFE.
- MIN. (2018). *Udhëzim administrativ (MIN) për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve*. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*.
- Ministarstvo Privrede RS. (2015). *MSSP Strategija razvoja i Akcioni Plan 2015-2020*. Ministarstvo Privrede RS.
- Ministria e Ekonomisë. (2018). *Nacionalna Strategija za MSP 2018-2023*. Ministria e Ekonomisë.
- Ministria e Ekonomisë. (2019). Retrieved from <http://www.economy.gov.mk>
- Ministria e Ekonomisë. (2019). *Godisen Plan za rabota vo 2019 godina*. Ministria e Ekonomisë.
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. (2014-2018). *Operativen Plan za aktivni programi i merki za vработuvanje i usluga na pazarot na trudot za 2014-2018 godina*.
- MPMS. (2018). *Rregullore (MPMS) për masat aktive të tregut të punës*. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*.

- MPNTR. (2015). *Zakon o Inovacionoj Delatnosti. Sluzben Glasnik RS.*
- MZHETTS & MF. (2017). *Rregullore e funksionimit për Fondin e Ekonomisë Kreative (Artizanatit). MZHETTS & MF.*
- Naceva, B. (2019). *Disclosable Restructuring Paper - Skills Development and Innovation Support Project. Washington D.C: World Bank Group.*
- Nacionalna sluzba za zaposljavaње. (2015). *Pravilnik o kriterijumima, nacinu i drugim pitanjima od znacaja za sprovođenje mera aktivne politike zaposljavaња. Sluzben Glasnik RS.*
- Nacionalna sluzba za zaposljavaње. (2018). *Program rada Nacionalne sluzbe za zaposljavaње za 2019 godinu. Beograd: NSZ.*
- OECD & UNIDO. (2004). *Effective policies for small business. Paris: OECD & UNIDO.*
- OECD. (1994). *Globalisation and Competitiveness: Relevant Indicators. Paris: OECD.*
- OECD. (2005). *Oslo Manual. Guidelines for collecting and interpreting innovation data (3rd ed.). Luxembourg: OECD.*
- OECD. (2011). *OECD Science, Technology and Industry Scoreboard 2011: Innovation and growth in Knowledge Economies. Paris: OECD.*
- OECD IC. (2013). *Assessment of the National Innovation System of the Former Yugoslav Republic of Macedonia. OECD IC.*
- OECD/ETD/EU/EBRD. (2019). *"Profili i Aktit të Biznesit të Vogël i Kosovës", në Indeksin e Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019: Vlerësimi i zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën. OECD Publishing.*
- Portal Preduzetnistva. (2019). Retrieved from Kratorocni Krediti:  
<https://www.preduzetnistvo.gov.rs/programi/kratorocni-kredit/>
- Portal Preduzetnisva. (2019). Retrieved from "Start-up":  
<https://www.preduzetnistvo.gov.rs/programi/startup/>
- Portal Preduzetnistva. (2019). Retrieved from Investicioni Krediti:  
<https://www.preduzetnistvo.gov.rs/programi/investicioni-kredit/>
- Portal Preduzetnistva. (2019). Retrieved from Krediti za trajna obrtna sredstva:  
<https://www.preduzetnistvo.gov.rs/programi/krediti-trajna-obrtna-sredstva/>
- Portal Preduzetnistva. (2019). Retrieved from Medjunarodni Programi:  
<https://www.preduzetnistvo.gov.rs/medjunarodni-programi/>
- Porter, M. E. (1980). *Competitive Strategy. Techniques for Analyzing Industries and Competitors. New York: The Free Press.*
- Porter, M. E. (1998). *Competitive Strategy: Techniques for Analyzing Industries and Competitors. New York: Free Press.*
- ProCredit Bank Kosovo. (2017). Retrieved from <https://procreditbank-kos.com/eng/news/eur-70m-for-smes-in-kosovo-serbia-and-the-for-701/>
- Qeveria e Republikës së Kosovës. (2017). *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021. Qeveria e Republikës së Kosovës.*
- Razvojnja Agencija Srbije. (2019). Retrieved from Javni pozivi: <http://www.ras.gov.rs/javni-pozivi>

- Schumpeter, J. A. (1934). *The Theory of Economic Development*. Cambridge: Harvard University Press.
- Shipovikj, S. (2018). *Strukturalni Delovni Statistiki*. Shkup: Enti shtetëror i statistikës së RM-së. Retrieved from <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbrtxt=111>
- Singh, R. K., Garg, S. K., & Deshmukh, S. G. (2007). *Interpretive structural modelling of factors for improving competitiveness of SMEs*. *Int. J. of Productivity and Quality Management*, 2, 423-440.
- Sluzben Glasnik RS. (2015). *Zakon o Fondu za razvoj Republike Srbije*. Sluzben Glasnik RS.
- Sluzben Glasnik RS. (2018). *Zakona o Racunovodstvo br.62/2013 i br.30/2018*. Sluzben Glasnik RS.
- The World Bank. (2018). *World Development Indicators*. Washington, D.C.
- U. I. (2019). Retrieved from <http://data.uis.unesco.org>,
- USAID & RAS. (2018). *Projekt Razvoja Privatnog Sektora*. USAID & RAS.
- USAID. (2019). Retrieved from *Fact Sheet: Business Ecosystem Project - North Macedonia*: <https://www.usaid.gov/macedonia/fact-sheets/business-ecosystem-project>
- WB EDIF. (2019). Retrieved from *North Macedonia*: <http://www.wbedif.eu/wbedif-in-your-country/north-macedonia/>
- Western Balkans Investment Framework*. (2019). Retrieved from [www.wbif.eu](http://www.wbif.eu)
- World Economic Forum. (2018). *The Global Competitiveness Report*. Geneva: World Economic Forum.
- АППРМ. (2015). *Обсерваторија на МСП*.

## 8. Shtojcë

### PYETËSOR PËR NDËRMARRJET

#### **Udhëzime dhe informacione të përgjithshme**

Ky pyetësor është projektuar për të vënë në pah ndikimet e subvencioneve financiare dhe jofinanciare në performancën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si pjesë e studimit shkencor në kuadër të tezës sime të magjistraturës.

Të gjitha përgjigjet në këtë pyetësor do të mbahen RREPTËSISHT KONFIDENCIALE dhe do të përdoren vetëm për nevojat e studimit.

Ju lutemi plotësoni këtë pyetësor duke zgjedhur kutitë e duhura në pyetjet e parashtruara më poshtë.

Ju faleminderit për kontributin tuaj.

A. TË DHËNA PËR NDËRMARRJEN

1. Emri i ndërmarrjes: \_\_\_\_\_
2. Adresa: \_\_\_\_\_ Komuna: \_\_\_\_\_
3. Tel/Mob: \_\_\_\_\_ Email: \_\_\_\_\_ Web: \_\_\_\_\_
4. Personi për kontakt: \_\_\_\_\_

B. KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË NDËRMARRJES

5. Cili është aktiviteti i ndërmarrjes suaj?
  - Bujqësi
  - Prodhimtari
  - Shërbime
  - Tregti
  - Tjetër: \_\_\_\_\_
  
6. Cila është forma e regjistrimit të ndërmarrjes suaj?
  - SHPKNJ
  - SHPK
  - Tregtar individual
  - Zanaetçi
  - Bujk individual
  - Të tjera: \_\_\_\_\_
  
7. Ndërmarrja është në pronësi të:
  - Pronarit/CEO-së mashkull
  - Pronares/CEO-së femër
  
8. Për sa kohë ekziston ndërmarrja juaj?
  - Më pak se 1 vit
  - Nga 1 deri në 5 vite
  - Nga 5 deri në 10 vite
  - Mbi 10 vite
  
9. Sipas kategorizimit ligjor, në cilin grup bën pjesë ndërmarrja juaj?
  - Mikro (0 deri 9 të punësuar)

- E vogël (10 deri 49 të punësuar)
- E mesme (50 deri 249 të punësuar)

10. A e konsideroni biznesin tuaj si biznes familjar? Zgjidhni përgjigjen relevante.

- Po
- Jo
- Nuk mund ta vlerësoj

11. A keni biznes plan për ndërmarrjen tuaj?

- Po
- Jo

12. Sa ka qënë qarkullimi vjetor i ndërmarrjes suaj në 5 vitet e fundit, 2014-2018?

	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Qarkullimi vjetor në MKD					

13. Sa i përket qarkullimit vjetor në 3-5 vitet e ardhshme (2019-2023), sa pritet që ndërmarrja juaj të shënojë rritje në vit?

- Rritje të ndjeshme – mbi 20% në vjet në terma të qarkullimit vjetor
- Rritje të moderuar – nën 20% në vjet në terma të qarkullimit vjetor
- Nuk do të ketë ndryshim
- Do të zvogëlohet
- Nuk e di

14. Sa ka qënë numri i të punësuarve në 5 vitet e fundit 2014-2018?

	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Numri i të punësuarve					

15. Sa i përket numrit të të punësuarve në 3-5 vitet e ardhshme (2019-2023), sa pritet që ndërmarrja juaj të shënojë rritje në vit?

- Rritje të ndjeshme – mbi 20% në vjet në terma të numrit të të punësuarve
- Rritje të moderuar – nën 20% në vjet në terma të numrit të të punësuarve
- Nuk do të ketë ndryshim
- Do të zvogëlohet
- Nuk e di

#### C. BIZNES PERFORMANCA E NDËRMARRJES

16. Shënoni faktorët më problematik në udhëheqjen e biznesit tuaj (mund të zgjidhni më tepër se një përgjigje):

- Administratë joefikase shtetërore
- Qasje deri te mjetet financiare



- Korrupsioni
- Jostabiliteti i politikave ekonomike
- Shkallët tatimore
- Rregullativat ligjore
- Etikë pune e pamjaftueshme e fuqisë punëtore
- Kriminaliteti dhe vjedhja
- Qeveri jostabile
- Fuqi punëtore me edukim jo të përshtatshëm
- Infrastrukturë jo e përshtatshme
- Rregullativat devizore
- Inflacioni
- Shpenzimet për telefon, nxemje, internet dhe komunikim
- Mungesë e besimit në relacionet e biznesit
- Të tjera: \_\_\_\_\_

17. A jeni anëtar i ndonjë ode ekonomike?

- Po  Jo

18. Nëse po, tek cila? \_\_\_\_\_

19. Nëse jeni anëtarë i ndonjëres prej odave ekonomike, a i fitoni shërbimet e duhura për të cilat keni nevojë?

- Po  Jo

20. A keni përkrahje nga institucionet vijuese?

	Asnjëherë (1)	Rrallë (2)	Ndonjëherë (3)	Shpesh (4)	Gjithmonë (5)
Qeverisja qendrore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Qeverisja lokale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
QZHRPP <sup>22</sup>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Oda ekonomike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Sektori joqeveritar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

21. A keni aplikuar ndonjëherë për ndonjë lloj përkrahjeje nga insitucionet relevante?

<sup>22</sup> QZHRPP – Qendra për Zhvillim të Rajonit Planor të Pollogut.

Po  Jo

22. Nëse po, cilës kategori të mëposhtme i përket ajo:

- Financare
- Jofinanciare
- Të tjera: \_\_\_\_\_

23. Cilat dokumente kërkoheshin gjatë procesit të aplikimit për përkrahjen e marrë?

- Kërkesë/Fletëaplikim
- Certificate biznesi nga regjistri qendror
- Llogaritë përfundimtare (Balanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit)
- Biznes Plan
- Boniteti i ndërmarrjes
- Pjesëmarrja në investim
- Fatura për furnizimin e makinave/pajisjeve
- Vërtetim nga DAP
- Të tjera: \_\_\_\_\_

24. A keni hasur në ndonjë vështirësi gjatë përgatitjes së dokumentacionit për aplikim?

Po  Jo

25. Nëse po, në çfarë lloje vështirësish keni hasur?

---

---

---

---

26. Nga cili institucion është marrë përkrahja e shfrytëzuar?

- Ministria e ekonomisë
  - Banka Maqedonase për përkrahje të zhvillimit
  - Fondi për zhvillim të inovacioneve dhe zhvillimit teknologjik
  - Agjensioni për përkrahjen e sipërmarrësisë në RM
  - Masat aktive për punësim (UNDP, Ministria për punë dhe politikë sociale Agjensioni për punësim)
  - Agjensioni për financim të bujqësisë dhe zhvillimit rural
- Projekte të donatorëve të huaj (nga:  EU Fonde,  USAID,  GTZ,  SDC,  UNDP,  Të tjera \_\_\_\_\_)

- Projekte nga organizata joqeveritare (nga: \_\_\_\_\_)
- Projekte nga dhomat ekonomike (nga: \_\_\_\_\_)

27. Nëse keni shfrytëzuar ndonjërin nga masat aktive për punësim, cila ka qënë ajo:

- Vetëpunësimi
- Formalizimi i biznesit
- Punësime me subvencionim
- Përkrahje të NVM-ve për krijim të vendeve të reja të punës
- “Maqedonia punëson 1 dhe 2”
- Trajnime për të punësuarit
- Kredi për startim të biznesit
- Kredi për punësime të reja
- Praktikantë
- Të tjera: \_\_\_\_\_

28. Sa ka qënë lartësia e mjeteve financiare apo jofinanciare që i keni shfrytëzuar për biznesin tuaj nga institucionet relevante:

- 0-3000 EUR
- 3000-5000 EUR
- 5000-10000 EUR
- 10000-20000 EUR
- 20000-30000 EUR
- mbi 30000 EUR (sa: \_\_\_\_\_)

29. Nëse përkrahja që keni shfrytëzuar ka qënë e natyrës financiare, për çfarë është shfrytëzuar ajo? *(mund të zgjidhni më tepër se një përgjigje)*

- Maqina dhe pajisje
- Furnizim me lëndë të parë
- Adaptim/renovim të objektit/ve afarise
- Implementim të standardeve ndërkombëtare
- Punësime të reja
- Kontribute të rrogave për të punësuarit
- Zhvillimi i produkteve apo shërbimeve të reja
- Rifinancimi apo pagesa e detyrimeve
- Të tjera: \_\_\_\_\_

30. Nëse përkrahja që keni shfrytëzuar ka qënë e natyrës jofinanciare, për çfarë është shfrytëzuar ajo? *(mund të zgjidhni më tepër se një përgjigje)*

- Këshilla/konsulencë afariste
- Trajnime, seminare, punëtori dhe konferenca

- Shërbime konsulente për përgatitje të dokumentacionit për implementim të standardeve ndërkombëtare
- Pjesëmarrje në panairë vendore/ndërkombëtare
- Të tjera: \_\_\_\_\_

31. A kanë qenë të mjaftueshme mjetet që i keni marrë në formë të përkrahjes?

- Po  Jo

32. Nëse jo, cila ka qenë arsyeja?

---



---



---



---

33. Si do ta vlerësonit eksperiencën e përgjithshme të procedurës për sigurimin e përkrahjes financiare/jofinanciare?

1 Dobët	2 Mjaftueshëm	3 Mirë	4 Shumë mirë	5 Shkëlqyeshëm
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

34. Nëse nuk e keni fituar përkrahjen për të cilën keni aplikuar, cilat kanë qenë arsyet?

- Aplikimi nuk i plotësonte kushtet
- Aplikimi nuk ishte i mbushur në mënyrë të saktë
- Mungesë dokumentacioni
- Pamundësi e sigurimit të përqindjes së pjesëmarrjes vetanake
- Jo-transparencë në procesin e zgjedhjes
- Të tjera: \_\_\_\_\_

35. A pajtoheni me arsyen që ju është dhënë?

- Po  Jo

36. Nëse jo, komentoni pse?

---



---



---



---

37. Cili ishte impakti nga mospranimi i kërkesës/aplikimit tuaj për përkrahje financiare/jofinanciare?

- Vështirësi financiare
- Duhet të shtyja planet

- Duhej të shtyja planet, por eventualisht i kam realizuar
- Nuk kishte impakt
- Ngelet për tu parë
- Të tjera: \_\_\_\_\_

38. Nëse nuk keni aplikuar fare për asnjë lloj përkrahjeje, cila është arsyeja? *(mund të zgjidhni më tepër se një përgjigje)*

- Nuk keni nevojë për përkrahje të tilla
- Nuk i plotësoni kushtet e kërkuara në shpallje
- Mosbesim në procesin e selektimit
- Vëllimi i mbështetjes është minor
- Promovim i dobët i masave përkrahëse nga institucionet relevante
- Jo informim i duhur nga ana ime/ndërmarrjes
- Të tjera: \_\_\_\_\_

39. Nëse do tu ofrohej mundësia për të shfrytëzuar ndonjë lloj përkrahjeje, cilën do ta preferonit më shumë:

- Përkrahjen financiare
- Përkrahjen jofinanciare

40. Ju lutemi jepeni një arsyetim për zgjedhjen tuaj në pyetjen paraprake.

---



---



---



---

41. Nëse do tu ofrohej mundësia për të shrytëzuar ndonjë përkrahje financiare/jofinanciare nga institucionet relevante, për çka do ti kishit përdorur? *(mund të zgjidhni më tepër se një përgjigje)*

- Maqina dhe pajisje
- Furnizim me lëndë të parë
- Adaptim/renovim të objektit/ve afariste
- Implementim të standardeve ndërkombëtare
- Punësime të reja
- Kontribute të rrogave për të punësuarit
- Zhvillimi i produkteve apo shërbimeve të reja
- Rifinancimi apo pagesa e detyrimeve
- Këshilla/konsulencë afariste
- Trajnime, seminare, punëtori dhe konferenca
- Pjesëmarrje në panairë vendore/ndërkombëtare
- Të tjera: \_\_\_\_\_

42. Nëse do tu ofrohej mundësia për të shrytëzuar ndonjë përkrahje financiare/jofinanciare nga institucionet relevante, cila do të ishte vlera për të cilën keni nevojë?
- 0-3000 EUR
  - 3000-5000 EUR
  - 5000-10000 EUR
  - 10000-20000 EUR
  - 20000-30000 EUR
  - mbi 30000 EUR (sa: \_\_\_\_\_)
43. Shfrytëzimi i përkrahjeve paraprake ka pasur/do të kishte ndikim pozitiv në: (*mund të zgjidhni më tepër se një përgjigje*)
- Themelimin e biznesit
  - Rritjen e qarkullimit vjetor të ndërmarrjes
  - Rritjen e numrit të vendeve të reja të punës
  - Përmirësimin e kualitetit të produktit/shërbimit
  - Furnizimin me lëndë të parë
  - Përmirësimin e teknologjisë së punës
  - Përmirësimin e kushteve të punës në objektin/et afariste
  - Rritjen e pjesëmarrjes në treg
  - Depërtim në tregje të reja lokale/rajonale
  - Përmirësimin e aftësive/shkathtësive të të punësuarve
  - Të tjera: \_\_\_\_\_
44. Për sa u përket përkrahjeve financiare dhe jofinanciare, nevoja për to në 5 vitet e fundit është:
- Rritur                       Nuk ka ndryshuar                       Zvogëluar
45. Si informoheni për përkrahjet e disponueshme financiare/jofinanciare të biznesit?
- Kontakte personale të biznesit
  - Përmes anëtarësimit në asociacione tregtare
  - Burime nga qeveria
  - Komunikimi masiv i medias
  - Të tjera: \_\_\_\_\_

46. Sipas jush, cilat nga masat e mëposhtme janë të domosdoshme për të përmirësuar performancën e ndërmarrjes tuaj në tregun ku veproni? *(mund të zgjidhni më tepër se një përgjigje)*

- Mjetet stimuluese, masat aktive për themelimin e bizneseve, punësimet dhe trajnimet
- Fondet për përkrahjen e inovacioneve në ndërmarrje
- Subvencionimi i investimeve të reja nga institucionet qendrore/vendore
- Edukimi (rikualifikimi, kualifikimi i mëtutjeshëm dhe trajnimi) i kuadrove
- Mbështetja e aktiviteteve të ndryshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjes (transferi i teknologjive, inovacioneve, misioneve tregtare, aplikimeve tek fondet evropiane)
- Kushtet e volitëshme për thithje të burimeve financiare (nga bankat komerciale, Banka maqedonase për përkrahje të zhvillimit, burime të tjera financiare)
- Zhvillimi i përgjithshëm i fushave të ndryshme të shoqërisë (ekonomia, teknologjia, arsimit, ekologjia, bujqësia, etj.)
- Përshtatja e sistemit të arsimit sipas kërkesave të tregut të punës
- Përmirësimi i menaxhmentit të ndërmarrjes
- Të tjera: \_\_\_\_\_

47. A keni ndonjë propozim për shërbimet të cilat duhet ti sigurojë pushteti qendror/lokal për përmirësimin e bashkëpunimit me sektorin afarist?

---

---

---

---

\_\_\_\_\_

Data